



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2 regjistër (JR)
Datë 12.01.2023

Nr. 2 i vendimit
Datë 24.01.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.01.2024, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 570, datë 07.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42, 179/b, pika 5, neni F i Aneksit të saj; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa "b"; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 46; neni 442 e vijues i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.01.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), shqyrtoi shkaqet e ankimit

dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 570, datë 07.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco) (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, me shortin e hedhur më datë 16.12.2019, nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar (në vijim “deklarata vetting”), deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”).

3.1. ILDKPKI-ja¹, pasi kreu procedurën e kontrollit për deklaratimet e pasurive të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) mungon dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2. DSIK-ja ka kryer procedurat për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin prej të cilit rezultoi se nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, dhe përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco)².

3.3. KLGJ-ja ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në: formularin e vetëdeklarimit; tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së³.

¹ ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 8.10.2018, ka dërguar në Komision aktin e përfundimit të kontrollit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

² Raporti i DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 12.7.2022, të KDZH-së, është dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 13.07.2022.

³ Raporti është dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 22.04.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit, ka zhvilluar procesin e hetimit administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht për kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me vendimin nr. 570, datë 07.10.2022, Komisioni ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco)*. Vendimi i Komisionit u bazua në përfundimet e paraqitura në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -36.169.783 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në kushtet e germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

4.2. Për vlerësimin e kontrollit të figurës:

Nga hetimi administrativ, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës.

4.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale:

Për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i

rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 570, datë 07.10.2022, të Komisionit, në zbatim të nenit 63, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili mbështetet në dispozitat ligjore të referuara në hyrje të këtij vendimi, për aspekte procedurale dhe për themelin. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Kolegj parashtrime në datën 18.01.2024. Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit.

A. Parashtrimet në ankim

6. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit parashtroi:
 - 6.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar dhe të paravendosur, pa u kryer procesi i hetimit dhe gjykimet. Shorti i posaçëm dhe i veçantë i datës 16.12.2019, i organizuar nga Komisioni për shqyrtimin e çështjeve të subjekteve të rivlerësimit ku është përfshirë, nuk është i bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.
 - 6.2. Vendimet e ndërmjetme të Komisionit për rrëzimin e kërkesave paraprake të saj në seancë dëgjimore, janë të pabazuara në ligj, të paarsyetuara ligjërisht, dhe kanë cenuar garancitë për një proces të rregullt ligjor, parimet e paanësisë, barazisë së armëve dhe aksesit në gjykim.
 - 6.3. Në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), gjykata, e krijuar në kundërshtim me ligjin, nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme. Kolegji të marrë në shqyrtim kërkesën e saj për mospërmblidhjen e kritereve ligjore të zgjedhshmërisë të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit që shqyrtuan çështjen e saj, dy prej të cilëve, kryesuesja dhe relatori, kanë qenë në kushtet e papajtueshmërisë për të qenë pjesë e trupës gjyquese që kreu procesin e saj të rivlerësimit.
 - 6.4. Në shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, nuk është respektuar ligji, është cenuar parimi i sigurisë juridike, i diskrecionit, proporcionalitetit dhe objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës.
 - 6.5. Është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 4, pika 5, nenit 6 e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vendosur barrë prove të paarsyeshme, joligjore, joproporcionale, joobjektive. Vendimi është marrë për fakte, shkaqe apo rrethana për të cilat subjekti është në pamundësi objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
 - 6.6. Vendimi është i pabazuar në ligj dhe në prova, rrjedhë e keqinterpretimit apo anashkalimit të provave, paraqitjes së rrethanave dhe fakteve të gabuara në shërbim të qëllimit për dhënien e një vendimi të paravendosur, të paragjykuar dhe për të konfirmuar të ashtuquajturin short dhjetori, ose “lista e zezë”, është i paarsyetuar dhe tërësisht alogjik, në kundërshtim të hapur me ligjet materiale dhe procedurale.

7. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material, subjekti ka parashtruar si vijon.

7.1. Për pasurinë *shtesë anësore, me sipërfaqe 68 m² (pa leje ndërtimi), e apartamentit të banimit me sipërfaqe 39 m², në Tiranë:*

(i) Ndërtimi informal nuk është deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë të vitit 2003 dhe 2004, për shkak të parashikimeve në formularët respektivë, por është deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, ku është saktësuar kërkesa për deklarim të tij.

(ii) Me aktekspertimin tekniko-ekonomik të hartuar nga ing. e licencuar I. S., ka provuar kohën e ndërtimit të shtesës, vitin 2000, dhe vlerën e kostos së ndërtimit. Në koston e ndërtimit të llogaritur sipas vlerave të Entit Kombëtar të Banesave, nuk janë zbritur së paku vlerat që përfaqësojnë TVSh + fitim + fond rezervë.

(iii) Në analizën financiare për burimet e krijimit të kësaj pasurie, nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit me burim të ligjshëm; nuk është pasqyruar gjendja familjare e saj dhe e personit të lidhur, bashkëshortit, të ardhurat respektive të tyre, para lidhjes së martesës e bashkëjetesës; si dhe të ardhura të dokumentuara të depozitave bankare nga viti 1997 e në vijim, krijuar me kursime të saj, bashkëshortit dhe familjeve respektive, si dhe interesat e tyre.

7.2. Për pasurinë *shtesë kati, me sip. 70 m² (pa leje ndërtimi), ndërtuar mbi banesën ekzistuese në lagjen “{***}”, Vlorë, e regjistruar në ZVRPP Vlorë me nr. pasurie {***}, Z.K. {***}, në emër të babait të subjektit R. G. dhe bashkëpronarëve të tjerë, janë anashkaluar fakte dhe prova lidhur me kohën e përfundimit të ndërtimit, koston së ndërtimit sipas aktekspertimit tekniko-ekonomik të hartuar nga ing. e licencuar I. S.. Kostoja e ndërtimit minimalisht duhet të ndahet në dy pjesë mes bashkinvestitorëve, bashkëshortit dhe vëllait të tij.*

7.3. Për pasurinë *tokë me sipërfaqe 20.000 m², e ndodhur në Tale, Lezhë, është përfituar nga bashkëshorti si shpërblim në natyrë për shërbimet e avokatisë. Sipas nenit 4 të kontratës së shitblerjes, e vetmja mënyrë për regjistrimin e pronës në ZVRPP, nga ana e bashkëshortit të subjektit nuk është lëshuar asnjë faturë për këtë shërbim dhe nga ana e porositesit nuk është kryer asnjë pagesë për punën si avokat, për rrjedhojë nuk ka pagim të detyrimeve tatimore.*

7.4. Për pasurinë *automjet, tip “Mercedes Benz” me targë {***}, konkluzioni i Komisionit është alogjik dhe kontradiktor me analizën financiare të hartuar prej vetë Komisionit, ku viti 2006 rezulton me balancë pozitive.*

7.5. Për pasuritë trashëgimore të bashkëshortit, *sipërfaqe trualli prej 6000 m², 3.590 m², 1.200 m², 8.399 m², 1.350 m², të ndodhura në Vlorë, konkluzioni i Komisionit dëshmon tendencë për të penalizuar me patjetër subjektin, duke cenuar besueshmërinë e të gjitha konkluzioneve të tjera.*

7.6. Për pasuritë në emër të bashkëshortit, *depozita bankare: në BKT, në vlerë 22.779 USD dhe 29.728 euro; në Intesa San Paolo Bank, në vlerë 40.255 euro; në Raiffeissen Bank, në vlerë 1.992.281 lekë; 80.652 USD; 2.348 USD dhe 30.048 euro; në ProCredit Bank, në vlerën 37.159 USD; dhe llogari rrjedhëse në ProCredit Bank, në vlerën 51.438 USD, nga analiza financiare janë shmangur të ardhurat e ligjshme të tij ose janë përfshirë të ardhura që rëndojnë në mënyrë të padrejtë balancën e të ardhurave të dokumentuara. Konkretisht:*

(i) Të ardhurat përpara vitit 2007, të përfituara nga bashkëshorti, nga punë dytësore jashtë qendrës së punës, si ofrim i shërbimeve juridike, janë të ligjshme, pasi detyrimet tatimore janë paguar nga subjektet përkatëse. Bashkëshorti ka vepruar si individ natyror, cilësia e avokatit është titull që merret pas një kualifikimi të caktuar, dhe jo kur regjistrohesh në organin tatimor.

(ii) Të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga shërbimet e kryera për shoqërinë “{***}” ShPK, në vitin 1999, janë të ligjshme. Bashkëshorti ka vepruar si individ, brenda hapësirave ligjore të kohës, përpara se t’i jepej leja për ushtrimin e profesionit të avokatit, dhe sipas aktmarrëveshjes, detyrimet tatimore janë në ngarkim të shoqërisë.

(iii) Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pronave të familjes M. për periudhën 2001-2016, janë të drejta reale të kësaj familjeje, nuk duhet të llogariten si të ardhura nga puna si avokat e bashkëshortit [person fizik], por si të ardhura me burim të ligjshëm, për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore.

7.7. Metodologjia e përdorur për analizën financiare të kryer nga Komisioni, është e pabazuar në ligj e në prova, në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, mendimin e kualifikuar të institucioneve kompetente, si INSTAT-i, dhe organet tatimore.

(i) Depozitat pranë ish-Arkës së Kursimeve, aktualisht Raiffeissen Bank ShA, dhe pranë Bankës Kombëtare Tregtare, janë krijuar nga kursimet e saj, të bashkëshortit, si dhe të familjeve respektive para dhe pas martesës. Sa u përket depozitave në Bankën Kombëtare Tregtare, është në pamundësi objektive për të siguruar dokumentacion sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

(ii) Të ardhurat e saj nga paga si gjyqtare për vitet 1994, 1995, 1996, 1997, 1998, kursimet e saj përpara vitit 1997, si dhe të ardhurat e bashkëshortit, për periudhën 1989-1993, nga puna si mësues në Orikum, Vlorë, nga punësimi pranë {***}-së/ Ministrisë së Bujqësisë, në periudhën prill 2000-mars 2006, si edhe kursimet, interesat bankarë, shpenzimet për qira, nuk janë llogaritur saktë.

(iii) Shpenzimet e jetesës për periudhën 1997-2000, janë llogaritur në mënyrë të gabuar me 66% të të ardhurave vjetore, dhe pa marrë në konsideratë ekonominë e përbashkët familjare, sipas certifikatës së përbërjes familjare. Për periudhën 2003-2016, në mënyrë të gabuar, përlllogaritja nuk ka referuar të dhënat e INSTAT-it, si institucion i caktuar me ligj, por të dhënat e ILDKPKI-së. Për periudhën 2002-2014, shpenzimet e jetesës janë llogaritur dy herë, për dy vajzat, pasi paketa arsimore e institucionit arsimor “{***}” ka përfshirë dy vakte ushqimi, mëngjesin dhe drekën.

(iv) Vlera e kostos së ndërtimit të shtesës së apartamentit në Tiranë në vitin 2000, duhet të korrigjohet sipas aktekspertimit tekniko-ekonomik dhe shpenzimet për mobilim nuk duhet të llogariten si zë i veçantë për vitet 2001 dhe 2002.

(v) Vlera e kostos së ndërtimit të shtesës së katit në Vlorë, duhet të shtrihet në periudhën 2013-2017, duke i zbritur gjysmën e investimit të kryer nga vëllai i bashkëshortit.

(vi) Shpenzimet për arsimin e dy vajzave për vitet 2002-2008, për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion pranë institucionit arsimor “{***}”, nuk duhet të llogariten në analizën financiare.

(vii) Për periudhën shtator 2007 - dhjetor 2013, të ardhurat nga aktiviteti i personit të lidhur, bashkëshortit, janë në masën 4.000.000 lekë në vit.

(viii) Vlera e gjendjes së llogarive dhe depozitave bankare në emër të bashkëshortit, në fund të vitit 2016, prej 41.326.002 lekësh, është nxjerrë sipas një metodologjie të gabuar duke bërë konvertimin e monedhave të ndryshme në të njëjtën periudhë kohore, dhjetor 2016, ndërkohë që depozitimet janë bërë në kohë të ndryshme.

8. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, mosrespektimi i afateve procedurale të arsyetimit të vendimeve, duhet analizuar duke referuar ligjin procedural të kohës dhe jo atë të vitit 2017. Për numrin e lartë të çështjeve në gjykim prej saj, dhe numrin e çështjeve të përfunduara, ka qenë mbi standardin sasior të sistemit të vlerësimit, për rrjedhojë justifikon problematikat lidhur me tejkalimin e afateve të gjykimit.
9. Në konkluzionet dhe kërkimet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji të gjykojë çështjen objekt ankimi në seancë publike, duke riçelur/përsëritur hetimin gjyqësor, në funksion të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike dhe kryerjes së një analize të drejtë financiare, ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 570, datë 07.10.2022, dhe konfirmimin e saj në detyrë.

B. Parashtrimet e datës 18.01.2024

10. Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti paraqiti parashtrime shtesë mbi shkaqet e ngritura në ankim, akte shkresore dhe rrethana të reja, të vëna në dispozicion apo të ndodhura pas dhënies së vendimit objekt ankimi. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, subjekti fokusoi konkluzionet e Komisionit lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga angazhimet private të bashkëshortit, të ardhurat e krijuara nga administrimi i pronave të familjes M., dhe pamundësisë financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite. Në këndvështrim të saj, dokumentet e paraqitura bashkëlidhur, apo qëndrimet e anëtarëve të trupës gjyqësore të Komisionit që kryen procesin e saj të rivlerësimit, të ndryshme për raste të ngjashme në vendime të dhëna më pas, provojnë se vendimi i dhënë ndaj saj është tendencioz, i paramenduar, i njëanshëm dhe në kundërshtim të hapur me ligjin. Konkretisht:

10.1. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga angazhime private në periudhën 2000-2007, nga punë dytësore, ofrimi i shërbimeve juridike, subjekti parashtrroi se arsyetimi i Komisionit se *bashkëshorti nuk ka iniciuar proces gjyqësor ndaj shoqërive tregtare në lidhje me pagimin e detyrimit tatimor*, nuk është i bazuar në ligj, pasi (i) bashkëshorti nuk ka pasur legjitimitetin aktiv për ngritje të kërkesëpadive në lidhje me pagimin e detyrimit tatimor, derisa nuk është deklaruar debitor nga ana e organeve tatimore; (ii) janë parashkruar afatet e ngritjes së kërkesëpadisë për detyrimin e shoqërive tregtare për të paguar tatimin në burim, sipas legjislacionit tatimor. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), citon qëndrime të anëtarëve të trupit gjyqësor, në vendime të mëvonshme, sipas saj, të ndryshëm nga qëndrimet në rastin e saj⁴.

10.2. Lidhur me llogaritë dhe depozitat bankare në emër të bashkëshortit, në vijim të sa argumentuar dhe kërkuar në ankim, subjekti parashtron se me dokumentet bashkëlidhur parashtrimeve, provon se bashkëshorti vijon administrimin e pronave të familjes M.. Konkretisht: (i) më datë 29.08.2023, me shkresë të thjeshtë, vërtetohet se i është dorëzuar R. E. D., njëra nga trashëgimtarët e familjes,

⁴ Subjekti referon vendimet e Komisionit nr. 479, datë 03.12.2021; nr. 689, datë 24.07.2023; nr. 711, datë 01.11.2023 [mendimin në pakicë të komisioneres P. Q.].

shuma prej 12.500 USD, të cilën bashkëshorti e ka tërhequr nga llogaritë e tij bankare, ku janë vlerat e akumuluar nga qiratë e pronave të kësaj familjeje; (ii) R. Xh. S. (M.), për të cilën ka shpjeguar se ka qenë në konflikt me trashëgimtarët e tjerë, me deklaratën noteriale të datës 09.08.2023, deklaroi se heq dorë nga kërkesa të mëparshme lidhur me legalizimin në emër të saj të shtesës së katit në Vlorë, si dhe ka pajisur bashkëshortin e saj me prokurën e përgjithshme nr. {***}, datë 12.08.2023, që të veprojë dhe ta përfaqësojë në administrimin e pasurive.

10.3. Lidhur me pretendimin për *pasqyrimin në analizën financiare të të ardhurave të familjeve respektive, para lidhjes së martesës dhe të bashkëjetesës*, subjekti shprehet se aktet bashkëlidhur parashtrimeve provojnë trashëgiminë e saj familjare, në aspektin moral dhe pasuror. Konkretisht, me prokurën e përgjithshme nr. {***}, datë 08.05.2015, provohet se ka qenë administratore e të gjithë pasurisë që halla e saj trashëgonte nga babai dhe bashkëshorti; ka firmosur në emër dhe për llogari të hallës, kontratën nr. {***}, datë 08.05.2015, dhe në llogarinë e saj bankare ka kaluar shuma e shitjes prej 67.000 eurosh; sipas aktit të trashëgimisë ligjore nr. {***}, datë 12.06.2023, provohet se ajo dhe e motra janë trashëgimtare ligjore të vetme të hallës, por dhe të bashkëshortit të saj, për prona të luajtshme dhe të paluajtshme sipas certifikatave të pronësisë. Ndërsa, me kontratë shitjeje nr. {***}, datë 22.09.2022, deklaratë noteriale nr. {***}, datë 03.09.2022, dhe nxjerrje llogarie bankare të bashkëshortit nga Raiffeissen Bank ShA, provohet se nëna, vëllai dhe motra e këtij të fundit, pjesën e tyre takuese nga shitja e pasurisë, në vlerën prej 3.738.084 lekësh, e kanë transferuar në llogari të bashkëshortit, duke ia lënë në administrim, sikundër në raste të ngjashme të periudhës përpara vitit 2003, bazuar në harmoninë dhe solidaritetin familjar.

10.4. Lidhur me shpenzimet për arsimin e vajzave pranë institutit arsimor “{***}”, përmes vendimit të Komisionit nr. 711, datë 01.11.2023, ka rënë në dijeni rreth një vlere të përafërt për secilën nga vajzat, që varion në vlerën prej 150.000 lekësh në vit shkollor për vitet 2002, 2003, 2004, dhe me një rritje të lehtë vjetore për vitet në vijim.

11. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në konsideratë qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*⁵ dhe, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 570, datë 07.10.2022, të Komisionit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.
13. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

⁵ Subjekti citon paragrafët 85, 86, 87, 88, 92, 95, 96 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*.

Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Trupi gjykues i Kolegjit e shqyrtoi këtë çështje në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi vlerësoi se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike.
15. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012⁶, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision⁷. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit

⁶ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, parashikon që: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁷ Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur:

(i) Printime nga faqja zyrtare e Komisionit të referuara: “Praktika të dorëzimit të vendimeve të arsyeuara” nga komisioneri R. I.: vendimet nr. 177, datë 08.07.2019; nr. 115, datë 11.03.2019; nr. 97, datë 10.01.2019; nr. 100, datë 14.01.2019; nr. 81 datë 26.11.2018; nr. 73, datë 02.11.2018; nr. 57, datë 01.08.2018; nr. 61, datë 02.08.2018; nr. 37, datë 16.07.2018; nr. 244, datë 05.03.2020; nr. 340, datë 01.02.2021; nr. 351, datë 25.02.2021; nr. 357, datë 18.03.2021; nr. 363, datë 01.04.2021; nr. 410, datë 30.06.2021; nr. 211, datë 18.11.2019, nr. 570, datë 07.10.2022; nga komisionerja P. Q.: vendimet nr. 173, datë 01.07.2019; nr. 108, datë 15.02.2019; nr. 46, datë 24.07.2018; nr. 231, datë 29.01.2020; nr. 293, datë 10.09.2020; nr. 296, datë 16.09.2020; nr. 298, datë 17.09.2020; nr. 315, datë 16.11.2020; nr. 337, datë 18.01.2021; nr. 330, datë 11.01.2021; nr. 339, datë 19.01.2021; nr. 401, datë 16.06.2021; nr. 413, datë 07.07.2021; nr. 473, datë 05.11.2021; nr. 479, datë 03.12.2021; nr. 521, datë 01.04.2022, nr. 264, datë 17.06.2020, nr. 376, datë 26.04.2021; nga komisionerja E. Ç., vendimet nr. 201, datë 25.10.2019; nr. 194, datë 06.09.2019; nr. 176, datë 08.07.2019; nr. 111, datë 27.02.2019; nr. 94, datë 21.12.2018; nr. 83, datë 26.11.2018; nr. 82, datë 26.11.2018; nr. 69, datë 10.10.2018; nr. 55, datë 31.07.2018; nr. 44, datë 23.07.2018; nr. 228, datë 17.01.2020; nr. 239, datë 21.02.2020; nr. 248, datë 05.03.2020; nr. 242, datë 28.02.2020; nr. 334, datë 14.01.2021; nr. 369, datë 21.04.2021; nr. 385, datë 18.05.2021; nr. 392, datë 28.05.2021; nr. 399, datë 14.06.2021; nr. 448, datë 21.09.2021; nr. 419 datë, 12.07.2021; nr. 465, datë 28.10.2021; nr. 304, datë 06.10.2020.

(ii) Vendime gjyqësore “Për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit”, dhënë prej subjektit, dhe ekstrakte të QKB-së për shoqëri tregtare ndaj të cilave është lëshuar urdhër ekzekutimi: vendim, datë 25.09.2019, me nr. {***} akti dhe ekstrakt historik i shoqërisë “{***}” ShPK; vendim, datë 24.01.2020, me nr. {***} akti dhe ekstrakt historik i shoqërisë “{***}” ShPK; vendim, datë 06.03.2020, me nr. {***} akti dhe ekstrakt historik i shoqërisë “{***}” ShPK.

(iii) Dokumente të referuara “Ekstrakt i dosjes gjyqësore, me paditëse A. A., nr. {***} akti, datë 02.10.2018”, me vulë të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me shënimin: “Nxjerrë nga dosja nr. {***} akti, datë 02.10.2018 regj.”, me nënshkrim [T. P.], të cilat konsistojnë në: kopje të kapakut të dosjes gjyqësore; faqja e parë e kërkesëpadisë me paditëse A. A., e paditur M. H.; vendim i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, datë 01.04.2019, me të cilin është vendosur pezullimi i gjykimit të çështjes civile me nr. {***} akti, nr. regjistri 02.10.2018, deri në përfundimin e Gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, të çështjes civile me palët ndërgjyqëse sipërcituar; vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. {***}, datë 18.06.2019, me palë paditëse A. A., me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rrëzimi i kërkesës për pezullimin e gjykimit, dhe dërgimin e çështjes në të njëjtën gjykatë me të njëjtin trup gjykues për vazhdimin e gjykimit [...]; kërkesë e palës paditëse A. A., datë 10.12.2021, për heqjen dorë të subjektit

për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016⁸. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues vëren se:

15.1. Me vendimet e Komisionit, të cituara në poshtëshënimin 7/i, subjekti kërkon të provojë se procesi i saj i rivlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me parimet e objektivitetit dhe paanësisë. Sipas subjektit, Komisioni ka konstatuar mosrespektim të afatit procedural të arsyetimit të vendimeve, por ai vetë nuk e respekton afatin në arsyetimin e vendimeve të tij. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit se *subjekti ka arritur nivel minimal kualifikues*, nuk ka qenë shkak për dhënien e masës disiplinore. Respektimi i afateve procedurale të arsyetimit të vendimeve prej subjekteve të rivlerësimit, analizohet dhe vlerësohet bazuar në rrethanat faktike, rast pas rasti, sikundër rezulton të ketë vepruar dhe Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson këto akte shkresore të panevojshme.

15.2. Me vendimet gjyqësore “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”, dhe ekstraktet historike të shoqërive tregtare, të cituara në poshtëshënimin 7/ii, subjekti pretendon se kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit ka vepruar në kushtet e papajtuëshmërisë, pasi bashkëshorti i komisioneres është shpallur debitor me vendimet gjyqësore të dhëna prej saj. Duke abstraguuar nga fakti që këto akte nuk përmbushin kriteret për provat e reja në ankim, pasi subjekti si gjyqtare që ka disponuar me dhënien e tyre, ka pasur mundësi për t’i paraqitur ato në Komision, referuar edhe përmbajtjes së tyre, pretendimet e subjektit rezultojnë të pabazuara. Subjekti nuk e referon emrin e bashkëshortit të komisioneres, për rrjedhojë në ekstraktet historike të shoqërive tregtare, identifikohet se shtetasi me mbiemër të njëjtë me komisioneren, është larguar prej shoqërive tregtare më datë 24.02.2020. Vendimet e dhëna prej subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco)⁹, përkojnë respektivisht: një prej tyre kur ajo ende nuk ishte shortuar për procesin e rivlerësimit, dhe dy të tjerët pasi Komisioni kishte vendosur nisjen e hetimit administrativ për subjektin me vendimin nr. 1, datë 20.12.2019. Fakti që pas vendimit për fillimin e hetimit administrativ, dy muajt e parë përkojnë me periudhën kur për shoqëritë tregtare janë lëshuar urdhra ekzekutimi prej subjektit, nuk përbën shkak për të pretenduar se kryesuesja/komisionerja kishte dijeni për këto vendime të subjektit, e aq më pak që bashkëshorti i kryesueses/komisioneres dhe vetë ajo të kishin interesa në këto gjykime civile. Në këtë situatë faktike, subjekti nuk arriti të provojë që kryesuesja e trupit gjykues të Komisionit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit gjatë fazave fillestare të procedurave të ndjekura për hetimin administrativ në Komision. Në kuptim të parashikimeve të nenit 30 të ligjit nr. 44/2015, ku referon neni 27 i ligjit nr. 84/2016, edhe sipas këndvështrimit të parashtruar prej subjektit, nuk gjen relevancë asnjë nga 14 rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për përfshirje në procedurë vendimarrëse të anëtarit të organit kolegjal, specifikisht ato të germave “a”, “b”, “dh” dhe “g”¹⁰.

nga gjykimi i çështjes, si shkak pengues: është në raport të afërt familjar me relatorin që do të gjykojë vlerësimin e saj kalimtar.

⁸ “[...] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm; ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit; d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

⁹ Vendimet e datave 25.09.2019, 24.2.2020 dhe 6.3.2020.

¹⁰ Ligji nr. 44/2015, neni 30, “Pengesat ligjore”, parashikon: “Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimarrëse, në rastet kur: a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimarrjen në shqyrtim; b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në

Së fundmi, subjektit i është kërkuar të shprehet lidhur me konfliktin e interesit, menjëherë pas shortimit të trupit gjykues, e po ashtu në seancë dëgjimore, por prej saj nuk është ngritur asnjë pretendim. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit kanë rënë në dekadencë sipas nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile.

15.3. Me aktet e dosjes gjyqësore me palë paditëse A. A., të cilësuar prej subjektit si motra e bashkëshortes së relatorit të trupit gjykues, subjekti kërkoj të provojë se relatori i çështjes nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk ka paraqitur dorëheqjen në momentin e rënies në dijeni, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 dhe 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9367/2005, nenit 27, paragrafët 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, relatori i çështjes, duke vënë në dijeni kunatën për rolin e tij në përbërjen e trupit gjykues, ka shkelur parashikimet e nenit 28, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke përbërë shkak për përgjegjësi disiplinore sipas nenit 16, pikat 1 dhe 10 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka përdorur funksionin e tij për t’u hakmarrë për vendimmarrjen e subjektit për pezullimin e këtij gjykimi deri në përfundim e gjykimit të një çështjeje tjetër, sipas kërkesës së palës së paditur, duke konsumuar edhe elementet e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

15.3.i Në kërkesën e paraqitur më datë 10.12.2021, lidhur me heqjen dorë të gjyqtarës [subjektit], nga gjykimi i çështjes, pala paditëse A. A. shprehet se: *nga biseda me të afërm të mi, është vënë në dijeni se gjyqtarja është shortuar për të kaluar procesin kalimtar të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe është duke u hetuar pranë komisionerit relator R. I., dhe në kushtet kur paditësja është një familjare e afërt e gjyqtarit R. I., vlerëson se në kuptim të nenit 72 të KPC, ka shkaqe që vlerëson se e pengojnë gjykimin e saj, nga sa kohë mund të jemi përpara kushteve të konfliktit të interesit. Në kushtet kur paditësja është vënë në dijeni rastësisht gjatë një bisede me familjarët e saj të afërt [...].* Në ankim, subjekti ka pasqyruar pjesë nga teksti i kërkesës, vendosur në thonjëza, çka presupozon që citimi të jetë literal, por rezulton të jetë shtuar *motra e bashkëshortes së relatorit I.* Përpos citimit jokorrekt të kërkesës, subjekti nuk parashtron se ku është referuar për ta cilësuar kërkuesen si *motra e bashkëshortes së komisionerit R. I.* Duke u kthyer te pretendimi i subjektit, prej saj nuk jepen shpjegime përse ajo, pas rënies në dijeni të kësaj rrethane, nuk e ka vlerësuar atë si shkak për pengesë ligjore për pjesëmarrjen e komisionerit R. I. në trupin gjykues që po kryente procesin e rivlerësimit të saj, dhe përse nuk ka kërkuar përjashtimin e tij¹¹. Fakti që pas datës 12.10.2021, subjekti nuk ka vijuar gjykimin e këtij procesi civil¹², tregon që rrethanat për të cilat ka rënë në dijeni rreth një vit përpara përfundimit të hetimit administrativ

shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim; [...] dh) ndaj nëpunësit publik ose personave të parashikuar në shkronjën “b” të këtij neni, ka nisur një proces gjyqësor nga palët në procedurën administrative në shqyrtim; [...] g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij, neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim”.

¹¹ Ligji nr. 44/2015, në nenin 30, “Pengesat ligjore”, në shkronjën “b” parashikon: “Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: [...] b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim [...]”; ndërsa në nenin 31, “Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim”, në pikën 3 parashikon: “Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtari të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja”.

¹² Subjekti nuk shprehet si dhe kur është disponuar kërkesa për dorëheqjen e saj, por nga kopja e kapakut të dosjes gjyqësore evidentohet se emrit të saj i është hequr vijë, dhe në krah është shënuar një emër tjetër. Gjithashtu, referuar datave të seancave gjyqësore, figuron e renditur edhe data 13.10.2021, që pason datën e kërkesës për heqje dorë të subjektit nga gjykimi i çështjes.

dhe dhënies së vendimit, vetë ajo nuk i ka çmuar si shkaqe për ekzistencë të konfliktit të interesit të komisionerit R. I. në raport me ushtrimin e detyrës, e kundërta do të dëshmohej nga njoftimi me shkrim i tyre për trupin gjykues, në ushtrim të detyrimeve të parashikuara në nenin 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016¹³.

15.3.ii. Lidhur me pretendimin e subjektit për mos respektimin e parimit të konfidencialitetit, nga leximi harmonik i parashikimeve të ligjit nr. 84/2016¹⁴ dhe të ligjit nr. 44/2015¹⁵, vlerësohet se dijenia për rolin e caktuar një anëtarit të trupës gjykuese të Komisionit, konkretisht të relatorit, nuk përfshihet në sferën e të dhënave, mbrojtja e të cilave garantohet nga parashikimet ligjore të mësipërme.

15.4. Në konsideratë edhe të qëndrimit të GjEDNj-së¹⁶ për detyrimin e subjekteve për të vepruar me kujdesin e duhur gjatë procedurave të brendshme, subjekti i rivlerësimit, duke mos ngritur në Komision asnjë pretendim lidhur me anëtarët e trupit gjykues, dëshmon se në qasje retroaktive, përpiqet të paraqesë një situatë të ndryshme nga ajo faktike, të cilën dështoi ta provojë me pretendimet dhe aktet shkresore të paraqitura me ankimin. Për rrjedhojë, aktet e sipërcituara të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, znj. Ariana Gumbardhi (Caco), për të provuar pretendime deklarative të saj lidhur me trupin gjykues të Komisionit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germat “a” dhe “c” e ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan të panevojshme dhe të papërshtatshme.

16. Lidhur me aktet e paraqitura me parashtrimet para seancës gjyqësore¹⁷, trupi gjykues vlerëson se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas

¹³ Ligji nr. 84/2016, në nenin 27, “Garantimi i paanësisë”, në pikën 3 parashikon: “3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short”.

¹⁴ Ligji nr. 84/2016, në nenin 28, “Kushtet për garantimin e besueshmerisë dhe konfidencialitetit”, në pikën 2 parashikon: “Anëtarit i institucionit të rivlerësimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare”.

¹⁵ Ligji nr. 44/2015, në nenin 8, të titulluar “Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit”, parashikon: “Pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

¹⁶ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 225 e vijues.

¹⁷ Bashkëlidhur parashtrimeve subjekti, ka paraqitur:

- (i) kontratë shitjeje nr. {***}, datë 08.08.2022 [sipas certifikatës së pronësisë, halla e subjektit, V. S., rezulton një prej 9 bashkëpronarëve të pasurisë objekt shitjeje];
- (ii) kontratë shitjeje nr. {***}, datë 22.09.2022 [sipas certifikatës së pronësisë, bashkëshorti i subjektit rezulton një prej 26 shitësve të pasurisë, çmim shitje 44.875.000 lekë];
- (iii) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 03.09.2022 [D. dhe I. G., dhe M. R. (nëna, vëllai dhe motra e b/shortit të subjektit), shprehin vullnetin që pjesa e tyre takuese e ngurtësuar në llogarinë e noteres, të transferohet në llogarinë e A. G.];
- (iv) vendim për lëshimin e trashëgimisë ligjore nr. {***}, datë 12.06.2023 [subjekti një nga dy trashëgimtarët ligjore të hallës së saj, V. S.];
- (v) prokurë e posaçme nr. {***}, datë 12.08.2023 [Z., M. M., dhe R. S. emërojnë përfaqësues av. A. G.];
- (vi) deklaratë noteriale nr. {***}, datë 09.08.2023 [R. S. (atësia Xh., amësia A.) deklaron se në periudhën 1991-2000, si administratore e pronave të familjes M., për llogari të familjes, ka paguar shumën 30.000 GPB tek administratori i Kompanisë “{***}”. Shuma e sipërcituar ka shkuar në vlerën 60.000 USD deri në vitin 2004, me kusht që të legalizohej kati shtesë i objektit në emër të saj. Deklaruesja heq dorë nga kjo kërkesë dhe deklaron që legalizimi të dalë në emër të gjithë bashkëpronarëve të familjes M.];

të cilave deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Megjithatë, trupi gjykues çmon të theksojë se edhe në prezumimin në favor të subjektit të rivlerësimit, se këto akte do të ishin në plotësim të kritereve ligjore të sipërcituara, përmes tyre provohen veprime juridike apo të ardhura të subjektit dhe të personit të lidhur, të ndodhura apo realizuara së fundmi, si të tilla pa vlerë provuese për situata faktike në kohën kur janë krijuar pasuritë objekt kontrolli. Fakti që subjekti në vitin 2015, ka vepruar si administratore e pasurive të hallës së saj, apo që është trashëgimtare ligjore e saj nga viti 2023, nuk ka asnjë relevancë lidhur me mundësitë financiare të subjektit për krijimin e pasurive, për sa në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike të pasurisë, subjekti nuk ka deklaruar se ka përfutur dhurata apo trajtime preferenciale nga halla e saj. Po kështu, fakti që në vitin 2023, nëna, vëllai dhe motra e bashkëshortit i lënë këtij të fundit në administrim pjesët takuese nga shitja e një prone, nuk mund të provojë, sikundër pretendon subjekti, që edhe në vitin 1997 të jetë vepruar në të njëjtën mënyrë.

17. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

B/1 Procedura e shortit e datës 16.12.2019

18. Sipas këndvështrimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), shorti i posaçëm dhe i veçantë i datës 16.12.2019, i organizuar nga Komisioni për shqyrtimin e çështjeve të subjekteve të rivlerësimit, ku përfshihet dhe ajo, nuk është i bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ndodhet në kushtet e përcaktuara në listën e përparësive për shkak të ligjit. Subjekti parashtrori se në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit”¹⁸, në nenin 15, pika 2, parashikohet: *radha e shqyrtimit të çështjeve është ajo e përcaktuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*,

(vii) deklaratë me shkrim dore e znj. R. D., datë 29.08.2023 [deklaron se në datë 29.08.2023 ka marrë nga A. G. shumën 12.500 USD, vlerë e qirave të dyqanit për periudhën gusht 2020 - gusht 2023];

(viii) prokurë e përgjithshme nr. {***}, datë 08.05.2015 [V. S. (halla e subjektit) emëron përfaqësuese të përgjithshme Arjana Gumbardhin];

(ix) kontratë depozitë bankare me Credins Bank, datë 12.10.2023 [për çelje të depozitës në shumën 65.000 euro, në emër të znj. Arjana Gumbardhi];

(x) nxjerrje llogarie, datë 12.01.2023 [RFZ Bank, llogari në emër të A. G.];

(xi) certifikata regjistrimi pronësie, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Korçë, në datë 03.10.2023, pronësi të fituara me dëshmi trashëgimie, me pjesë takuese të Arjana Gumbardhit: nr. pas. {***}- 2/24 pjesë; nr. pas. {***}- 1/12 pjesë; nr. pas. {***}2/24 pjesë; nr. pas. {***}2/24 pjesë; nr. pas. {***}-2/24 pjesë; nr. pas. {***}-2/24 pjesë;

(xii) pjesë të vendimit të KPK-së nr. 711, datë 01.11.2023, dhe mendimit të pakicës [që i përket subjektit të rivlerësimit B. M.];

(xiii) pjesë të analizës vjetore të vitit 2022 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁸ Miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.07.2017, të Komisionit.

ndërsa në rregulloren “Për procedurën e zhvillimit të shortit në KPK”¹⁹, në nenin 8 parashikohet: *Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen procedurat për organizimin e një shorti të veçantë dhe të posaçëm, pas rekomandimit me shkrim të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit brenda 30-ditëve nga marrja e këtij rekomandimi*²⁰. Subjekti potencoi se, sipas nenit B të Aneksit të Kushtetutës, ONM-ja nuk ka të parashikuar në detyrat e saj të rekomandojë organizimin e një shorti të veçantë dhe të posaçëm për subjektet e rivlerësimit dhe, referuar nenit 118 të Kushtetutës²¹, nenit 69 të ligjit nr. 84/2016²², pikës 8 të rregullores “Për procedurën e zhvillimit të shortit në KPK”, është e paligjshme, në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, nenin 4, pika 4, që përcakton rrethin e subjekteve që do të trajtohen me përparësi dhe short të veçantë.

18.1. Trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, çmon të theksojë se, referuar ligjit nr. 84/2016, nenit 63, pika 3, parashikohet se në ankimin në Kolegj ndaj vendimeve të Komisionit, nuk zbatohen rregullat për ankimin administrativ, parashikuar në nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative [në vijim ligji nr. 44/2015]²³. Komisioni ka publikuar në faqen zyrtare në internet²⁴ dhe ka njoftuar subjektin në rrugë elektronike për shortin e datës 16.12.2019, për shpërndarjen e çështjeve të miratuara me vendimin nr. 86, datë 25.11.2019, sipas pikës 8 të nenit 3 të rregullores “Për procedurën e zhvillimit të shortit në KPK”, si dhe për listën e 120 subjekteve të përfshirë në këtë procedurë, ku subjekti i rivlerësimit renditet me numër 41. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), nuk ka shfaqur pretendime për fillimin e procesit të saj të rivlerësimit. Nga procesverbali i seancës dëgjimore, konstatohet se gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit është shprehur: *[...] shorti i datës 16.12.2019 është në kundërshtim me nenin 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë i ka mohuar subjektit të rivlerësimit parimin e barazisë para ligjit [...], duke u shprehur se nuk po paraqet një kërkesë paraprake, por thjesht një konstatim. Në këtë situatë faktike, pretendimet e subjektit vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.*

18.2. Lidhur me pretendimet për rolin dhe detyrat e ONM-së në procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se parashikimet kushtetuese, të materializuara në

¹⁹ Miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019, të Komisionit.

²⁰ Rregullorja “Për procedurat e zhvillimit të shortit në KPK”, miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019, në nenin 8 të saj parashikon: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen procedurat për organizimin e një shorti të veçantë dhe të posaçëm”.

²¹ Neni 118 i Kushtetutës parashikon: “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte [...]”.

²² Neni 69 i ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] 3. Brenda 30 ditëve nga krijimi i institucioneve të rivlerësimit, mbledhja e anëtarëve të Komisionit, mbledhja e gjyqtarëve dhe mbledhja e komisionerëve publikë kanë detyrimin të miratojnë rregullat për veprimtarinë e institucioneve përkatëse të rivlerësimit. 4. Procedura për zhvillimin e shortit të përcaktuar në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, miratohet, sipas rastit, me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit ose të gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit”.

²³ Ligji nr. 44/2015, në nenin 128, “Legjitimimi dhe mjetet e ligjore administrative”, parashikon: “1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim. 2. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë. 3. Mjetet ligjore administrative janë: a) ankimi administrativ, i cili përfshin: i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës administrative (Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ); ose ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ); b) rishikimi. 4. Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje”.

²⁴ Shih: <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>.

dispozitat e ligjit nr. 84/2016, për të cilat është shprehur edhe Komisioni i Venecias²⁵, dhe i janë nënshtruar rivlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, përcaktojnë kompetencat e vëzhguesve ndërkombëtarë, duke konfirmuar pozitën e tyre si vëzhgues që garantojnë veçanërisht transparencën në proces, ndërkohë që vendimmarrja është tagër i organeve të pavarura të rivlerësimit. ONM-ja, si mekanizëm garantues ndërkombëtar, në ushtrimin e rolit të saj mbikëqyrës, të paanshëm dhe objektiv, në përputhje me normat kushtetuese dhe ligjore, strikte e të detajuara për procesin e rivlerësimit kalimtar, qëndron mbi palët në proces. Në vlerësim të rolit të ONM-së në proces, vetë Kolegji, lidhur me përcaktimin e radhës së shqyrtimit të çështjeve, ka parashikuar shqyrtimin me përparësi të ankimeve të Komisionerit Publik, me bazë rekomandimin e ONM-së²⁶.

18.3. Përpos sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimeve se përfshirja e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar është bërë sipas një rekomandimi të ONM-së, dhe se si pasojë e këtij rekomandimi, si subjekt i përfshirë në shortin e datës 16.12.2019, është paragjykuar duke nisur ndaj saj hetimin administrativ në cenim, sipas saj, të parimit të paanësisë dhe pavarësisë. Gjithashtu, në fashikullin e përcjellë nga Komisioni, nuk u evidentua asnjë e dhënë apo informacion lidhur me sa më sipër. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ.

19. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosanalizim të kërkesave paraprake në seancë dëgjimore, bazuar në dispozitat ligjore të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe paligjshmërinë e vendimeve të ndërmjetme për rrëzimin e tyre, trupi gjykues vlerëson si vijon.

19.1. Në seancën dëgjimore të datës 28.09.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tri kërkesa paraprake, dhe në ankim kundërshton vendimet e Komisionit për diponimin e dy prej tyre, respektivisht me objekt: (i) përjashtimin e komisioneres E. Ç. nga gjykimi i çështjes së saj, pasi është marrë si e pandehur nga SPAK për veprat penale të parashikuara nga nenet 257, shkronja “a”, pika 2 dhe 186 të Kodit Penal dhe çështja është dërguar për gjykim; (ii) për t’i bërë me dije emrat e këshilltarëve, atij ligjor (pasi nga lista e publikuar në faqen zyrtare të Komisionit në internet, me dy prej tyre është në konflikt interesi) dhe atij ekonomik, ky i fundit të thirret në seancë publike, të dëgjohet, t’i drejtohen pyetje prej subjektit, të japë mendim me shkrim në mënyrë analitike dhe jo një përmbledhje tabelare, të cilësuar si analizë financiare.

19.2. Kërkesa e parë e subjektit, e shqyrtuar nga një trupë tjetër gjykuese e Komisionit, zgjedhur me short, është rrëzuar me vendimin nr. {***}, datë 28.09.2022, duke vlerësuar se pretendimet e

²⁵ Shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e). Ndër të tjera, në paragrafin 73 të këtij opinioni, pasqyrohet se vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejta procedurale të rëndësishme dhe luajnë një rol të ngjashëm me atë të avokatit të përgjithshëm në Francë – një magjistrat i pavarur që përfaqëson interesin publik dhe këshillon gjykatën se si duhet zgjidhur rasti, por pa votuar për çështjen konkrete.

²⁶ Shih: https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/05/Rregullore_Per_veprimtarine_e-KPA_me_ndryshimet_e_vendimit_nr_47-dat%C3%AB-17.05.2023.pdf,

neni 20, “Përgatitja e çështjes për shqyrtim”, ku parashikohet: “I. Radha e shqyrtimit të çështjeve përcaktohet duke pasur në konsideratë përparësitë në procesin e rivlerësimit të përcaktuara nga Kushtetuta, ligji nr. 84/2016, ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe datën e regjistrimit të çështjes në Kolegji. Çështja që i përket ankimit të Komisionerit Publik, i cili është bërë mbi bazën e një rekomandimi të vëzhguesve ndërkombëtarë, do të shqyrtohet me përparësi, pavarësisht datës së regjistrimit në Kolegji”.

subjektit nuk gjejnë zbatim nën dispozitat ligjore dhe nuk përbëjnë shkaqe që mund të cenojnë paanësinë e komisioneres Ç. për të vazhduar procesin e rivlerësimit. Në këtë vendim të ndërmjetëm, është arsyetuar si vijon. Neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, i referuar si bazë ligjore nga subjekti, parashikon rastet e dorëheqjes së gjyqtarit kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie, dhe neni 74 i të njëjtit Kod parashikon paraqitjen e kërkesës. Nën leximin e këtyre dispozitave, përjashtimi nga procedura vendimmarrëse i atribuohet ekzistencës së një arsyeje serioze njëanshmërie, të vërtetuar, që në këtë rast nuk gjen zbatim. Fakti i hetimit të komisioneres nga struktura e SPAK-ut nuk krijon në vetvete një bazë të mjaftueshme që të ngrihet në nivelin e cenimit të këtij parimi, për sa jemi përpara fakteve: nuk provohen sjellje të komisioneres për anësi në çështjen e subjektit të rivlerësimit; dyshimet për paanshmëri duhet të jenë konkrete dhe objektive të justifikueshme, pasi e kundërta do të ishte po aq e dëmshme; zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë sipas nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale dhe vijimit të ushtrimit të detyrës prej komisioneres për vendimmarrje të subjekteve të rivlerësimit. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se në referim të nenit 42 të Kushtetutës dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, *çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafi 280, nuk mund të pretendohet se cenohet parimi i paanshmërisë kur një gjykatës ofron garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim.

19.3. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton vendimin e ndërmjetëm të sipërcituar, duke pretenduar se është një vendim i paarsyetuar, i pabazuar në ligj, duke anashkaluar qëllimisht bazën ligjore të kërkesës, alogjik, në kundërshtim me vendimmarrjen e trupave gjyquese të tjera të Komisionit, ku ka qenë i njëjti shkak, dhe ka cenuar të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor. Subjekti pretendon se dyshimi i saj për njëanshmëri është objektive të justifikueshëm, duke argumentuar se në interpretim të parashikimeve konventore, kushtetuese, të dispozitave procedurale të ligjit nr. 84/2016, që garantojnë në nivel kushtetues gjykimin e pavarur dhe të paanshëm, dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, një komisioner që është marrë i pandehur *për një krim të kryer me dashje*, nuk mund të vazhdojë të ushtrojë detyrën sepse, në këto kushte, qenia e tij i pavarur dhe i paanshëm nuk mund të garantohet²⁷. Subjekti argumenton se pretendimet e saj u provuan në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sa i përket pasurisë tokë *moçal*, të ndodhur në Tale, Lezhë, transaksioni i së cilës është quajtur fiktiv dhe është penalizuar subjekti, ndërkohë që vendimi i GJKKO-së nr. {***}, datë 16.09.2022, pavarësisht se e ka shpallur të pafajshme, ka konstatuar se komisionerja ka kryer kundërvajtje administrative pasi kontrata e kryer prej saj është fiktive.

19.3.1. Subjekti pretendoi se duke mos parashikuar të drejtën e ankimit në vendimin e ndërmjetëm, Komisioni ia ka mohuar këtë të drejtë, e në bazë të nenit 75, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, ankimon këtë vendim së bashku me vendim përfundimtar. Për sa dispozita që vetë subjekti referon, parashikon se ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar, theksuar edhe nga kryesuesja në seancë dëgjimore:

²⁷ Subjekti referon: nenet 42/2, 140, 179/b/6 të Kushtetutës, nenin C të Aneksit të Kushtetutës, nenet 6, 16, 17 dhe 27 të ligjit nr. 84/2016, vendimin e GjEDNj-së [*çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, Driza kundër Shqipërisë*], nenin 30 të K.Pr. Administrative, nenin 3 të ligjit nr. 9367/2005, nenin 72/6 të K.Pr. Civile, vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 5/2007, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2013, vendimin e Kolegjit nr. 15/2021 (JR), paragrafi 26.9 ku është analizuar: “Për pasojë, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, se faktet dhe rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit dhe se vlerësimi i kësaj situatë varet tërësisht nga bindja e brendshme e gjyqtarit, Kolegji konkludon referuar edhe qëndrimeve të mbajtura nga jurisprudenca e GjEDNj-së, për të vlerësuar paanshmërinë nuk mjafton vetëm verifikimi i testit subjektiv, por edhe atij objektiv, në të cilin në rastin konkret, mundej që subjekti të dështonte”.

[...] këto vendime, siç ju e dini mirë, janë objekt ankimi me vendimin përfundimtar²⁸, pretendimi i subjektit, përpos i pakuptimtë, vlerësohet i pabazuar.

19.4. Lidhur me pretendimin se kjo vendimmarrje është e paarsyetuar, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar, për sa rezulton se Komisioni ka analizuar situatën faktike bazuar në dispozitat ligjore të referuara. Subjekti pretendon se vendimmarrja vjen në kundërshtim me vendimmarrje të trupave të tjera gjykuese të Komisionit, po për të njëjtin shkak, pa identifikuar apo referuar të dhëna për këto vendime. Megjithatë, referuar disa vendimeve të Komisionit të publikuara në faqen e tij zyrtare në internet, evidentohet pranimi i kërkesave të subjekteve të tjera për përjashtimin e komisioneres E. Ç. për shkak të marrjes në cilësinë e së pandehurës në një proces penal²⁹. Këto vendime i përkasin periudhës përpara se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 16.09.2022, të shpallte të pafajshme komisioneren përkundrejt akuzave që rëndonin mbi të, dhe qëllimi i vendimmarrjes ka qenë ruajtja e besimit të publikut te drejtësia, për sa marrja si e pandehur e komisioneres mund të perceptohej se krijonte një konflikt interesi, të paktën në dukje me ushtrimin e detyrës. Kërkesa me të njëjtin objekt e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, është disponuar në datë 28.09.2022, në rrethana faktike të ndryshme, ku vendimi i gjykatës që shpallte të pafajshme komisioneren, ndonëse jo i formës së prerë, ishte indikator i rëndësishëm si për perceptimin publik, ashtu edhe për subjektet e rivlerësimit. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit se vendimi i Komisionit për rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e komisioneres vjen në kundërshtim me vendime të trupave të tjerë të Komisionit, për të njëjtin shkak, vlerësohet i pabazuar. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se vendimi nr. {***}, datë 16.09.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nga Gjykata e Lartë, dëshmojnë se pafajësia e komisioneres për akuzat që rëndonin mbi të, përbën *res judicata*, rrethana të cilat e bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit.

²⁸ Shih f. 3 të seancës dëgjimore të datës 30.09.2022.

²⁹ Shih: <https://kpk.al/www-content/uploads/2023/02/Vendim-A.-Y..pdf>;

<https://kpk.al/www-content/uploads/2022/08/Vendim-A.-A..pdf>;

<https://kpk.al/www-content/uploads/2022/10/Vendim-A.-Gj..pdf> .

Gjithashtu, vendimet e ndërmjetme të Komisionit janë bërë publike edhe në media, shih: <https://boldnews.al/2022/06/22/dokumenti-kpk-e-c.-cenon-besimin-e-publikut-por-vijon-detyren/>; <https://www.aksesdrejtesi.al/dokumenta/1686124840Vendim-A.-Gj..pdf>; duke pasqyruar përmbajtjen e tyre, ndër të tjera: “[...] Në kushtet kur komisionerja është marrë e pandehur nga një organ i drejtësisë së re, mund të perceptohet nga publiku si e papërshtatshme për të kryer procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por, nisur nga parimi i prezumimit të pafajësisë, trupi gjykues vlerëson se besimi i publikut nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për cnimin e së drejtës së komisioneres për t’u prezumuar e pafajshme deri në një vërtetim të së kundërtës. [...] nga njoftimi publik i bërë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, zonja Ç. është marrë e pandehur për veprën penale të parashikuar nga nenet 257/1/2/ dhe 186 të Kodit Penal. [...] në këto kushte, kur komisionere Ç., në kuadër të aktivitetit të saj profesional, do të duhet të vlerësojë deklarinimin dhe pasurinën e subjektit, duket sikur lind një konflikt në dukje, që bën të ngrihet një dyshim i arsyeshëm se kryerja e procesit të rivlerësimit të subjektit [...] nuk do të zhvillohet në përputhje me parimet e objektivitetit dhe paanësisë, pasi anëtarja e trupit gjykues mund të ndodhet në kushtet që do t’i duhet të krahasojë pozitën e saj me atë të subjektit. [...] Kjo lloj përplasje interesash mund të passjellë humbjen e besueshmërisë dhe kredibilitetit të institucionit, duke dëmtuar në tërësi procesin e rivlerësimit dhe besimin e publikut te drejtësia. Për pasojë, shumica e këtij trupi gjykues vlerëson se ndodhemi në kushtet kur konflikti i interesit, në mos faktik, të paktën në dukje, krijon premisat për përjashtimin e komisioneres nga procesi i rivlerësimit të subjektit [...]”.

19.4.1. Gjykata Kushtetuese, në të njëjtën linjë me GjEDNj-në³⁰, në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrim se, në kuptim të nenit 42, pika 2 e Kushtetutës, respektimi i parimit të paanshmërisë verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, si edhe testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim, ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm³¹. Subjekti parashtron se pretendimet e saj lidhur me anshmërinë e komisioneres Ç. u vërtetuan, pasi Komisioni ka quajtur fiktive transaksionet e bashkëshortit të saj lidhur me pasurinë tokë *moçal*, të ndodhur në Tale, Lezhë, duke penalizuar subjektin, ndërkohë që GJKKO, me vendimin nr. {***}, datë 16.09.2022, ka konstatuar se kontrata e kryer prej komisioneres është fiktive, por kjo përbën një kundërvajtje administrative dhe jo penale. Trupi gjykues vlerëson se ky argument nuk përbën shkak për të pretenduar anshmëri të komisioneres në kuptim të testit subjektiv, e për më tepër që veprimet fiktive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, janë vlerësuar me votë unanime nga Komisioni. Nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, duke kontrolluar testin objektiv dhe atë subjektiv në drejtim të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i vlerëson ato të pabazuara.

19.4.2. Përpos sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç., e ka paraqitur në seancën dëgjimore të datës 28.09.2022, pasi një ditë më parë është njohur përmes medias se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka marrë të pandehur dhe dërguar për gjykim komisioneren për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 186 të Kodit Penal. Zgjedhja e subjektit për të kërkuar përjashtimin e komisioneres pothuaj 10 ditë më vonë nga njoftimi në media, më datë 16.09.2022, i vendimit të gjykatës për shpallje të pafajshme të komisioneres, nuk duket të dëshmojë shqetësim real lidhur me paanshmërinë e komisioneres, në të kundërt, kërkesa do të ishte paraqitur bashkë me parashtrimet dhe provat për të përmbysur barrën e provës, për të shmangur pjesëmarrjen e komisioneres në vlerësimin e tyre. Për rrjedhojë, në të gjithë këndvështrimet, pretendimi i subjektit se rrëzimi i kërkesës së saj për përjashtimin e komisioneres E. Ç. ka cenuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor, vlerësohet i pabazuar.

19.4.3. Në përmbyllje, trupi gjykues çmon të theksojë se pranimi *a priori* që paraqitja e një kallëzimi penal ndaj një anëtari të organeve të rivlerësimit përbën arsye për fillimin e procedimit disiplinor dhe pezullimin e veprimtarisë së tij/saj, do të nxiste në mënyrë abuzive një fenomen negativ për vijueshmërinë e mirëfunksionimit të organeve të rivlerësimit, me pasojë në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për sa më lart, kërkesa e paraqitur prej subjektit për përjashtimin e komisioneres E. Ç., ndërkohë që komisionerja ishte shpallur e

³⁰ Shih vendimet e GjEDNj-së, ndër të tjera, çështjet *Mežnarić: kundër Kroacisë; Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë; Wettstein kundër Zvicrës; San Leonard Band Club kundër Maltës; Korzeniak kundër Polonisë; Tozicka kundër Polonisë.*

³¹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, nr. 38/2007; nr. 23/2008; nr. 11/2008; nr. 7/2008; nr. 10/2009; nr. 25/2011; nr. 47/2011; nr. 25/2013.

pafajshme me vendim gjyqësor, vlerësohet në kushtet e pabazueshmërisë për të integruar sa kërkuar prej nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile³², determinuese e kompromentimit të paanësisë së komisioneres për të ushtruar detyrën e saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson vendimin e Komisionit të drejtë, dhe pretendimet e subjektit, të pabazuara.

19.5. Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimi i ndërmjetëm i Komisionit nr. 5, datë 29.09.2022, për rrëzimin e kërkesës për komunikimin e emrave të këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë të çështjes, bërë me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor në bazë të parimeve të barazisë së armëve dhe të aksesit në gjykatë, është i pabazuar, me arsyetim të përciptë, alogjik, duke mos analizuar kërkesën e saj të bazuar në Kushtetutë, ligjin nr. 84/2016, ligjin nr. 9367/2005, trupi gjykues vlerëson si vijon.

19.5.1. Subjekti pretendon për konflikt interesi me dy prej këshilltarëve në listën e publikuar në faqen e internetit të Komisionit³³ dhe se të dy këshilltarët e përfshirë në procedurë, duhet të kishin shprehur *mendimin* e tyre sipas ligjit nr. 9367/2005³⁴ dhe sipas nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, që parashikon përjashtimin e nëpunësve dhe anëtarëve të organeve kolegjiale nëse përmbushen kushtet e parashikuara në germa “a-k”, ku nëpunës është çdo person që vepron në një procedurë administrative, duke nënkuptuar pozitë ose funksion që mund të ketë efekt apo ndikim në procedurë. Subjekti potencon se *nga informacionet e siguruara, dhe nga bindja e krijuar për shkak të mospërgjigjes së Komisionit, këshilltari ligjor që ajo pretendon se është në konflikt interesi, ka hartuar konkluzionet e hetimit paraprak.*

19.5.2. Kolegji ka mbajtur qëndrim lidhur me pretendime të subjekteve të rivlerësimit për mosbërjen me dije të emrave të këshilltarëve që angazhohen në çështjen përkatëse, duke vlerësuar: *Komisioni nuk ka detyrimin për t'i bërë të njohur subjektit këshilltarët ligjorë apo ekonomikë, pasi bazuar në nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016, ata janë nëpunës që ndihmojnë trupin gjykues në studimin dhe përgatitjen e çështjes, por nuk kanë asnjë kompetencë vendimmarrëse gjatë procesit të rivlerësimit*³⁵. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se ligji nr. 84/2016, në nenin 27, të titulluar “Garantimi i paanësisë”, parashikon detyrimin për deklarim dhe shmangie të konfliktit të interesit për shkaqe të përmendura në nenin 30 të ligjit nr. 44/2015 apo të ligjit nr. 9367/2005 vetëm për anëtarët e organeve të rivlerësimit. Në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, që rregullojnë në mënyrë shteruese lidhur me Njësinë e Shërbimit Ligjor, me rol ndihmës dhe këshillues, nuk parashikohet për deklarimin e konfliktit të interesit, për rrjedhojë pretendimet e

³² Kodi i Procedurës Civile, në nenin 72, të titulluar “Rastet për përjashtimin e gjyqtarit”, në pikën 6, parashikon: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [...] 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

³³ Subjekti ka pretenduar se nga lista e publikuar e këshilltarëve ligjorë, janë në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 3/1 i ligjit nr. 9367/2005, z. I. P. dhe znj. A. Sh.. I pari për shkak se është djali i ish-ministrit të Drejtësisë në periudhën 1996-1998, njëherazi anëtar i KLD-së, dhe me insistimin e tij KLD-ja ka proceduar me shkarkimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit. Subjekti ka paraqitur si provë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 15/1997, që sipas saj ka prishur vendimin e KLD-së dhe detyruar të rishqyrtonte çështjen, duke rikthyer në këtë mënyrë statusin e magjistratit, por që nuk u zbatua asnjëherë. Për këshilltaren tjetër ligjore, subjekti ka parashtruar si shkak miqësinë me të për një periudhë të gjatë kohe, dhe se ajo ka pasur avokat bashkëshortin e saj në çështjet gjyqësore të familjes së origjinës.

³⁴ Ligji nr. 9367/2005, në nenin 3, pika 1, parashikon: ““Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike”.

³⁵ Shih vendimin e Kolegjit nr. 13/2019, që i përket subjektit B. A., paragrafi 13.

subjektit për referim me analogji në ligjin nr. 98/2016³⁶, apo në nenin 30 të ligjit nr. 44/2015, për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, vlerësohen të pabazuara.

19.6. Subjekti pretendoi se kërkesa për të pyetur këshilltarin ekonomik në seancë është rrëzuar në mënyrë të paargumentuar dhe jologjike, duke u bazuar në parashikimet e nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Për këtë pretendim, subjekti referoi parashikimet e Kodit të Procedurës Civile duke argumentuar se: sipas nenit 224/a, analiza financiare e përgatitur prej këshilltarit ekonomik është provë e rëndësishme në lidhje me vendimmarrjen për kriterin e pasurisë; sipas nenit 224/b, eksperti jep mendim me shkrim, por mund të dëgjohet në seancë e pyetet nga gjykata; dhe sipas nenit 224/c, për këshilltarin ekonomik, si ekspert, shkaqet e përjashtimit janë të njëjtat si të gjyqtarit.

19.6.1. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton se analiza financiare, e hartuar në bazë të provave të administruara, dhe metodologjia i janë përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, me sqarimin se *kjo analizë është objekt ndryshimi në varësi të përgjigjeve të saj mbi rezultatet e hetimit*. Në ushtrim të të drejtave të saj, lidhur me analizën financiare, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në parashtrime, duke pretenduar për interpretim të gabuar të ligjit nr. 9844/2007³⁷, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5/2006, si dhe ka paraqitur provat që i ka çmuar të nevojshme, të cilat janë shqyrtuar nga trupi gjykues përpara seancës dëgjimore. Gjithashtu, shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit në seancë dëgjimore, janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues pas përfundimit të saj. Nga leximi harmonik i parashikimeve ligjore që rregullojnë lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore, nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, dhe ligjit nr. 44/2015 ku kjo dispozitë referon, e drejta e subjektit për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, garanton të drejtat për një zgjidhje efektive dhe proces kontradiktor. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit për prezencë në seancë dëgjimore të këshilltarit ekonomik, për kryerjen e një debati gjyqësor me të, vijnë në tejkalim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe të ligjit nr. 44/2015, e për rrjedhojë pretendimi se kjo kërkesë është rrëzuar në mënyrë të paargumentuar, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

20. Lidhur me pretendimet e subjektit për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak se gjykata nuk ka qenë e pavarur, e paanshme, dhe është krijuar në kundërshtim me ligjin, trupi gjykues vlerëson si vijon.

20.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), pretendoi se procesi i rivlerësimit të saj nuk u krye nga një *gjykatë e krijuar me ligj*, dhe mosrespektimi i garancive procedurale duke vepruar si *gjykatë e jashtëzakonshme*, tregon qartësisht se Komisioni nuk përmbush kriteret për t’u konsideruar “Gjykatë”³⁸. Referuar në kriteret e përcaktuara nga GjEDNJ-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, subjekti i rivlerësimit ngre pretendime lidhur me përfaqësimin e gjyqtarëve në Komision, garancitë ndaj presioneve të jashtme³⁹, kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse, mandatin e limituar, që sipas saj i bën anëtarët e trupit gjykues të Komisionit vulnerabël nga

³⁶ Ligji 98/2016, në nenin 34/7, parashikon: “Këshilltari ligjor dhe ndihmësmagjistrati u nënshtrihen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati”.

³⁷ Ligji nr. 9844/2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””.

³⁸ Subjekti referon vendimet e GjEDNJ-së Baka kundër Hungarisë, paragrafi 121; Paluda kundër Sllovakisë, par. 45.

³⁹ Subjekti, ndër të tjera, referon VKM-në nr. 813, datë 31.12.2018, lidhur me bonusin e qeverisë për anëtarët e organeve të rivlerësimit, si dhe lidhjen gjinore të znj. Q. me zv. kryeministren, e cila ka votuar në kushtet e konfliktit të interesit për zgjatje të mandatit të Komisionit dhe për shpërblimin për punë të mirë.

influenca politike dhe qeveritare. Këto pretendime lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, janë analizuar gjerësisht prej Kolegjit në jurisprudencën e tij⁴⁰, duke vlerësuar se *përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, si dhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë⁴¹, në konkluzionin se institucionet e krijuara për të kryer rivlerësimin përmbushin garantitë e sanksionuara nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj), për sa i përket gjykatës së krijuar me ligj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i konsideron këto argumente të ezauaruara, të trajtuara në detaj dhe të papranueshme.*

20.2 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se shkarkimi i saj nga detyra, krahas të tjerave, është rrjedhojë e drejtpërdrejtë edhe e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit që shqyrtuan çështjen e saj, në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Sipas saj, nuk janë respektuar kriteret strikte të përzgjedhjes, parashikuar nga ligji nr. 84/2016, të vlerësuara nga GjEDNJ-ja si garanci për pavarësinë dhe paanësinë e organeve të *vetting*-ut⁴², dëshmuar kjo edhe nga listat e dërguara nga Avokati i Popullit në Kuvend [mars 2017], dhe justifikimet e tij në shkresën nr. {***} prot., datë 17.07.2020⁴³, për kualifikim të kandidaturave që nuk plotësojnë kriteret ligjore. Subjekti pretendoi se dhënia e mundësisë për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm ligjor, ndryshimi nga lista e personave që nuk plotësojnë kriteret formale në listën e personave që plotësojnë kriteret formale, është bërë në kundërshtim me procedurën ligjore, procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të organeve të rivlerësimit është mbuluar me errësi, procedura para komisionit parlamentar *ad-hoc* dhe vendimmarrja e tij ka qenë formale, për sa Komisioni *me votë të cilësuar-barrierë e pakapërcyeshme* nuk mund të vendoste ndryshe nga sa propozuar, dhe se vendimi nr. {***}/2017 i Kryetarit të Kuvendit, që u ka dhënë mundësi kandidatëve të plotësojnë dokumentacionin jashtë afatit ligjor, është absolutisht i pavlefshëm, si i marrë jashtë kompetencave ligjore.

20.2.1. Subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të tre komisionerëve të trupës gjykuese të Komisionit që kanë gjykuar çështjen e saj, kërkesë të cilën u shpreh se e bazon në vendimin nr. 64, datë 30.04.2020, të Gjykatës Kushtetuese, dhe në vendimin e GjEDNJ-së çështja *Cani kundër Shqipërisë*. Pretendimet e subjektit lidhur me kushtet e zgjedhshmërisë së anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, fokusohen kryesisht në përvojën e punës, gradat a titujt shkencorë në fushën e së drejtës.

⁴⁰ Shih vendimet e Kolegjit, ndër tjerë, nr. 19/2022 (JR).

⁴¹ Vendimi i GjEDNJ-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 280-288.

⁴² Subjekti referon vendimin e GjEDNJ-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 284, 299, 300, 302, si dhe çështjen Gudmundur Andri Astradsson v. Iceland, paragrafi 98(64-69) [subjekti e citon këtë paragraf, të plotë, disa herë, 92, 116].

⁴³ Nga shkresa e referuar, subjekti citon: “[...] vetë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka pasur problematika [jo të vogla] për shkak të paqartësive të dispozitave kushtetuese, si nga përmbajtja e tyre, ashtu edhe procedurat e parashikuara në to. Afati 7-ditor është një afat tepër i shkurtër për të kryer një punë voluminoze, për të cilën kërkohet kohë dhe cilësi, kriteret janë të paqarta, nuk ka kohë për të kryer një vlerësim”.

20.2.2. Lidhur me pretendimet e subjektit për procedurat e emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, Kolegji⁴⁴ ka mbajtur qëndrim në shqyrtimin e ankimeve të subjekteve të tjera, dhe në të njëjtën linjë me GjEDNj-në⁴⁵, duke i analizuar dhe vlerësuar në disa këndvështrime, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, *çështjet Astradsson kundër Islandës dhe B. Cani kundër Shqipërisë*. Konkretisht, Kolegji ka vlerësuar si vijon: “[...] si obiter dictum, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’u nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve, edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t’i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë, do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja⁴⁶, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit”.

20.3. Lidhur me zgjedhshmërinë e komisionerit R. I., relator i çështjes, subjekti parashtrori se ka pasur rrethana penguese, të parashikuara në ligj, që lidhen me kriterin e integritetit, pastërtisë së figurës, e se është i varur politikisht. Konkretisht:

i. Në të kundërt nga vërtetimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. {***}, datë 09.02.2017, dorëzuar me dokumentacionin për aplikim, sipas të cilit: *nuk rezulton të ketë procedim penal të regjistruar ndaj tij*, rezulton se është hetuar në kohë të ndryshme, në dy procedime penale, dhe në datën e lëshimit të këtij vërtetimi, komisioneri ishte në dijeni për përmbajtjen e pavërtetë të tij⁴⁷. Subjekti pretendoi për shmangie nga komisioneri të të dhënave ndaluese në kuptim të nenit 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016⁴⁸, përfshirë kërkesën dhe formularin

⁴⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 43/2022(JR); nr. 3/2023 (JR); nr. 38/2023 (JR).

⁴⁵ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73; çështja Besnik Cani kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73, çështja Sevdari kundër Shqipërisë, paragrafi 109; çështja Admir Thanza kundër Shqipërisë, paragrafët 83- 84.

⁴⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582>, paragrafi 221.

⁴⁷ Subjekti referon se nga shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***} prot., datë 13.11.2020, rezulton se komisioneri është hetuar në kohë të ndryshme, në dy procedime penale: (i) nr. {***}, regjistruar në datë 08.04.2010, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe i pushuar nga Prokuroria më datë 06.01.2011; (ii) nr. {***}, regjistruar më datë 3.06.2016, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, dhe pushuar më datë 17.02.2017. Sipas subjektit, për sa rezulton se të hetuarve, përfshirë edhe komisionerin I., u është komunikuar vendimi i pushimit të procedimit penal nr. {***}/2016, presupozohet pas datës 17.02.2017.

⁴⁸ Ligji nr. 84/2016, në nenin 6, të titulluar “Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”, parashikon: “[...] d) ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose të mos ketë qenë subjekt i ndalimeve të

e vetëdeklarimit, ku nuk ka deklaruar masën “detyrim paraqitje”, vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër më datë 24.11.2016 në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2016, në fuqi në momentin e paraqitjes së dokumentacionit për kandidim, si dhe shmangie të përgjigjeve lidhur me to gjatë intervistimit.

ii. Sipas publikimeve në media dhe në shtypin e shkruar, ka qenë i renditur i pari në listën e kandidatëve për deputet të partisë “{***}”, fakt që tregon se është i varur politikisht dhe cenon parimin e pavarësisë së trupit gjykues të Komisionit.

iii. Në cilësinë e avokatit, titull i marrë në vitin 1997 dhe regjistruar si person fizik në QKB në vitin 2014, nuk ka faturuar shërbimin e tij me faturë tatimore, por ka paraqitur vërtetime të thjeshta, duke shmangur pagimin e detyrimeve tatimore.

20.3.1 Lidhur me parashtrimet e pasqyruara në nënpikat (i) dhe (iii) më sipër, subjekti nuk paraqiti dokumentacion, për rrjedhojë pretendimet e tij mbetën të paprovuara. Sa i përket parashtrimet të pasqyruar në nënpikën (ii), për të cilin gjithashtu subjekti nuk paraqiti të dhëna për të identifikuar publikimet në media të cilave u referohet, nga kërkimi në burime të hapura⁴⁹, rezultoi se për zgjedhjet për Kuvendin e vitit 2009, në listat e kandidatëve për deputet të Partisë “{***}” për qarkun Shkodër, në numrin rendor 2, figuron emri i kandidatit R. I.. Duke abstraguar nga pamundësia për të vlerësuar nëse emri në listë është ai i komisionerit, trupi gjykues sjell në vëmendje se kandidimi nën siglën e një partie politike nuk është pozicion drejtues në partinë politike, për pasojë nuk mund të pretendohet për cenim të kriterit të parashikuar në nenin 6, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016⁵⁰. Përpos sa më sipër, në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së: *Gjykata vëren se një palë në një proces gjyqësor, e cila ka dyshime për ligjshmërinë e emërimit të një gjyqtari që merr pjesë në seancën e çështjes së tij/saj, çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e parimit “të themeluar nga ligji” të asaj gjykate, përgjithësisht pritet t’i drejtojë ato pyetje përpara gjykatës dhe/ose të ndjekë çdo mjet tjetër efektiv të parashikuar nga ligji vendës teksa procesi është ende në pritje*⁵¹ – trupi gjykues çmon se ngritja e këtyre pretendimeve pas përfundimit të procesit në Komision, nuk përbën një mjet efektiv, dhe dëshmohet si një tjetër përpjekje e subjektit për të delegjitimuar procesin e saj të rivlerësimit.

20.3.2 Në përmbledhje të sa më sipër, pretendimet e ngritura nga subjekti lidhur me *gjykatën e krijuar me ligj*, për të cilat subjekti dështoi të provojë mospërmbushjen e kushteve ligjore të zgjedhshmërisë së anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, vlerësohen nga trupi gjykues i Kolegjit, të pabazuara. Pavarësisht sa më sipër, në konsideratë sa konstatuar nga GjEDNj-ja në vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për strukturën dhe rolin e përcaktuar të Kolegjit nga Kushtetuta dhe ligji, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se kontrolli nga Kolegji i vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, vlerësohet një garanci me efekt zgjidhjeje efektive shëruese të çdo defekti të pretenduar.

parashikuara në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

⁴⁹ Shih: https://fv.al/t/lista-e-plote-e-140-kandidateve-per-deputete-{***}.12730/.

⁵⁰ Ligji nr. 84/2016, në nenin 6, të titulluar “Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”, parashikon: [...] ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit [...].

⁵¹ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Sevdari kundër Shqipërisë*, paragrafët 110-113.

20.4 Duke parashtruar këndvështrimin e saj se përbërja e gjykatës nuk ka qenë e rregullt, subjekti pretendoi se e gjithë procedura e hetimit dhe gjykimin, të gjitha aktet/vendimet e prodhuara nga trupi gjykues i Komisionit, janë të pavlefshme, dhe kërkoi që të shpallen të tilla nga Kolegji. Sipas saj, për shkak se përbërja e gjykatës nuk ka qenë e rregullt, shkelja e rëndë procedurale e kryer nga Komisioni, hyn në rastet e parashikuara në nenet 53, shkronja “ç” dhe 54, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, nenin 467, paragrafi i parë, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, dhe kërkoi prishjen e vendimit të Komisionit dhe korrëgjimin e shkeljeve të rënda procedurale, duke e rigjykuar çështjen nga Kolegji, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

20.4.1 Trupi gjykues sjell në vëmendje që edhe nëse do të prezumoheshin të provuara pretendimet e subjektit, vendimi i Komisionit iu nënshtrua kontrollit shterues të kryer në Kolegji, të shtjelluar në detaj, në arsyetimin në vijim. Në këtë kontroll, trupi gjykues kreu verifikimin e të gjitha pretendimeve të subjektit dhe nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, edhe të pretendimeve në raport me analizën financiare, me të cilën subjekti është njohur përmes rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, e ka dhënë prapësimet e saj. Në përfundim, edhe për sa kërkimet dhe pretendimet e subjektit u gjetën të pabazuara, siç është arsyetuar më lart, trupi gjykues e refuzon kërkesën e subjektit për konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi dhe akteve të tjera nxjerrë prej të tij.

- 21** Subjekti i rivlerësimit pretendoi për parregullsi të procesit të rivlerësimit, në disa aspekte: (i) *shtrembërim me qëllim të fakteve, rrethanave e gjetjeve, mosanalizimin e provave të administruara, mosmarrje në konsideratë të provave të paraqitura dhe mospërcaktimit të drejtë të rrethanave për të cilat nuk janë pranuar provat e paraqitura;* (ii) *vendosje të barrës së provës në kundërshtim me ligjin;* (iii) *interpretim të gabuar ligjor të fakteve të paraqitura prej saj;* (iv) *kufizimit në seancën dëgjimore për t’u shprehur, shpërfillja për të dëgjuar shpjegimet e saj.*

21.1 Nga analiza e akteve të administruara në fashikuj dhe vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka bërë analizën e plotë të provave të përdorura për vlerësimin e pasurisë, duke cituar shpjegimet, pretendimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, dhe vlerësuar ato në tërësinë e rrethanave të çështjes, sikundër parashikon neni 51 i ligjit nr. 84/2016. Vendimi i Komisionit është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁵² dhe të GjEDNj-së që është shprehur se: *neni 6/1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, por kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument*⁵³. Lidhur me parashtrimet për *moskuptim apo mosdijeni të Kodit Civil në lidhje me kontratën e shkëmbimit, të administrimit të pronave, apo për padijeni totale të legjislacionit tatimor*, trupi gjykues sjell në vëmendje se çmuarja e provave dhe vlerësimi i tyre në tërësi me rrethanat faktike, jo në mënyrën e pretenduar prej subjektit dhe në favor të interesave të saj, nuk përbën shkak për të ngritur pretendimet si më sipër cituar. Në konsideratë të qëndrimit të GjEDNj-së: *gjykatat e brendshme kanë një marzh të caktuar vlerësimi, kur zgjedhin argumentet dhe vlerësojnë provat, është e detyrueshme për to të justifikojnë këto veprime duke i arsyetuar në vendim*⁵⁴ – në vendimin objekt ankimi ka një analizë të plotë të provave mbi të cilat bazohen konkluzionet e arritura, si edhe argumentim të shkaqeve për të cilat nuk janë vlerësuar pretendime apo prova të paraqitura prej subjektit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson totalisht të pabazuar pretendimin e subjektit se:

⁵² Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 19.3.2015, dhe nr. 26, datë 27.3.2017.

⁵³ Vendimi i GjEDNj-së në çështjen Garcia Ruiz kundër Spanjës.

⁵⁴ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Centro Europa SRL dhe Di Stefano kundër Italisë, 2012; dhe çështja Suominen k. Finlandës, 2003.

nga mënyra si janë analizuar provat, çështja e saj është paragjykuar vetëm për shkak të origjinës së saj dhe të bashkëshortit, nga shtresat e pasura. Një analizë e hollësishme lidhur me provueshmërinë e provave të paraqitura prej subjektit, do të kryhet gjatë analizimit të shkaqeve të ankimit lidhur me themelin.

21.2 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur barrë prove të paarsyeshme, joproportionale, joobjektive, në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenin 87 të ligjit nr. 44/2015.

21.2.1. Lidhur me sa parashtron subjekti në mbështetje të këtij shkak ankimi, *se duhet të “akuzohet” përpara se të “dënohet”, pra t’i kalojë barra e provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të Komisionit, ka si sanksion marrjen e një mase disiplinore, t’i komunikojë drejtpërdrejt kur krijon bindjen se subjekti nuk ka përmbushur një detyrim ligjor të caktuar, Kolegji ka mbajtur qëndrim në jurisprudencën e tij⁵⁵. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se qëllimi i rezultateve të hetimit është t’i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara kishin mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit në përfundim të fazës së hetimit administrativ kryesisht. Nga shqyrtimi i raportit për rezultatet e hetimit administrativ, konstatohet se, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën për situata të rezultuara, të cilat e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi qartësisht të lexueshme e të kuptueshme. Gjithashtu, nga parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, provat e paraqitura bashkëlidhur e ato në seancë dëgjimore, nuk rezultojnë asnjë paqartësi e subjektit lidhur me barrën e provës, për rrjedhojë për përgjegjësitë në rast të mos përmbysjes së saj.*

21.2.2. Lidhur me parashtrimet e tjera: *se në rezultatet e hetimit e as në vendim nuk është konkluduar se pasuria e subjektit është më e madhe se dyfishi i asaj të ligjshme, apo se pasaktësitë në deklaram kanë qenë me qëllim fshehje të pasurisë, e në këto kushte nuk kishte detyrim/barrë prove sipas parashikimeve të nenit D, pikat 4 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe se në përmbledhje të gjithë konstatimeve të njoftojë qartë shkeljen që mendon se është kryer prej subjektit, në mënyrë që subjekti të ushtrojë të drejtën që i njeh Kushtetuta për të provuar të kundërtën, për t’u dëgjuar e mbrojtur denjësisht e në mënyrë efektive, janë trajtuar gjerësisht prej Kolegjit në jurisprudencën e tij⁵⁶. Trupi gjykues, duke risjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se standardi i vendosur nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse, e vlerëson këtë pretendim të tejkalluar.*

21.3 Subjekti pretendoi se, për gjetjen kryesore për të cilën i është kaluar barrë prove, nga e cila burojnë gjetjet e tjera, *nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e realizuara nga puna e bashkëshortit, nuk është njoftuar se cili ishte dokumentacioni që duhet të kishte ruajtur subjekti, sa është afati i ruajtjes së tij e, për rrjedhojë, nuk përbën gjetje sipas parashikimeve ligjore. Sipas subjektit, për shkak të paafhtësisë së institucioneve për të ruajtur*

⁵⁵ Shih vendimet e Kolegjit nr. 1/2019 (JR), nr. 2/2019 (JR), nr. 5/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR), nr. 2/2020 (JR), nr. 3/2020 (JR), nr. 6/2020 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), nr. 22/2021 (JR), nr. 26/2021 (JR), nr. 28/2021 (JR), nr. 31/2021 (JR), nr. 3/2022 (JR), nr. 5/2022 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁵⁶ Shih vendimet e Kolegjit nr. 19/2019 (JR); nr. 19/2022 (JR).

dokumentacionin e përpara vitit 2003, si e vetmja mundësi që të provonte të kundërtën e barrës së provës, do të ishte prezumimi i pamundësisë objektive për të pasur dokumentacionin e kërkuar.

21.3.1. Trupi gjykues, së pari çmon të sjellë në vëmendje se normat kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në themel të tyre përcaktojnë barrën e provës për subjektin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, për rrjedhojë, pretendime të ngritura *a priori* lidhur me paraqitje të dokumentacionit justifikues ligjor, vijnë në mospërputhje të hapur me detyrimet e buruara nga ky proces, të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, i është nënshtruar me vullnetin e saj. Si subjekt deklarues prej vitit 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. “9049/2003”), subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarin të pasurive të akumuluar në vite dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive, të saj dhe personave të lidhur⁵⁷. Nën përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të dispononte dokumentacionin justifikues të pasurive dhe burimeve të krijimit, të saj dhe të personit të lidhur, si detyrim i pandërvarur nga ushtrimi apo jo i një kontrolli të plotë nga ILDKPKI-ja ndaj deklarimeve të saj. Në këtë kontekst, dhe në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, trupi gjykues sjell në vëmendje se detyrimi për deklarin dhe provimin e burimeve të ligjshme, i subjektit dhe personave të lidhur, i parashikuar me ligjin nr. 9049/2003, ka të njëjtin rregullim edhe në ligjin nr. 84/2016, nenin 30 të tij, ku parashikohen të njëjtat nivele kontrolli, si për subjektin, ashtu edhe për personat e lidhur⁵⁸. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për pamundësi objektive për të pasur dokumentacionin e kërkuar, vlerësohen nga trupi gjykues, të pabazuara.

23.4. Subjekti pretendoi për paragjykim të çështjes nga momenti i përpilimit të rezultateve të hetimit administrativ, pasi me një arsyetim qesharak dhe dashakeqës, nuk i janë njohur të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit, të familjeve të origjinës, trashëgimia ligjore e bashkëshortit në qytetin e Vlorës. Sikundër do të analizohet gjerësisht në vijim, subjekti ka ngritur pretendime për të ardhura të familjeve të origjinës, si burim krijimi i pasurive nën hetim, në parashtrimet e paraqitura, lidhur me raportin për rezultatet e hetimit kryesisht. Për rrjedhojë, në këtë raport nuk mund të gjenin pasqyrim shpjegime të dhëna prej subjektit në një fazë të mëvonshme. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit dhe trashëgiminë e tij ligjore, në raport pasqyrohen gjetje për të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës, dhe pasi subjekti është dëgjuar, janë analizuar dhe vlerësuar provat e paraqitura, vlerësimi përfundimtar është atribut i vendimit të Komisionit në përfundim të procedurës administrative. Sa më sipër, pretendimet e subjektit për paragjykim të çështjes në fazën procedurale të përfundimit të hetimit administrativ kryesisht, vlerësohen të pabazuara dhe si përpjekje për të delegitimuar procesin e saj të rivlerësimit.

23.5. Subjekti pretendoi se: *në themel të vendimit, janë vendosur fakte dhe shkaqe për të cilat nuk i ka kaluar barra e provës, që kanë të bëjnë me pronësinë mbi një moçal të ndodhur në Tale, Lezhë, në pronësi të bashkëshortit.* Nga aktet në fashikuj, konstatohet se me pyetësonin 2, subjekti i janë kërkuar shpjegime nëse kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie dhe çmimi janë fiktivë, për sa në këtë kontratë, krahas çmimit të shitjes së pasurisë, pasqyrohej se likuidimi është bërë në bazë të kontratës së porosisë, dhe kontratës shtesë të saj, akte sipas të cilëve bashkëshorti i subjektit

⁵⁷ Ligji nr. 90/49/2003, në nenin 1, “Qëllimi”, parashikon: “Qëllimi i këtij ligji është kontrolli i pasurisë, i legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, i detyrimeve financiare për subjektet deklaruese, familjarët e tyre dhe të personave të lidhur me ta”.

⁵⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 5/2023 (JR).

kontraktohej për ofrimin e shërbimeve si avokat, dhe shpërblimi për punën e tij përcaktohej pikërisht kjo pasuri, me të njëjtën sipërfaqe dhe vendndodhje. Pas deklarimeve, shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ, në raportin për rezultatet e këtij hetimi, Komisioni konstaton: (i) kontrata e shitblerjes është nënshkruar për efekt të regjistrimit të pasurisë në ZVRRP Lezhë; (ii) bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e avokatit, nuk rezulton të ketë dokumentuar me faturim shërbimin e ofruar ndaj bashkëpronarëve, dhe ka kërkuar prej subjektit të sqarojë nëse për shërbime të avokatisë të kryera nga viti 2008 e në vazhdim, është lëshuar faturë dhe a është paguar tatimi sipas legjislacionit në fuqi. Sa më sipër, duket se pretendimi i subjektit qëndron, por fakti që Komisioni nuk është shprehur për *barrë prove*, nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia për të dhënë shpjegime e paraqitur prova për të provuar të kundërtën e sa konstatuar.

23.6. Sa i përket pretendimit të subjektit për *barrë prove të panevojshme lidhur me blerjen e makinës në vitin 2006, pasi ky vit financiar është me balancë pozitive*, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar. Në funksion të procesit të rivlerësimit për verifikimin e ligjshmërinë e pasurisë, objekt kontrolli janë burimet e deklaruara të krijimit të saj. Fakti që kjo pasuri është krijuar në një vit që ka rezultuar me balancë pozitive, nuk përbën shkak për të pretenduar se barra e provës lidhur me krijimin e saj, ka qenë e panevojshme, për sa për burimin e deklaruar – të ardhurat e bashkëshortit – subjekti ka dështuar të provojë se janë paguar detyrimet tatimore. Për më tepër, kjo pasuri është blerë më datë 28.07.2006, për rrjedhojë referimi në të ardhurat e të gjithë vitit nuk është relevant.

23.7. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se meqenëse procesi i rivlerësimit kalimtar është proces disiplinor, atëherë gjejnë zbatim të gjitha parimet e nenit 100, “Parimet e procedimit disiplinor”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër to parimet e prezumimit të pafajësisë dhe dyshimit në favor të magjistratit. Sipas subjektit, mbi të njëjtin konkluzion dhe logjikë arsyetimi, Komisioni i Venecias ka theksuar se: *Nisur nga ngjashmëria midis procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe procedimit penal, parimi procedural penal i parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore dhe interpretimit të ngushtë të tyre (moslejimi i interpretimit me analogji) zbatohet mutadis mutandis edhe në procedimin disiplinor*⁵⁹. Trupi gjykues sjell në vëmendje se kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit i është nënshtruar ekspertizës së Komisionit të Venecias⁶⁰, vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese⁶¹, dhe zbatimi në praktikë i tij nga organet e rivlerësimit ka kaluar testin e GjEDNj-së përmes disa vendimeve të saj për çështje të këtij procesi⁶². Normat kushtetuese, të materializuara në ligjin nr. 84/2016 lidhur me kontrollin dhe deklarimin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit, zbatohen në mënyrë autonome e, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për referim me analogji në kuadrin penal, vlerësohet prej trupit gjykues, i pabazuar.

23.8. Lidhur me pretendimin se: *në mosrespektim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për të zhvilluar një hetim të plotë mbi bazën e debatit gjyqësor efektiv, bazuar në ballafaqimin e pretendimeve të subjektit me provat përkatëse, se në seancën dëgjimore është vënë re qartë njëanshmëria pasi trupi gjykues është paraqitur pa dosjen ku ishin administruar provat e saj, por u mjaftuan me relatimin e konkluzioneve të hetimit*, trupi gjykues sjell në vëmendje se ligji nr. 84/2016 rregullon në mënyrë shteruese, në disa dispozita të tij, për kryerjen e hetimit administrativ

⁵⁹ Subjekti i referohet opinionit nr. 789, datë 15.12.2014, të Komisionit të Venecias (*Amicus Curia për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë*).

⁶⁰ *Opinion CDL - AD (2016)*.

⁶¹ *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017.*

⁶² *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 306.*

kryesisht dhe zhvillimin e seancës dëgjimore. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, subjekti vetë dhe përmes përfaqësuesit të saj, krahas shpjegimeve të detajuara lidhur me rezultatin e hetimit administrativ, ka kundërshtuar drejtpërdrejt gjetjet e Komisionit, ka depozituar prova të reja për të përmbysur barrën e provës, si dhe u është përgjigjur të gjitha pyetjeve të adresuara, duke kontribuar në efektivitetin e seancës dëgjimore dhe në hetimin e plotë të rrethanave prej Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk gjen asnjë shkak që të mbështesë pretendimet si më lart cituar, prandaj i vlerëson ato të pabazuara.

24. Lidhur me pretendimin e subjektit për shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, për shkak të mosrespektimit të ligjit, të parimeve të sigurisë juridike, diskrecionit, proporcionalitetit dhe objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, *së pari* trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se neni 7 i KEDNj-së zbatohet në të drejtën penale, ndërsa procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka natyrë administrative sipas parashikimeve të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë rregullat dhe parimet e zhvillimit të tij. Për rrjedhojë, vlerësimi i gjetjeve nga hetimi administrativ në kuadër të vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit dhe i tërë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, nuk u nënshtrohet standardeve të drejtësisë penale. Në të njëjtën linjë, GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit nuk përbën proces penal, bazuar në ligjin mbi të cilin mbështetet, natyrën e veprimeve të marra në analizë, subjektet të cilat i nënshtrohen dhe seriozitetin e sanksionit⁶³. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, gjenden të pabazuara në ligj.

24.1. Lidhur me pretendimin për mosrespektim të parimit të sigurisë juridike, subjekti parashtrohet se për shkak të pozicionit të gjyqtarit, ajo nga viti 1994 e në vazhdim, dhe bashkëshorti deri në vitin 1996, kanë qenë subjekte të deklarimit të pasurisë sipas ligjit nr. 7903, datë 08.03.1995, kanë kryer deklarimin sipas formularëve përkatës, për mbledhjen dhe administrimin e të cilëve ngarkohej ILDKPKI-ja me dispozitat kalimtare të ligjit nr. 9049/2003. Në vijim, subjekti parashtrohet se: *Komisioni në mënyrë të qëllimshme arsyeton se deklarimi i pasurisë për herë të parë është kryer në vitin 2003, për sa ka sqaruar se deklarimi i parë prej saj dhe bashkëshortit, në ushtrim të detyrës së gjyqtarit, është kryer në vitin 1995, bazuar në ligjin nr. 7903/1995, dhe se ndodhet në pamundësi objektive për të siguruar këtë dokumentacion, sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe Vlorë me kërkesë për të tërhequr kopje të deklaratave të saj dhe të personit të lidhur, por institucionet nuk e disponojnë këtë dokumentacion.*

24.1.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje se ligji nr. 9049/2003, me hyrjen e tij në fuqi, në nenin 6, të titulluar, “Deklarimi i parë”, parashikon se: *Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre, dhe në nenin 22, “Deklarimi i pjesëtarëve të familjes”, parashikon detyrimin për deklarim veçmas nga çdo pjesëtar i familjes të pasurive të ndara dhe të regjistruara si të tilla. Sa më sipër, ligji i ri nr. 9049/2003, duke përcaktuar si të parë deklarimin që kryhet në bazë të tij, parashikoi detyrimin për deklarim të gjithë pasurive të akumuluar. Thënë ndryshe, subjektet deklaruese kishin detyrimin që të kryenin deklarim të parë, pavarësisht deklarimeve të kryera në bazë të ligjit nr. 7903/1995, të shfuqizuar së bashku me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, që në këtë kuptim kishte lënë pa fuqi edhe deklaratimet e bëra në bazë të tij. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka*

⁶³ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafin 241 e vijues.

selektuar opsionin e deklaramit *për herë të parë*, çka dëshmon qartësinë e saj lidhur me rregullimet e ligjit nr. 9049/2003, në përmbushje të detyrimeve të të cilit kryhej ky deklaram. Duke sjellë në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ku gjykata ka vlerësuar se *pas hyrjes në fuqi të ligjit për deklaramin e pasurive në vitin 2003, sipas nenit 6, gjyqtarëve dhe prokurorëve iu kërkua të kryejnë deklaramin fillestar të pasurisë*⁶⁴, pretendimet e subjektit *për arsyetim në mënyrë të qëllimshme të Komisionit se deklarami i pasurisë për herë të parë është kryer në vitin 2003*, vlerësohen nga trupi gjykues, të pabazuara.

24.1.2. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, deklaram i parë sipas ligjit nr. 9049/2003, subjekti deklaron vetëm pjesën takuese të apartamentit me sipërfaqe 40 m², në Tiranë, në bashkëpronësi me anëtarët e familjes së origjinës. Në këtë deklaratë, subjekti nuk e deklaron bashkëshortin si pjesëtar të familjes me pasuri më vete, për sa nga shkresa e Raiffeisen Bank vërtetohet se dy prej depozitave në emër të tij, të hapura në vitin 1998, janë mbyllur në korrik 2004. Për rrjedhojë, pretendimi se si subjekte të deklaramit të pasurisë sipas ligjit nr. 7903, datë 8.3.1995, “Për deklaramin e pasurisë të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, prej saj dhe bashkëshortit janë kryer deklaramet sipas formularëve përkatës, edhe për sendet me vlerë të trashëguara, të konvertuara më vonë në tregun e lirë, e të depozitura në llogari bankare në emër të bashkëshortit nga viti 1997, mbetet deklarativ dhe i paprovuar. Në këtë situatë faktike, përmirësimi i kuadrit ligjor të deklaramit dhe kontrollit të pasurive në kuadër të frytshmërisë së luftës kundër korrupsionit, nuk përbën shkak për të ngritur pretendime për cenim të parimit të sigurisë juridike. Përpos kësaj, për sa deklarami i parë i subjektit dhe i personit të lidhur nuk është në përmbushje të detyrimeve të buruara nga ligji nr. 9049/2003, nuk ka shkak ligjor për të ngritur pretendime për pamundësi objektive sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar si dokumentacion provues, formularët e deklaramit të pasurisë në bazë të ligjit të mëparshëm.

24.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se shpenzimet e jetesës janë llogaritur në metodologji të përcaktuar nga ILDKPKI-ja, dhe në vështrim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 dhe të ligjit nr. 9049/2003, nuk ka asnjë parashikim për llogaritjen e tyre. Sipas subjektit, është shkelur parimi i sigurisë juridike, vendimmarrja e Komisionit është subjektive, pasi mungon ligji për referim. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 nuk rezultojnë t’i kenë dhënë të drejtën Komisionit të ushtrojë diskrecion në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas vlerësimit të tij, Komisioni do të kishte të drejtë të ushtronte parimin e diskrecionit vetëm në rastet e parashikuara në nenin 11 të ligjit nr. 44/2015⁶⁵, të cilat janë kumulative.

24.2.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vendim, i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit analizën financiare dhe metodologjinë e përdorur, si dhe standardet mbi të cilat bazohet llogaritja e shpenzimeve të jetesës⁶⁶. Komisioni ka shpjeguar se shpenzimet e jetesës janë përllogaritur bazuar në ato mujore për konsum, sipas madhësisë së familjes, anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-

⁶⁴ *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 201.*

⁶⁵ *Ligji nr. 44/2015, në nenin 11, “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”, parashikon: “Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe; ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.*

⁶⁶ *Shih raportin e Komisionit për rezultatet e hetimit administrativ, faqet 4, 26-32, dhe vendimin e Komisionit, faqet 10, 38-46.*

i, ndërsa për periudhën para vitit 2000, është zbatuar orientimi i Kolegjit, sipas vendimit nr. 15, datë 18.06.2021. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, shpenzimet e jetesës të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emërues i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, dhe përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste⁶⁷. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se është subjektive marrja për bazë e të dhënave nga INSTAT-it për nivele mesatare shpenzimesh, apo se janë realizuar vendimmarrje subjektive, të ndryshme, bazuar në rrethana të ngjashme dhe metodologji të ndryshme, vlerësohen prej trupit gjykues, të pabazuara.

24.3. Subjekti pretendoi për mosrespektim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke parashtruar se nuk është marrë për bazë vit pas viti struktura e buxhetit të familjes, sipas INSTAT-it, duke llogaritur më vete zëra të përfshirë në të, si: mobilimi, arsimit dhe ushqimi; nuk verifikohet si janë nxjerrë shpenzimet e jetesës për vitin 2000-2001; analiza financiare duhet të ishte krijuar si provë nga ekspertë të fushës ekonomi-kontabilitet, në përputhje me nenin 224, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile⁶⁸, nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, dhe nenin 80 të ligjit nr. 44/2015, dhe se në vendim nuk është arsyetuar fare lidhur me shpenzimet e jetesës, nuk gjen pasqyrim një analizë e re financiare, në rast se është bërë, duke bërë të vështirë realizimin e një mbrojtjeje efektive.

24.3.1 Me argumentin se Njësia e Shërbimit Ligjor nuk mund të kryejë vlerësime për fakte dhe rrethana që kërkojnë njohuri të posaçme, dhe se në varësi të Komisionit kjo strukturë nuk ka status të pavarur dhe të paanshëm si eksperti i pavarur, subjekti i rivlerësimit pretendoi për papërdorshmërinë e analizës financiare të Komisionit. Trupi gjykues sjell në vëmendje se ligji nr. 84/2016 parashikon rregulla të qarta e shteruese lidhur me studimin e dosjes së subjektit të rivlerësimit nga pikëpamja financiare/ekonomike. Gjithashtu ky ligj, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve përzgjedhëse për këshilltarin ekonomik, ka garantuar profesionalizmin e tij, me rol ndihmës dhe këshillues pranë organeve të rivlerësimit. Përpos sa më sipër, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe mbi bazën e parimeve që i garantojnë subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë, pretendimi lidhur me statusin e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është i pakuptimtë dhe i pabazuar dhe pretendimi për papërdorshmërinë e analizës financiare të Komisionit, vlerësohet nga trupi gjykues i papranueshëm.

24.3.2 Në vendimin objekt shqyrtimi, rezulton se, në vlerësim të provave të paraqitura prej subjektit në përmbyse të barrës së provës, në analizën financiare janë përfshirë paga të subjektit për vitet 1994, 1997, 1998; paga të bashkëshortit të saj të muajve gusht 2000, dhe janar-mars 2006; të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 1.2.2008 e në vijim, si avokat i shoqërisë “{***}” ShPK. Gjithashtu, është pasqyruar analiza e hartuar sërish për periudhën 1993-2002 dhe periudhën 2003-2016⁶⁹, si dhe *metodologjia e përdorur dhe problematikat*⁷⁰. Për sa më sipër, pretendimet e

⁶⁷ Shih vendimet e Kolegjit, ndër të tjerë, nr. 29/2020 (JR); nr. 31/2023 (JR).

⁶⁸ K.Pr. Civile, në nenin 224/a parashikon: “Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkojnë njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë. Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod”.

⁶⁹ Shih faqet 39-40 të vendimit të Komisionit.

⁷⁰ Shih faqet 41-46 të vendimit të Komisionit, ku analiza është strukturuar si vijon: a) gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur nxjerrë nga dokumente bankare; b) të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe të

subjektit lidhur me mosanalizim të pretendimeve e provave të saj, se nuk është arsyetuar fare lidhur me shpenzimet e jetesës, se nuk gjen pasqyrim një analizë e re financiare, apo për vështirësi në realizimin e një mbrojtjeje efektive, vlerësohen të pabazuara. Nën dritën e parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, kërkesa e subjektit *për marrjen si provë akt ekspertimi financiar nga ekspert i pavarur dhe i paanshëm, t'i vihet në dispozicion kopja formale dhe joformale e tij, metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve, dhe për dhënie kohe të nevojshme për ta kundërshtuar*, vlerësohet e pabazuar, dhe referimi për këtë kërkesë në vendimin 12/2003 të Gjykatës Kushtetuese⁷¹, pa relevancë.

24.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se është cenuar parimi i kontradiktoritetit, barazia e armëve dhe aksesit në gjykim, për shkak të vendimmarrjeve të Komisionit për kërkesat e paraqitura prej saj në gjykim, dhe të shkeljes së parimit të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore.

24.4.1 Lidhur me pretendimet për vendimmarrjet me të cilat janë disponuar kërkesat e saj në seancë dëgjimore, analizuar në detaje në paragrafin 19 e nënparagrafët e tij, janë vlerësuar prej trupit gjykues të pabazuara. Sa i përket pretendimit për *kufizim të kohës në dispozicion në seancë dëgjimore*, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore dhe regjistrimit audio të saj, trupi gjykues konstaton se subjekti, vetë dhe përmes përfaqësuesit të saj, ka dhënë shpjegime për të gjitha çështjet që i ka vlerësuar të nevojshme. Ndërhyrjet e kryesueses duke kërkuar fokusimin në barrën e provës në funksion të efikasitetit të seancës, dhe shmangie të shpjegimeve pa lidhje me procesin e rivlerësimit, nuk vlerësohen si cenim i të drejtave të subjektit për t'u dëgjuar⁷². Duke sjellë në vëmendje parashikimin e nenit 55, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, *për të kufizuar në mënyrë të arsyeshme kohën e parashikuar për t'u shprehur nga ana e subjektit të rivlerësimit*, në situatën faktike ku shpjegimet e çmuara të nevojshme ishin paraqitur në formë shkresore në prapësimet e saj prej 70 faqesh, kufizimi i kohës në kontekst të detajimit të panevojshëm e pa relevancë, vlerësohet i bazuar. Përpos sa më sipër, në aspekt të kohëzgjatjes së seancës dëgjimore, pretendimet e subjektit si më sipër cituar, vlerësohen nga trupi gjykues, të pabazuara.

25. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, tërësisht alogjik, në kundërshtim të hapur me ligjin material dhe procedural, që tregon për mungesë të theksuar profesionalizmi ose në rastin më të keq, dhënien e tij në shkelje të ligjit dhe në shpërdorim të detyrës, nuk iu është dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej saj në prapësime, nuk është analizuar asnjë provë e paraqitur, nuk është trajtuar fare analiza financiare në lidhje me të ardhurat, duke e bërë vendimin të paarsyetuar e, për rrjedhojë, të pavlefshëm. Në përmbyllje, për sa parashtruar, subjekti pretendoi se vendimi i Komisionit duhet deklaruar si i pavlefshëm nga Kolegji.

bashkëshortit të saj; c) shpenzimet; ç) vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve.

⁷¹ Nga vendimi 12/2003 i Gjykatës Kushtetuese, subjekti i rivlerësimit referon paragrafin: “U vërtetua se Gjykata e Apelit Korçë, gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ka lejuar disa shkelje të rëndësishme procedurale. Ajo ka marrë përsipër rolin e ekspertit duke vlerësuar si të zënë truallin e paditësve në kushtet, kur sipas nenit 135 të Kushtetutës, gjykatat janë organe të pushtetit gjyqësor dhe si të tilla nuk mund të kryejnë detyra jashtë veprimtarisë gjyqësore. Proceduralisht, ekspertët thirren nga gjykata për sqarimin e fakteve për të cilat kërkohen njohuri të posaçme. Çështja e përcaktimit të llojit të truallit objekt konflikti, është e tillë që gjykata e apelit zgjidhjen e saj nuk duhet ta bënte vetë, por të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi të ri”.

⁷² Shih f. 14, 15, 23, 24, 26, 36, f. 48 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

25.1. Trupi gjykues konstaton se pretendimet lidhur me arsyetimin e vendimit prej Komisionit, apo mosanalizim të provave të paraqitura prej saj, janë të pabazuara. Në një linjë me qëndrimin e GjEDNj-së⁷³, në kontekst të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, Kolegji në jurisprudencën e tij ka trajtuar gjerësisht pretendime të subjekteve lidhur me çmuarjen prej Komisionit të provave të paraqitura nga subjektet e rivlerësimit⁷⁴. Edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco), nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi dhe akteve në fashikuj, konstatohet që në vendim janë pasqyruar deklaratimet, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, të vlerësuara duke çmuar vlerën provuese të tyre përkundër ndikimit mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative⁷⁵. Për secilën pasuri objekt kontrolli, është konkluduar duke cituar dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur përfundimi i arritur. Fakti që Komisioni nuk i ka vlerësuar provat e subjektit në mënyrën e dëshiruar prej saj, duke konkluduar që subjekti ka dështuar të përmbysë barrën e provës, nuk përbën shkak për të pretenduar *a priori* se ka munguar vlerësimi lidhur me provat, apo se Komisionit i ka munguar profesionalizimi. Për rrjedhojë, pretendimet se vendimi ka mungesë të plotë të arsyetimit, se nuk është trajtuar fare analiza financiare, ndërkohë që ajo rezulton si pjesë integrale e vendimit, me nënpjesët përkatëse lidhur me metodologjinë e përdorur, problematikat lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, lidhen me vlerësimin që Komisioni u ka bërë fakteve dhe rrethanave të provuara në raport me kërkesat ligjore e, si të tilla, vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.

25.2 Në shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, si dhe në ato lidhur me themelin, subjekti, duke ritheksuar pretendimet *sa i përket gjykatës së krijuar me ligj*, kërkon shpalljen të pavlefshëm të vendimit të Komisionit, rigjykimin e çështjes nga Kolegji, rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni dhe gjykimin e çështjes në seancë publike. Përpos sa vlerësuar më lart në këtë vendim, referuar parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative⁷⁶, trupi gjykues nuk konstaton ekzistencën e ndonjë shkakut për të ngritur pretendime lidhur me ligjshmërinë e vendimit objekt shqyrtimi, nxjerrë nga organi kompetent, Komisioni, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Trupi gjykues sjell në vëmendje se për shqyrtimin e shkaqeve të ankimit lidhur me themelin, shqyrtimi i provave të administruara në fashikuj, është pjesë e procedurës edhe në vendimmarrjen mbi bazë aktesh, dhe nuk mund të argumentohet se analiza e provave kushtëzohet nga zhvillimi i debatit gjyqësor me praninë e subjektit. Për rrjedhojë, kërkesa e subjektit për rivlerësim të provave, konsiderohet e ezauruar nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor dhe kontrollit të vendimit të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, dhe është pjesë integrale e arsyetimit të këtij vendimi.

⁷³ Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Wierzbicki k. Polonisë, 2002.

⁷⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 3/2020 (JR), paragrafi 25; nr. 6/2020 (JR), paragrafi 13; nr. 8/2021 (JR), paragrafi 19.1; nr. 4/2021 (JR), paragrafi 11; nr. 9/2023 (JR), paragrafi 13.

⁷⁵ Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", në nenin 81, të titulluar "Vlerësimi i provave", parashikon: "Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ".

⁷⁶ Ligji nr. 44/2015, në nenin 108, "Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm", parashikon: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elemente të tjera të detyrueshme të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj".

C. Mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

26. Pasi ka hetuar për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar probleme për pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme ndër vite, në vlerën (-) 36.196.783 lekë, për të përballuar kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve. Konkretisht, Komisioni e ka bazuar marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin, bazuar mbi konkluzionet për pasuritë: shtesë anësore me sipërfaqe 68 m² (pa leje ndërtimi) e apartamentit me sipërfaqe 39 m², në rrugën “{***}” në Tiranë, shtesë kati pa leje ndërtimi me sipërfaqe 70 m² mbi banesën ekzistuese në lagjen “{***}” në Vlorë, automjetin tip “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2006, depozita bankare të personit të lidhur, bashkëshortit, respektivisht: në BKT, në vlerën 22.779 USD dhe 29.728 euro; në Intesa San Paolo Bank, në vlerën 40.255 euro; në Raiffeissen Bank, në vlerën 1.992.281 lekë, 80.652 USD, 2.348 USD dhe 30.048 euro; në ProCredit Bank, në vlerën 37.159 USD, dhe llogarinë rrjedhëse në emër të tij në ProCredit Bank, në vlerën 51.438 USD, si dhe në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara për krijimin e tyre.

C/1. Pasuria shtesë anësore, me sip. 68 m² (pa leje ndërtimi), e apartamentit të banimit me sip. 39 m², në Tiranë

27. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2000. Nga analiza financiare për periudhën 1993-2000, Komisionit i ka rezultuar se për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës, subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamjaftueshmëri financiare në vlerën (-) 4.397.569 lekë.

27.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit si joligjor, në kundërshtim me qëndrimet e Kolegjit për raste të ngjashme, dhe në kundërshtim me të dhënat që burojnë nga provat e administruara, si dhe të kushteve teknike të ndërtimit të kryer. Subjekti parashton:

- i. Nuk e ka deklaruar ndërtimin informal në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2004, pasi në formularin për deklaram të vitit 2003, nuk ka pasur rubrikë për deklaramin e ndërtimeve informale, dhe në formularin për deklaram të vitit 2004, ishte parashikuar deklarami i pasurive të paluajtshme për ndërtime të trupëzuara në një të vetëm dhe të paregjistruara në ish-ZVRPP.
- ii. Shtesa anësore është deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, pasi në formularin e këtij viti është saktësuar plotësisht që duhet të deklarohen shtesat dhe pakësimet e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme; në këtë vit është kryer kalimi i pronësisë së apartamentit ekzistues në 2/3 pjesë në emër të bashkëshortit⁷⁷, ku përfshihej edhe shtesa anësore e konsideruar si një banesë e përbashkët (apartament + shtesë); si dhe për arsye të miratimit të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- iii. Me provat e paraqitura, ka provuar se ndërtimi si karabina ka përfunduar në fund të vitit 2000, dhe e banueshme është bërë në qershor 2001, dhe se vlera e kostos së ndërtimit të shtesës anësore me sipërfaqe 68 m², është 772.047,71 lekë, e cila së bashku me vlerën e mobilimit arrin në 1.000.000 lekë, vlerë e deklaruar prej saj në deklaratën *vetting*. Akti i ekspertimit tekniko-ekonomik, nga i cili ka rezultuar se kostoja e punimeve të ndërtimit

⁷⁷ Kontrata me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2005.

është 772.047,71 lekë, është hartuar nga inxhinieri e licencuar, sipas kërkesave dhe udhëzimeve të kuadrit ligjor në fushën e ndërtimit, prandaj në analizën financiare duhet të korrigjohet vlera e kostos së ndërtimit prej 1.685.040 lekësh, përcaktuar nga Komisioni, duke zbatuar koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2000.

- iv. Balanca negative në analizën financiare ka rezultuar, pasi: nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit me burim të ligjshëm, në shumën prej 1.500.000 lekësh, përfituar në vitin 1999, si përfaqësues me prokurë të posaçme nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështja “{***}” ShPK; nuk është pasqyruar gjendja familjare e subjektit dhe e personit të lidhur, bashkëshortit, dhe të ardhurat financiare të familjeve respektive para lidhjes së martesës, më datë 28.06.1996, dhe bashkëjetesës në muajin gusht 1997; nuk janë përfshirë të ardhura të dokumentuara nga interesat e depozitave bankare, të krijuara në vitin 1997, me kursimet nga puna e subjektit dhe bashkëshortit, si dhe kursimet e familjeve respektive.

27.2 Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie. Për pasojë, pretendimet e subjektit në këtë drejtim, u gjetën të pabazuara. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

27.3 Së pari, nga aktet në fashikull, rezulton e dokumentuar sa vijon.

- a. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: shtesë anësore e apartamentit⁷⁸ (pa leje ndërtimi), me sip. 68 m². Viti i krijimit 2000. Depozituar kërkesë pranë ALUIZNI-t, Tiranë, datë 01.08.2006. Vlera e shpenzimeve për ndërtimin, 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: *nga të ardhurat e mia nga paga si gjyqtare dhe të bashkëshortit A. G.. Pjesë takuese: 50%*.
- b. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 2/3 e një apartamenti me sipërfaqe 39,7 m², së bashku me një shtesë anësore pa leje ndërtimi, me sipërfaqe 50 m², e ndodhur në Tiranë, në adresën përkatëse, regjistruar në ZRPP, më datë 14.09.2005. Shtesa e paregjistruar. Vlera e pasurisë: vlera e 2/3 të apt. 39,7 m², sipas kontratës së shitjes, është 100.000 mijë lekë.
- c. Në përgjigje të barrës së provës, lidhur me kohën dhe vlerën e punimeve të ndërtimit, për të cilat gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion ligjor si leje ndërtimi, preventiv, situacion punimesh, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) fatura të materialeve të ndërtimit, letër personale të z. F. S., drejtuar bashkëshortit të subjektit në maj të vitit 2000, si dhe vërtetim të datës 5.06.2001, për lidhje të kontratës së energjisë elektrike në emër të babait të saj, z. P. C.. Subjekti ka shpjeguar se këto prova konfirmojnë kohën e ndërtimit dhe mospagimin e vlerës së themeleve dhe zërave të tjerë të punimeve që lidhen me koston e ndërtimit, dhe se punimet janë kryer me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të palicencuar, një faqe është e pallatit ekzistues, ndërsa themelet janë ndërtuar nga z. F. S. që është dhe pronar

⁷⁸ Apartamenti deklarohet prej subjektit në D-Vett. me nr. rendor 1, si vijon: “Apartament banimi me sipërfaqe 39 m², ndodhur në Tiranë, rr. “{***}”, pallati {***}, ap. {***}, fituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep, nr. {***} kol., regjistruar në ZVRPP Tiranë, me nr. pasurie {***}, VOL {***}, ZK {***}, çmimi i blerjes 3170 lekë. Burimi i krijimit, ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimn e banesave shtetërore”, të ardhurat e familjes Caco.

i katit I dhe III të shtesës; (ii) raport vlerësimi (tekniko-ekonomik), hartuar nga ing. e licencuar në fushën e ndërtimit, znj. I. S., në të cilin kostoja e ndërtimit përlllogaritet në vlerën 772.047 lekë, dhe ka shpjeguar se në vlerën prej 1.000.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*, përfshihet kostoja e ndërtimit dhe mobilimi i tij, si shpenzime në total për këtë apartament.

27.4 Pretendimet e subjektit për arsyet e mosdeklarimit të shtesës anësore të apartamentit në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë të viteve 2003 dhe 2004 (në vijim “DIPP”), trupi gjykues i vlerëson të pabazuara. Në DIPP-2003, në pjesën hyrëse të formularit dhe në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to”, sqarohet detyrimi për deklarim të “çdo gjëje që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën”, si dhe përcaktohet: “nr., dt. regj. në hipotekë (nëse ka)”. Sa më sipër, në të kundërt me pretendimin e subjektit se nuk ka pasur një rubrikë të posaçme për deklarimin e ndërtimeve informale, nga teksti i deklaratës, në mënyrë të qartë, kuptohej detyrimi për deklarim të shtesës së apartamentit, ndërtim informal i peregjistruar në regjistrat publikë, i përfunduar në vitin 2000, pra i trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme me apartamentin ekzistues. Në tekstin e deklaratës së vitit 2004, lidhur me *çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme*, jepet sqarimi për deklarim të pasurive *mbi të cilat ushtroni një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara apo jo në ZRPP [në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, sip. në m², vlerën e pronës, vitin e ndërtimit]*. Për rrjedhojë, në të kundërt të pretendimit për *detyrim të deklarimit të pasurive të paluajtshme për ndërtime të trupëzuara në një të vetëm dhe të peregjistruara në ish-ZVRPP*, subjekti kishte detyrimin e deklarimit të shtesës anësore si pasuri më vete, në të cilën ajo ushtronte të drejtë reale, dhe prej vitit 2001 banonte me familjen e saj.

27.5 Subjekti pretendoi se *në formularin e vitit 2005, është qartësuar plotësisht se duhet të deklarohen shtesat dhe pakësimet e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*. Për sa më lart analizuar, për deklarimin e shtesës së apartamentit, subjekti i kishte lindur detyrimi qysh në vitin 2003, e në vitin 2005 kjo pasuri nuk mund të konsiderohej si pasuri e krijuar/shtuar në këtë vit për të cilin kryhej deklarimi. Në vijim të pretendimeve, subjekti parashtron se *ndërtimi informal është deklaruar në vitin 2005 për faktin se këtë vit është kryer kalimi i pronësisë së apartamentit ekzistues në 2/3 pjesë në emër të bashkëshortit, në bazë të kontratës së shitjes nr. {***}, datë 07.07.2005, ku përfshihej edhe shtesa anësore, pasi konsiderohej si një banesë e përbashkët (apartament + shtesë)*. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se me kontratën e shitjes të vitit 2005, babai dhe motra e subjektit, pala shitëse, i shesin bashkëshortit të subjektit pjesët takuese prej 2/3 të apartamentit ekzistues, me pëlqimin e subjektit, bashkëpronare me 1/3 pjesë. Pala shitëse në këtë kontratë nuk kishte të drejta mbi shtesën anësore të apartamentit, pasuri e krijuar prej subjektit dhe bashkëshortit, dhe ku këta të fundit banonin prej vitit 2001. Për rrjedhojë, rrethanat faktike përjashtojnë çdo pretendim për ndërlidhje të deklarimit të shtesës me kohën e fitimit prej bashkëshortit të pronësisë në 2/3 pjesë të apartamentit ekzistues. Në vitin 2005, duke zgjedhur të deklarojë si një pasuri 2/3 e apartamentit ekzistues dhe shtesën anësore, dhe vlerë çmimit e blerjes së 2/3 pjesë të apartamentit, subjekti ka shmangur deklarimin e kohës së krijimit dhe të vlerës së shtesës së apartamentit. Në çdo mënyrë të pretenduar të kuptimit apo interpretimit të formularëve të deklarimit, nuk ka asnjë arsye logjike që çmimi i blerjes së 2/3 pjesë të apartamentit me sipërfaqe 39 m², në shifër 26 m², të përfaqësojë edhe vlerën e kostos së ndërtimit të shtesës anësore me sipërfaqe 69 m². Për rrjedhojë, edhe deklarimi i shtesës së apartamentit në DIPP-2005, vjen në

kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, qartësisht të sqaruara në formular për subjektet deklaruese që bartnin detyrim për deklarim⁷⁹, dhe pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara.

27.5.1 Lidhur me pretendimin për korrigjim në analizën financiare të vlerës së kostos së ndërtimit, duke e përcaktuar sipas vlerës në aktin e ekspertimit tekniko-ekonomik, të paraqitur prej saj si provë, trupi gjykues, së pari, çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit se për pasuritë/ndërtimet informale, për të cilat nuk ka dokumentacion justifikues ligjor të kohës lidhur me koston e ndërtimit, përlllogaritja do të kryhet mbi bazën e kostos sipas çmimeve të EKB-së, *si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi*⁸⁰. Në kuadër të këtij pretendimi, konstatohet se në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë hetimit administrativ⁸¹, subjekti deklaroi vlerën e punimeve të ndërtimit të shtesës anësore 1.000.000 lekë, ndërsa në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, me provën e paraqitur, akt-ekspertimi teknik të hartuar nga ing. I. S., ka pretenduar një tjetër vlerë. Subjekti ka pretenduar se deklarimi në deklaratën *vetting*, *vlera e shpenzimeve për ndërtimin e shtesës 1.000.000 lekë*, përfshin vlerën e punimeve të ndërtimit prej 772.047 lekësh, sipas akt-ekspertimit, dhe diferenca u përket shpenzimeve të mobilimit, e të njëjtin qëndrim mban edhe në ankim. Për sa deklarimi *për ndërtim* destinon qartë lidhur me përdorimin e vlerës 1.000.000 lekë, pretendimi se në këtë vlerë janë përfshirë edhe shpenzimet e mobilimit, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me ndërtimin, vlerësohet si përpjekje e subjektit për të ndikuar në rezultatin e analizës financiare. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se subjekti gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit janë kryer në vitet 2001 dhe 2002, që dëshmon jo vetëm pabazueshmërinë e pretendimit për përfshirje të shpenzimeve të mobilimit në vitin më të hershëm 2000, por gjithashtu mungesë konsistence, me synimin për të ndikuar në rezultatin e analizës financiare. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij, se: *kontrolli i deklaratës vetting dhe krahasimi i saj me deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, i shërben Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pra mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij*, në kushtet kur kostoja e ndërtimit të shtesës së apartamentit nuk është deklaruar në deklaratat periodike, dhe subjekti në mungesë konsistence, pretendon për një vlerë të ndryshme nga vlera e deklaruar në deklaratën *vetting*, potencojnë faktin se akt-ekspertimi teknik, krijuar për efekt të këtij procesi, është provë e njëanshme, në mbështetje të interesave të subjektit. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se caktimi prej Komisionit i vlerës së kostos së ndërtimit të shtesës anësore, sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2000, është i drejtë.

27.5.2 Nën dritën e arsytimit sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, se për sa vlera e kostos së punimeve të ndërtimit e pretenduar prej saj, ishte e ndryshme nga ajo e përlllogaritur nga Komisioni sipas standardit të EKB-së dhe Komisioni duhet të kishte caktuar një ekspert të pavarur për saktësimin e vlerës së ndërtimit, vlerësohen të pabazuara. Përpos që në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor provues për vlerën e kostos

⁷⁹ Në formular qartësohet: “Përshkrimi i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme të regjistruar ose jo në regjistrat publikë (në sasi, numër, lloj, sipërfaqe, adresë të plotë, vitin e krijimit)” dhe “vlera e secilës pasuri të shtuar ose pakësuar, në lekë apo valutë, në momentin e veprimit (me shifra dhe fjalë)”.

⁸⁰ Shih vendimet e Kolegjit nr. 6 (JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit H. K., paragrafin 14.5; nr. 35 (JR), datë 22.09.2022, që i përket subjektit E. Sh., paragrafin 49.

⁸¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.02.2022.

së ndërtimit, standardi i EKB-së, i bazuar në të dhëna zyrtare të kohës, është i arsyeshëm, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur prej Kolegjit se: *përcaktimi i vlerës së një objekti të ndërtuar në vite të mëparshme, në ditët e sotme, do të mbetet gjithsesi subjektiv dhe pa ndonjë referencë ligjore të gjithëpranuar për kostot e vlerave të ndërtimit apo metodologjisë së përdorur për llogaritjen e saj*⁸². Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se mosmarrja në shqyrtim e aktit të ekspertimit tekniko-ekonomik është në kundërshtim të hapur me parimet e barazisë së armëve dhe aksesit në gjykim, e se ka cenuar procesin e rregullt ligjor, vlerësohen prej trupi gjykues të pabazuara.

27.6 Ndër pretendimet e ngritura për të kundërshtuar vlerën e punimeve të ndërtimit prej 1.658.040 lekësh, të përcaktuar nga Komisioni, duke zbatuar koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2000, subjekti argumentoi se shtesa anësore ka një faqe të përbashkët me apartamentin ekzistues ku ajo ishte bashkëpronare me babain dhe motrën e saj, materialet e ndërtimit kanë qenë të një cilësie të ulët, punimet nuk janë kryer me shoqëri ndërtuese, por me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, themelet e godinës janë kryer nga pronari i katit të parë dhe të tretë të shtesës anësore, dhe minimalisht në vlerën e përllogaritur, Komisioni duhet të kishte zbritur shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSh + fitim + fond rezervë, që mund të identifikohen lehtësisht nga aktet në dosje.

27.6.1 Lidhur me pretendimin se *shtesa anësore ka një faqe muri të përbashkët me apartamentin ekzistues*, në aktin e ekspertimit të paraqitur si provë prej subjektit, është pasqyruar planimetria e shtesës anësore, ku evidentohet qartë që shtesa me apartamentin ekzistues ka të përbashkët më pak se gjysmën e faqes së murit [3,33 m], ndërsa në pjesën tjetër të tij, në gjatësinë 4,92 m, rezultojnë shkallë të ndërkatëve. Përpos sa më sipër, subjekti nuk provoi se në këtë pjesë të përbashkët të faqes së murit, nuk u kryen punime ndërtimi për të realizuar komunikimin me apartamentin ekzistues. Sa u përket pretendimeve lidhur me mosinvestimin në themelet e ndërtimit informal 4-katësh, në letrën e z. F. S., paraqitur prej subjektit si provë në Komision, pasqyrohet se bashkëshorti nuk e pranon vlerën e themeleve, por nuk ka një gjurmë tjetër dokumentare që bashkëshorti të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim edhe më pas. Nga ana tjetër, konstatohet se në aktin e ekspertimit tekniko-ekonomik, të paraqitur si provë prej subjektit, pasqyrohet: *punimet nën kuotën 0.00 janë realizuar me kontribut të përbashkët, ku secilit prej pjesëmarrësve në ndërtimin e saj, i takon pjesa 1/4, dhe është përllogaritur investimi i bërë për themelet, sipas pjesës takuese. Sa më sipër, pretendimet e subjektit mbetën deklarative. Lidhur me pretendimet për përdorim të materialeve me cilësi të ulët, kryerjen e punimeve me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të palicencuar, përpos që mbetën të paprovuara, Kolegji në jurisprudencën e tij ka mbajtur qëndrim, duke gjetur të pabazuara pretendimet që lidhen me zbritjen e komponentëve që lidhen me koston e krahut të punës, sa kohë subjektet nuk provojnë se kostoja e secilit komponent të pretenduar u ka kushtuar më lirë sesa përllogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga EKB-ja*⁸³.

27.6.2 Lidhur me pretendimin se, sipas qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në vendimin nr. 15/2019 (JR), minimalisht në vlerën e përllogaritur, Komisioni duhet të kishte zbritur shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSh + fitim + fond rezervë, që mund të identifikohen lehtësisht nga aktet në dosje, trupi gjykues vlerëson si vijon. *Së pari*, nga shqyrtimi i akteve në

⁸² Shih vendimin e Kolegjit nr. 35/2022 (JR), datë 22.09.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. Sh., paragrafi 14.5.

⁸³ Shih vendimet e Kolegjit nr. 34/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit I. Sh.; nr. 35/2022 (JR), datë 22.09.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Sh., paragrafi 49.

fashikuj, konstatohet se Komisioni ka përllogaritur vlerën e punimeve të ndërtimit duke referuar sipërfaqen e shtesës anësore 68 m², sipas deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe në formularin e vetëdeklarimit. Referuar lejes së legalizimit⁸⁴, dokument zyrtar që finalizon procedurat e legalizimit të ndërtimit informal, si dhe verifikimit në fakt në aktin e ekspertimit teknik, sipërfaqja e shtesës anësore përcaktohet 69 m², për rrjedhojë vlera e punimeve të ndërtimit do të rezultonte më e lartë se ajo e përllogaritur prej Komisionit. Pavarësisht këtij konstatimi, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit për mosrëndim të situatës së subjektit, edhe në Kolegj vlera e punimeve të ndërtimit u konsiderua për sipërfaqen 68 m². Së dyti, në kushtet e ndërtimit informal pa firmë ndërtimi, përqindja e TVSh-së është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit janë blerë materialet për ndërtimin e objektit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit për zbritjen e kësaj vlere vlerësohet i pabazuar⁸⁵. Së treti, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit⁸⁶, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë për subjektin, përllogaritja e vlerave *fitim i planifikuar + fond rezervë*, në masën 8,83% për vitin 2000⁸⁷, do të rezultonte në shifrën 148.864 lekë, dhe aplikimi i kësaj uljeje për koston e ndërtimit në vitin 2000, do të sillte një kosto totale ndërtimi prej 1.536.176 lekësh, me ndikim në uljen e balancës negative për periudhën dhjetor 1993-2000.

27.7 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare për ndërtimin e shtesës së apartamentit, balancën negative prej (-) 4.397.569 lekësh për periudhën dhjetor 1993-2000, me pretendimet se nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura me burim të ligjshëm, shuma prej 1.500.000 lekësh e përfutur nga bashkëshorti i saj nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje nr. {***}, datë 19.09.1995, çështja “{***}” ShPK, si përfaqësues me prokurë të posaçme; se Komisioni ka zbatuar gabim ligjin nr. 84/2016, nuk e ka interpretuar në harmoni me ligjet e kohës; nuk janë pasqyruar në analizën financiare gjendja familjare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit) dhe të ardhurat financiare të familjeve respektive para lidhjes së martesës dhe bashkëjetesës.

27.7.1 Së pari, nga aktet në fashikuj, lidhur me burimet financiare për krijimin e shtesës anësore, deklaratimet e subjektit janë si vijojnë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sikundër në deklaratën *vetting*, si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti deklaroi kursimet financiare nga paga si gjyqtare, prej datës 1.12.1993 e në vijim. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti deklaroi se kursimet e saj janë krijuar nga paga *neto*, nga fillimi i ushtrimit të detyrës e deri në fillimin e

⁸⁴ *Praktika e lejes së legalizimit është përcjellë në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.07.2020.*

⁸⁵ *Shih vendimin e Kolegjit, nr. 6 (JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit H. K., paragrafin 14.7 “Trupi gjykues vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbritjen nga kostoja totale e ndërtimit e vlerës që zë përqindja e TVSH-së në këtë ndërtim, pasi ajo është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit ai i ka blerë materialet për ndërtimin e objektit, referuar nenit 1, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar: Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet: a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë.”*

⁸⁶ *Shih vendimin e Kolegjit, nr. 6 (JR), datë 17.03.2022, që i përket subjektit H. K., paragrafin 14.8 “Trupi gjykues, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë dhe të plotë kreu analizën financiare bazuar në...manuallet e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83 % për vitet 1996-2000 dhe në masën 9,27 % për vitin 2001, nga ku rezultoi se kostoja totale e ndërtimit për këtë pasuri do të ishte...”*

⁸⁷ *Në bazë të informacionit që Enti Kombëtar i Banesave ka dërguar në Kolegj me shkresat nr.{***} prot., datë 11.03.2019; nr.{***} prot., datë 13.10.2021; nr. {***} prot., datë 21.10.2021, përllogaritja në masën 8,83% rezulton si total i fondit rezerve prej 3,97% dhe pjesa e fitimit të planifikuar.*

bashkëjetesës faktike me bashkëshortin, në gusht të vitit 1997, pasi shpenzimet e jetesës janë përballuar nga familja e origjinës, si edhe nga dhurimi i shumave të vazhdueshme nga familja e saj e origjinës, ku përfshihet halla me bashkëshortin që kanë bashkëjetuar me familjen e saj. Sa u takon burimeve të personit të lidhur, bashkëshortit, në pyetësorin e sipërcituar, i deklaroi në mënyrë të detajuar: *kursimet financiare 1989 - shtator 1993, si mësuës pranë shkollës 8-vjeçare Oriku, Vlorë; 1 dhjetor 1993 - gusht 1996, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe të ardhurat e tij nga puna si avokat nga viti 1997 e në vijim, të ardhura nga ekzekutimi i vendimit nr. {***}, datë 19.09.1995, i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Lushnje, shuma prej 1.500.000 lekësh, e përfituar neto.* Në përgjigje të barrës së provës, për kursimet personale të bashkëshortit, deklaroi se kanë burim edhe nga sende me vlerë të trashëguara, e po ashtu edhe për mundësi të tjera financiare të ndërlidhura me historikun e familjes së origjinës.

27.7.2 Trupi gjykues konstaton se deklaratimet e subjektit për burimet e përdorura prej saj për krijimin e kësaj pasurie, në deklaratën *vetting: të ardhurat e mia nga paga si gjyqtare*; dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2: *kursimet financiare nga paga ime si gjyqtare prej datës 1.12.1993 e në vijim* – janë të qarta, duke i kufizuar ato vetëm në të ardhurat/kursimet nga paga e saj si gjyqtare. Në këtë kontekst, pretendimi i subjektit për të ardhura të anëtarëve të familjes së saj të origjinës, ku pas vitit 1990 bashkëjetonte halla dhe bashkëshorti i saj⁸⁸, do të devijonin burimin e deklaruar – kursime nga paga. Lidhur me pretendimin për *dhurime të vazhdueshme nga familja e saj, të shumave në formën e prikës*, subjekti është kontradiktore për sa gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nga fillimi i detyrës nuk ka marrë dhurata me vlerë më të lartë se 500 euro⁸⁹ e, për më tepër, konsideruar kushtet e ekonomisë shqiptare, inflacionin *galopant* në vitet '89 -'92, rritjen e inflacionit në periudhën e lulëzimit dhe perëndimit të firmave piramidale,⁹⁰ mundësitë për *dhurime të vazhdueshme nga familja e origjinës*, nuk duken bindëse. Lidhur me pretendimet për deklaratimet e pasurisë prej saj sipas ligjit nr. 7903/1995, trupi gjykues ka analizuar në detaje më lart në këtë vendim, për më tepër që në ankim, sikundër në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti vetëm citon detyrimin sipas ligjit të kohës për deklarim të shumave apo sendeve me vlerë mbi shifrën 1.000.000 lekë, por jo shifrën e pretenduar të deklaruar prej saj. Në përmbyllje, duke konstatuar se nga fillimi i ushtrimit të detyrës deri në fillimin e bashkëjetesës me bashkëshortin, periudha 1.12.1993 - gusht 1997, të ardhurat e familjes së subjektit ishin mbi nivelin e pagave të kohës, për një qëndrim garantist, trupi gjykues vlerësoi të marrë në konsideratë si kursime të subjektit, të ardhurat nga paga e saj neto si gjyqtare, pa zbritur shpenzime të jetesës, të përballuara tërësisht nga familja, sipas pretendimit.

27.8 Për të ardhurat e pretenduara të personit të lidhur, bashkëshortit, prej 1.500.000 lekësh në vitin 1999, nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje nr. 1352, datë

⁸⁸ Subjekti shpjegon se kursimet e familjes së saj të origjinës, ku përfshihej dhe halla me bashkëshortin, janë krijuar nga pagat, pensionet, pasuritë e trashëguara, dhe dëmshpërblime financiare për shkak të persekutimit. Për periudhën 1994-1996, halla me bashkëshortin kanë përfituar 1.200.000 lekë dëmshpërblim në letra në vlerë dhe cash, provuar nga shkresa e "Raiffeisen Bank"; bashkëshorti i hallës, U. S., në vitin 1993 ka përfituar kompensim për pronën {***} Pogradec, në vlerën 491.426 lekë, të ardhura të tjera nga dhënia me qira e pronave në emër të bashkëshortit të hallës, bar "{***}" dhe hotel {***}, të provuara me mandatet e paraqitura bashkëlidhur prapësimëve.

⁸⁹ Shih pyetësorin standard, pyetja nr. 4: "A keni marrë ndonjëherë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro, a ka financuar ndokush shpenzimet në këtë shumë apo shumë më të lartë se kjo, nga marrja e detyrës për herë të parë?"

⁹⁰ Shih: https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Raporti_Vjetor_1994_2009_1_6441.pdf; <https://ndiqparate.al/?p=17130>.

19.09.1995, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, çështja “{***}” ShPK, Komisioni ka arritur në përfundimin se aktmarrëveshja mes shoqërisë dhe bashkëshortit të subjektit nuk përbën provë shteruese të pagesës së detyrimit tatimor prej shoqërisë, dhe duke mos qenë i regjistruar në organet tatimore si avokat, edhe të ardhurat e tij nga shërbimi i avokatisë nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme.

27.8.1 Subjekti, këto të ardhura, të deklaruara *gjatë hetimit administrativ*⁹¹, i pretendon të përfituara *neto* prej bashkëshortit, pasi detyrimet tatimore janë në ngarkim/janë paguar nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas parashikimeve në aktmarrëveshje: *shoqëria do të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që lidhen me këtë aktmarrëveshje dhe diferencën e shumës prej 341.900 lekësh do ta mbajë shoqëria për shpenzimet e kryera gjatë procesit gjyqësor dhe shpenzimet e tjera*, dhe sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Subjekti pretendon se Komisioni ka anashkaluar provat me të cilat ka vërtetuar se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion *shterues* të pagesës së detyrimit tatimor, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke mos marrë në konsideratë përgjigjet e institucioneve për sa kërkuar prej saj: Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Drejtoria e Kthimit të Shumave) i ka kthyer përgjigje se nga kërkimi në arkiv nuk gjendet dokumentacioni i shoqërisë “{***}” Shpk⁹², dhe Dega e Thesarit Tiranë ka informuar se nuk disponojnë asnjë dokumentacion financiar të shoqërisë “{***}” ShPK, pasi janë dokumente justifikuese dhe me miratimin e transaksionit financiar, ia kthejmë prapë institucionit⁹³.

27.8.2 Lidhur me dokumentacionin e paraqitur për të provuar këto të ardhura të bashkëshortit, subjekti shprehet se ka *paraqitur dokumentacionin e ruajtur prej saj në lidhje me këtë ekzekutim*. Ndër aktet e paraqitura, është edhe prokura e posaçme nr. {***}, datë 5.11.1999, me të cilën i përfaqësuari R. K., i jep përfaqësuesit të tij të posaçëm, avokatit A. G., të drejtën që në emër të tij të tërheqë shumën prej 3.341.900 lekësh pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (në vijim “AKP”). Fakti i kryerjes së këtyre veprimeve prej bashkëshortit, dëshmohet edhe nga përmbajtja e kërkesave të subjektit për dokumentacion financiar të shoqërisë “{***}” ShPK, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë [Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike], dhe Degës së Thesarit Tiranë, respektivisht më datë 22.02.2022 dhe 04.03.2022, ku subjekti shprehet se *shoqëria “{***}” ShPK përfaqësohej me prokurë të posaçme nga bashkëshorti A. G., në cilësinë e avokatit*. Për rrjedhojë, bashkëshorti i subjektit, duke kryer veprimet për tërheqjen e shumës, është pajisur me dokumentacionin përkatës. Subjekti nuk shpjegon përse ky dokumentacion, nuk është pjesë e dokumentacionit *në ruajtje*, i cili përpos aktmarrëveshjes mes bashkëshortit të subjektit dhe z. Rushit Kozare, administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “Kozare” ShPK, përfshin edhe

⁹¹ Subjekti ka paraqitur si prova: (i) aktmarrëveshje e datës 1.10.1999, me objekt: “Mënyra e shpërblimit, pagesës për shpërblimin që do të kryhet në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. {***}, datë 19.09.1996, të Gjykatës së Rrethit Lushnje”, mes A. G. dhe R. K.; (ii) prokurë e posaçme nr. {***}, datë 5.11.1999, me të cilën R. K. deklaron: “emëroj si përfaqësuesin tim të posaçëm z. A. G., avokat në rrethin e Tiranës, duke i dhënë të drejtën dhe kompetencën që në emër dhe për llogarinë time, të kryejë të gjitha veprimet pranë të gjitha Zyrave të Përmbartimit për ekzekutimin e vendimit nr. {***}, datë 19.09.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, dhe kopje të këtij vendimi; (iii) vendim nr. {***}, datë 20.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje për lëshim urdhër ekzekutimi; (iv) korespondenca të vitit 1999, mes AKP Tiranë dhe Ministrisë së Financave; (v) dokumentacion të shoqërisë “{***}” ShPK.

⁹² Shkresa e subjektit mban nr. {***} prot., datë 22.02.2022, dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2022, i është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

⁹³ Shkresa nr. {***}, datë 07.03.2022, e Degës së Thesarit Tiranë.

akte të themelimit, statusit, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor të shoqërisë, korrespondencën me institucionet shtetërore, përfshirë edhe korrespondencën e z. R.K. përpara përfaqësimit prej bashkëshortit të subjektit. Në ankim, në parashtrimet e shtjelluara gjerësisht në 30 pika, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga kjo marrëdhënie, subjekti mjaftohet me deklarinimin *se shuma prej 1.500.000 lekësh është marrë nga ana e bashkëshortit në fund të muajit dhjetor të vitit 1999*, pa dhënë shpjegime për dokumentimin e tërheqjes së shumës, apo të dokumentimit të kalimit/dorëzimit të pjesës takuese të shumës z. R. K.. Në këtë situatë faktike, kërkesat drejtuar institucioneve, konsideruar afatet e ruajtjes së këtij lloj dokumentacioni, vlerësohen si përpjekje për të pretenduar aplikim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim për të mos hedhur dritë mbi pagimin e detyrimeve tatimore, dhe për cilësinë me të cilën ka vepruar bashkëshorti në momentin e kryerjes së veprimeve për tërheqjen e shumës prej 3.341.900 lekësh, nga ku do të përfitonte shumën prej 1.500.000 lekësh, sipas aktmarrëveshjes së datës 1.10.1999, me objekt: “Mënyra e shpërblimit, pagesës për shpërblimin që do të kryhet në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. {***}, datë 19.09.1996, të Gjykatës së Rrethit Lushnje”.

27.8.3 Për sa më sipër, subjekti ka dështuar të provojë se në këtë veprimtari, bashkëshorti ka vepruar si individ, brenda hapësirave ligjore të Kodit të Procedurës Civile të kohës, dhe fjala “avokat” si titull, është bazuar në licencën profesionale. Thënë ndryshe, pretendimi se të ardhurat janë përfituar nga bashkëshorti përpara se t’i lindte detyrimi për regjistrim në organet tatimore, mbetet deklarativ, për sa *fundi i dhjetorit 1999*, kur pretendohet se është përfituar shuma, logjikisht referon të paktën 10-ditëshin e fundit të muajit, kronologjikisht pas datës 19.12.1999, kur bashkëshorti rezulton të jetë pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit, në bazë të së cilës bëhej regjistrimi në organet tatimore.

27.8.4 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kur bashkëshorti e ka kryer këtë veprimtari, personi fizik si subjekt tregtar apo si person fizik natyror, e ka pasur të pamundur zbatimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, pasi ligji nuk ka qenë qartësisht i zbatueshëm në praktikë. Sipas subjektit, ligji i sipërcituar ka hyrë në fuqi më datë 21.01.1999, dhe akti nënligjor, nxjerrë në zbatim të tij, është miratuar më 11.02.2003, e në këtë periudhë të ndërmjetme, organet tatimore dhe subjektet që do të luanin rolin e agjentit tatimor, nuk kanë qenë të qartë për mënyrën e zbatimit në praktikë të ligjit, dhe kjo situatë nuk mund të penalizojë personat fizikë natyrorë apo tregtarë, për moskrijimin e infrastrukturës së nevojshme që ata të kishin mundësinë e pagesës së detyrimeve.

27.8.5 Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin si më sipër, pasi rrethanat e pretenduara nuk zhveshin nga detyrimi për pagimin e detyrimit tatimor, as shoqërinë “{***}” ShPK që, sipas subjektit, kishte detyrimin për të paguar detyrimet tatimore, bazuar në parashikimet e aktmarrëveshjes, dhe as subjektin që ka përfituar të ardhura nga veprimtaria si avokat. Për më tepër, miratimi i ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, orientoi reformimin thelbësor të të gjitha operacioneve të administratës tatimore, në funksion të rritjes së të hyrave në buxhetin e shtetit. Për rrjedhojë, pretendimet se ligji nr. 8438/1998 nuk ka qenë i zbatueshëm në periudhën që bashkëshorti i subjektit ka përfituar këto të ardhura, vlerësohen të pabazuara.

27.8.6 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson që konkluzioni i Komisionit se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 1999, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, duke mos i përfshirë në analizën financiare, është i drejtë dhe i bazuar, dhe pretendimet e subjektit u vlerësuan të pabazuara.

27.9 Lidhur me pretendimin se në vendimin e Komisionit, në analizën financiare nuk janë pasqyruar të ardhurat financiare të familjes së personit të lidhur, bashkëshortit, përpara lidhjes së martesës, më datë 28.06.1996, dhe bashkëjetesës faktike në muajin gusht 1997, vlerësohet si vijon. *Së pari*, për burimin e krijimit të shtesës anësore, në deklaratën *vetting*, bashkëshorti deklaroi: *të ardhurat e mia*. Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti ka detajuar: *kursimet financiare të bashkëshortit që nga viti 1989 deri në shtator të vitit 1993; si mësuës pranë shkollës 8-vjeçare Orikum, Vlorë, 1 dhjetor 1993 deri në gusht 1996, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe të ardhurat e tij nga puna si avokat nga viti 1997 e në vijim*, deklarime që kufizojnë burimet financiare të përdorura nga bashkëshorti, në kursimet e tij. *Së dyti*, referuar burimeve të hapura, të paraqitura prej subjektit si provë⁹⁴, ka indicie se familjes Gumbardhi i janë sekuestruar sasi monedhash ari, por nuk provohet se pas këtij momenti, anëtarë të familjes të kenë pasur në disponim të tilla, por edhe duke analizuar *a contrario*, se familja ka disponuar të tilla, nuk provohet kur janë konvertuar, dhe se për çfarë qëllimi janë përdorur likuiditetet e përfutura. Gjithashtu, aktet e tjera provojnë të ardhura të familjes, por kursime të mundshme prej tyre i atribuohen familjes dhe jo subjektit. *Së treti*, subjekti pretendoi se nga data 28.06.1996 deri më 20.02.2003, sipas certifikatës së përbërjes familjare, kanë qenë në gjendje familjare me nënën dhe vëllain e bashkëshortit, dhe në analizën financiare duhet të përfshihen edhe të ardhurat e tyre, duke i trajtuar në kushtet e ekonomisë së përbashkët familjare. Gjatë hetimit administrativ⁹⁵, subjekti deklaroi se ka banuar në shtëpinë e bashkëshortit në Vlorë, në periudhën mars 1996 - maj 1997. Për pjesën tjetër të periudhës që e pretendon në kushtet e ekonomisë së përbashkët familjare me nënën dhe vëllain e bashkëshortit, deklarimi se ka banuar në Tiranë përjashton *de facto* jetesën në kushtet e ekonomisë së përbashkët familjare. Përpos sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur për të vëllain e bashkëshortit, anëtar i familjes sipas certifikatës familjare, provon se ai ka qenë rezident në Itali, sipas lejes së qëndrimit të datës 17.03.1997, fakt i cili edhe në rastin e ekonomisë së përbashkët, do ta përjashtonte nga përfshirja në analizë financiare. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pretendimet për përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave të anëtarëve të familjes së tij të origjinës para dhe pas lidhjes së martesës, janë të pabazuara.

27.9.1 Subjekti pretendon se pasuria personale e bashkëshortit, e disponuar dhe deklaruar prej tij në vitin 1995, sipas ligjit të kohës nr. 7903/1995, përbëhej: *nga të ardhurat e punës së tij, sende me vlerë (monedha ari), vlera monetare të dhuruara me rastin e martesës dhe lindjes së fëmijëve*, janë konvertuar me çmimin e tregut të lirë dhe janë depozituar në ish-Bankën e Kursimeve në vitet 1997, 1998. *Së pari*, megjithëse në bazë të ligjit të kohës nr. 7903/1995, bashkëshorti i subjektit, si subjekt deklarues, duhet të ketë kryer deklarimin e pasurisë për 5 vite, përfshirë periudhën pas largimit nga detyra⁹⁶, nuk deklaroi, qoftë edhe me përafërsi vlerën e këmbyeshme në lekë të sendeve me vlerë që pretendon se ka disponuar, për sa shprehet se kjo ka qenë mënyra e deklarimit

⁹⁴ Subjekti ka paraqitur printim të formatit elektronik të “Zanit të Malsisë”, datë 7 qershor 2019, shkrimin me titull: “Ja cilat janë familjet që iu sekuestrua floriri pas luftës nga regjimi komunist”.

⁹⁵ Në përgjigje të pyetësorit standard, pyetja 1.

⁹⁶ Ligji nr. 7903, datë 8.03.1995, “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, parashikonte në nenin 1 detyrimin për deklarim: “[...] Shumat në të holla ose sende me vlerë mbi 1 milion lekë dhe pasuri të luajtshme të regjistruara në administratën shtetërore, si dhe burimin e tyre”, dhe në nenin 2: “Personat e përmendur në nenin 1 të këtij ligji në tremujorin e parë të çdo viti duhet të deklarojnë ndryshimet që kanë pësuar pasuritë e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm ndaj atyre të deklaruara një vit më parë. Detyrimi për deklarimin e pasurive të këtyre personave shtrihet edhe në pesë vitet vijuese pas lënies së funksionit shtetëror”.

të tyre⁹⁷. Gjithashtu, deklarimi në seancë dëgjimore i bashkëshortit të subjektit: *thotë ke paguar tatimet, s'ke paguar tatimet... nuk do ishim, nuk do flisnim sot në qoftë se s'do kisha punuar. Pra, unë kam qenë në kushtet e nevojës së madhe në periudhën 1996-1997 [...]*, nuk i përkon një situatë të pretenduar me të ardhura/kursime nga disa burime, sikundër pretendohet. Së dyti, edhe me deklaratat e pasurisë, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë si provë në këtë proces, subjekti ka dështuar të provojë pasuritë trashëgimore të pretenduara. Përpos sa analizuar në paragrafët 21.3.1 dhe 24.1.1, lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 të depozitave bankare, si pasuri të regjistruara veçmas në emër të bashkëshortit të subjektit, dhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2006, depozitat bankare në Raiffeissen Bank deklarohen pa burimin e krijimit të tyre⁹⁸. Për sa më sipër, në të gjitha këndvështrimet, pretendimi i subjektit për disponim të sendeve me vlerë, mbetet deklarativ dhe potencimi i detyrimit që parashikonte ligji nr. 7903/1995, për deklarim të sendeve me vlerë mbi 1.000.000 lekë, dëshmohet vetëm si përpjekje për të mbështetur pretendimin se ka disponuar të ardhura nga pasuri trashëgimore. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit vlerësohen të pabazuara.

27.9.2 Lidhur me pretendimet për kursime nga të ardhurat e bashkëshortit si mësues, në Orikum, Vlorë, në periudhën 1989-1993, konstatohet se me dokumentacionin e paraqitur, subjekti ka provuar vetëm periudhën e punësimit, por jo shumën e të ardhurave⁹⁹, të cilat mbeten të paprovuara edhe në referim të VKM-së nr. 561, datë 12.08.2005, “Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, ku në pagat referuese për periudhën para datës 1.1.1994, nuk përfshihet ajo e mësuesit. Përpos që subjekti nuk ka përmbushur barrën e provës lidhur me këto të ardhura, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit se: *të ardhurat e përfutuara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare¹⁰⁰*, pretendimi i subjektit për krijim të kursimeve prej bashkëshortit gjatë kësaj periudhe, vlerësohet i pabazuar.

27.10 Lidhur me pretendimin se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhura të dokumentuara nga interesat e depozitave bankare, të krijuara në vitin 1997 me kursimet nga puna e subjektit dhe bashkëshortit, dhe kursimet e familjeve respektive, për lehtësi të leximit të këtij vendimi, trupi gjykues do të analizojë në detaj në vijim, në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të subjektit për analizën financiare.

27.11 Nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të kryer nga Komisioni, si dhe pasi u morën në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, për të cilat analizohet në detaje në vijim: (i) kursimet e subjektit për periudhën 1993-1996 u vlerësuan të krijuara nga *pagat neto*; (ii) u përfshinë të ardhura të subjektit nga pagat për muajt dhjetor 1996; tetor, nëntor të vitit 1997; (ii) për vitet 1997-1999, shpenzimet e jetesës u konsideruan me 30% të të ardhurave, përkundrejt 66% të llogaritur prej Komisionit; (iii) nga vlera e kostos së punimeve të ndërtimit u zbritën zërat e fitimit të planifikuar dhe fondit rezervë; (iv) u përfshinë interesat e depozitave bankare sipas

⁹⁷ *Shih faqen 19 të procesverbalit të seancës dëgjimore, deklarimin e bashkëshortit të subjektit: “në qoftë se ti çmoje që monedhat e tua të arit ose sende të trashëguara floriri, ose vepra të artit, mund t'i shesësh që kanë këtë vlerë, do të deklarohet vlerën, po nuk do deklarohet ku i kishe mbajtur [...] sot flasim shumë, por atëherë me kompensata ishin dyert, prandaj nuk tregohet vendi”.*

⁹⁸ *Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se këto depozita janë krijuar me burim kursimet familjare të para vitit 2000.*

⁹⁹ *Vërtetimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë, Himarë, me nr. {***} prot., datë 16.06.2022.*

¹⁰⁰ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 14/2019(JR), nr. 19/2019(JR), nr. 15/2021(JR); nr. 23/2022 (JR).*

analizës së të dhënave të dokumentacionit të administruar – rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 3.388.689 lekësh¹⁰¹, për përballimin me burime financiare të ligjshme të shpenzimeve të jetesës, shtimin e kursimeve dhe krijimin e pasurive. Në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit për analizën financiare, ky përfundim gjen trajtim në detaj.

27.12 Në përmbledhje të gjithë sa më sipër, lidhur me *pasurinë shtesë anësore me sip. 68 m² (pa leje ndërtimi), e apartamentit të banimit me sip. 39 m², në Tiranë*, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se qëndron konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2000, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në germat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C/II. Shtesë kati pa leje ndërtimi, me sip. 70 m², në Vlorë

28 Komisioni, për këtë pasuri ka arritur në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2013, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në germat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

28.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se është kontradiktor, bie ndesh me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (në vijim “ligji nr. 9482/2006”), me jurisprudencën e Kolegjit¹⁰² dhe me provat e administruara në dosje, disa prej të cilave janë anashkaluar, dhe kërkon që Kolegji të korrigjojë analizën financiare të vitit 2013, duke e shtrirë koston e ndërtimit në vitet e periudhës 2013-2017, dhe nga shpenzimet e ndërtimit të zbritet gjysma e investimit të kryer prej vëllait të bashkëshortit. Lidhur me këto pretendime, subjekti i rivlerësimit parashtroi si vijon.

- i. Vlera e punimeve të ndërtimit, sipas raportit të vlerësimit tekniko-ekonomik, hartuar nga inxhinieri e licensuar I. S., është 1.565.681 lekë. Mosmarrja në konsideratë e kësaj prove prej Komisionit, është në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve, aksesit në gjykim dhe ka cenuar procesin e rregullt ligjor.
- ii. Punimet e ndërtimit janë kryer në periudhën 2013-2017, prandaj kostoja e tyre duhet të shpërndahet në këto vite, respektivisht 300.000 lekë (30%), 100.000 lekë (10%), 200.000 lekë (20%), 100.000 lekë (10%) dhe 300.000 lekë (30%).
- iii. Kostos së punimeve të ndërtimit, e llogaritur sipas standardeve të EKB-së, prej 2.211.160 lekësh, sipas qëndrimit të Kolegjit, duhet t’i zbriten vlerat që përfaqësojnë TVSh-në, fitimin e planifikuar dhe fondin rezervë.
- iv. Vlera e punimeve të ndërtimit minimalisht duhet të ndahet në dy pjesë mes bashkëshortit dhe vëllait të tij, pasi si bashkëpronarë në ndërtesën ekzistuese, janë bashkëinvestitorë në shtesën e

¹⁰¹ Total i diferencave të vitit 1998 prej – 1.138.276 lekësh, vitit 1999 prej 944.878 lekësh dhe vitit 2000 prej 1.305.535 lekësh.

¹⁰² Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rr..

katit mbi të, provuar me dokumentacionin e administruar dhe praktikën për regjistrimin e saj në ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë.

v. Sa i përket pamjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme për ndërtimin e kësaj shtese, subjekti kundërshton metodologjinë e përdorur lidhur me të ardhurat e bashkëshortit në vitin 2013.

29 Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie. Për pasojë, pretendimet e subjektit në këtë drejtim, u gjetën të pabazuara. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

29.1 Kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *vetting*, dhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2016, si vijon: *Shtesë kati (pa leje ndërtimi) me sip. 70 m², ndërtuar mbi banesën ekzistuese e ndodhur në Vlorë, lagjja “{***}”, e regj. në ZVRPP Vlorë me nr. pas. {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, e cila figuron me emër të babait tim R. G. dhe bashkëpronarëve të tjerë. Depozituar kërkesë pranë ALUIZNI-t Vlorë, datë 16.07.2013. Vlera totale e shpenzimeve për ndërtimin: 1.000.000 lekë. **Burimi i krijimit:** nga të ardhurat e mia nga puna si avokat. **Vlera:** E pavlerësuar sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 25%.”.*

29.2 Duke konstatuar se edhe në deklarin *vetting*, nuk është deklaruar periudha e ndërtimit të shtesës së katit, pretendimet e subjektit se ky ndërtim informal nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2013, por në deklaratën e vitit 2016 kur kanë përfunduar punimet e ndërtimit, vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara. Nga aktet e administruara, konkretisht fotografitë bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit¹⁰³, provohet se më datë 16.07.2013, kur bashkëshorti i subjektit aplikon pranë ALUIZNI-t për legalizim të tij, kishin përfunduar punimet konstruktive të ndërtimit, kolonat dhe muret. Nën parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, lidhur me deklarin e pasurive të paluajtshme të peregjistruara në ZVRPP, të vlerës/shumës së shpenzuar dhe burimeve të krijimit, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të deklaruar këtë ndërtim informal të trupëzuar me ndërtesën ekzistuese, shumën e shpenzuar për të dhe burimet e krijimit të saj, për të cilin ishin ndërmarre veprime administrative për ta legalizuar.

29.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon se punimet për ndërtimin e shtesës së katit kanë filluar në muajin maj 2013, pas ekzekutimit nga Zyra Përmbartimore në datë 25.04.2013 të vendimit gjyqësor për lirimin dhe dorëzimin ish-pronarëve të banesës ekzistuese, dhe janë kryer në periudhën maj 2013-2016. Vetëdeklarimi i ndërtimit informal është kryer nga bashkëshorti më datë 16.07.2013, në limitet e afatit për vetëdeklarim, të përcaktuar në ligjin nr. 9482/2006. Shtesa e katit është bërë e banueshme në vitin 2017, pas kryerjes së punimeve të brendshme. Ndërkohë që punimet kanë filluar në maj 2013, edhe si kohë fizike nga ana teknike, nuk mund të pranohet përfundimi i plotë i shtesës dhe destinimi për banim, provuar kjo me: (i) fotot ilustruese që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, fotot në vijim dhe gjendjen aktuale; (ii) disa prej faturave të materialeve të ndërtimit, që datojnë pas vetëdeklarimit, në vitet 2014, 2015 e vijim; (iii) kërkesën e datës 13.05.2015 për lidhjen e energjisë elektrike, vërtetimin e OSHEE-së se kontrata për furnizimin me energji është lidhur më datë 15.10.2015. Furnizimi

¹⁰³ *Praktika e legalizimit është përcjellë nga ALUIZNI me shkresën e nr. {***} prot., datë 27.07.2017 (në dosjen e ILDKPKI-së).*

me energji elektrike mundësoi vijimin e punimeve të brendshme.

29.3.1 Nga aktet në fashikuj, konkretisht fotografitë e objektit bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit, konstatohet përfundimi i punimeve për konstruksionin e shtesës më datë 16.07.2013 [kolona dhe muret]. Nga shqyrtimi i provave të administruara në fashikuj, fatura të materialeve të ndërtimit të viteve 2013, 2014, 2015, dhe një në vitin 2016, kërkesa për lidhje të kontratës për furnizim me energji elektrike më datë 13.05.2015, vërtetimi i OSSHE-së për lidhjen e kontratës më datë 16.10.2015, trupi gjykues krijon bindjen se punimet e ndërtimit kanë përfunduar në vitin 2015, por jo në vitin 2016, ashtu si pretendon subjekti. Ky përfundim mban në konsideratë edhe deklarimin në seancë dëgjimore të bashkëshortit të subjektit se *mbi një godinë 100-vjeçare është ndërtuar një konstruksion i lehtë, thjesht për simbolikë*. Për sa më sipër, përfundimi i Komisionit se punimet e ndërtimit kanë përfunduar në vitin 2013, duke argumentuar se viti 2013 është viti kur subjekti ka paraqitur pranë ALUIZNI-t kërkesën për legalizim të objektit të ndërtuar në mënyrë informale dhe supozohet se ndërtimi ka qenë i përfunduar nga pikëpamja tekniko-ekonomike, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

29.3.2 Lidhur me pretendimet për marrjen në konsideratë të aktit të ekspertimit tekniko-ekonomik, koston së punimeve të ndërtimit sipas tij, apo se punimet janë kryer me punëtorë të palicencuar, materialet e përdorura janë me cilësi të ulët, mbikëqyrja e punimeve është bërë nga vëllai i bashkëshortit, inxhinier me licencë profesionale, konstatohet se bëhen në të njëjtat rrethana faktike sikundër edhe për shtesën anësore me sipërfaqe 68 m² të apartamentit në Tiranë. Për rrjedhojë, trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim sikundër shtjelluar në paragrafin 27.6.1 më lart në këtë vendim, dhe i vlerëson këto pretendime të subjektit të rivlerësimit të pabazuara. Me të njëjtin qëndrim si për ndërtimin informal në Tiranë, pretendimi i subjektit për zbritjen nga kostoja e ndërtimit të vlerës që zë përqindja e TVSh-së, vlerësohet i pabazuar¹⁰⁴. Lidhur me pretendimet për zbritje të vlerave që zënë komponentët: *fitim i planifikuar + fond rezervë*, për një qëndrim garantist edhe në rastin e këtij ndërtimi informal, vlerat përkatëse u identifikuan sipas të dhënave të EKB-së. Për vitet 2007 deri në 2011, janë në masën e 8,55%¹⁰⁵, dhe nga zbritja e tyre, vlera e koston së ndërtimit të shtesës së katit rezultoi 2.022.080 lekë, me diferencë prej 189.080 lekësh përkundrejt vlerës prej 2.211.160 lekësh, e përlllogaritur prej Komisionit.

29.4 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në mënyrë të paargumentuar, nuk është marrë në konsideratë se vlera e shtesës së katit minimalisht duhet të ndahet në dy pjesë, mes bashkëshortit dhe vëllait të tij, si bashkëpronarë, për sa janë të tillë në banesën ekzistuese mbi të cilën është ndërtuar kjo shtesë kati. Sipas saj, ky fakt provohet nga certifikata e pronësisë së banesës ekzistuese, deklarata noteriale nr. {***}, datë 26.08.2022, dhe praktika për regjistrimin e saj në ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë.

29.4.1 Referuar deklaratës noteriale për njohje bashkinvestitori në ½ pjesë të pandarë, me nr. {***}, datë 26.08.2022, deklarues subjekti, bashkëshorti dhe vëllai i tij, rezulton që ata deklarojnë se kanë ndërtuar shtesë kati mbi pjesën e tyre takuese *mbi pasurinë truall që kanë*

¹⁰⁴ Ligji nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa “a”, sipas së cilës tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh) paguhet: “a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

¹⁰⁵ Shkresat e EKB-së drejtuar Kolegjtit nr. {***} prot., datë 11.03.2019; nr. {***} prot., datë 13.10.2021; nr. {***} prot., datë 21.10.2021; për vitet 2007 deri në 2011 janë në masën 8,55%.

në bashkëpronësi¹⁰⁶, dhe se për ndërtimin e shtesës së katit kanë kontribuar të dy si familje më vete. Subjekti dhe bashkëshorti deklarojnë se meqenëse objekti është ende në proces legalizimi, janë dakord të heqin dorë nga ½ pjesë e pandarë e pasurisë shtesë kati, deklaruar me vetëdeklarimin e datës 16.07.2013, në favor të z. I. G. dhe leja e legalizimit të lëshohet në emër të deklaruesve si bashkinvestitorë, A. G. dhe I. G., secili në ½ pjesë të pandarë. Subjekti ka paraqitur shkresën, nënshkruar prej bashkëshortit, drejtuar ASHK Vlorë/Drejtorisë së Legalizimeve, me lëndë “Dërgim dokumentacioni” dhe në përmbajtje shprehet se kërkon të depozitohet deklarata noteriale të sipërcituar në lidhje me përcaktimin e pjesëve takuese të z. A. G. dhe z. I. G.. Konstatohet se nga kjo shkresë, pa datë, nuk ka gjurmë të depozitimit pranë institucionit të adresuar.

29.4.2 Trupi gjykues, *së pari*, çmon të sjellë në vëmendje se deklarimi në deklarata *vetting* i vlerës totale të shpenzimeve të ndërtimit prej 1.000.000 lekësh, të cilën gjatë hetimit administrativ subjekti e deklaroi si investim të bashkëshortit të saj dhe shpjegon edhe ndarjen e saj në vite, përjashton pretendime në fazë të mëvonshme të procesit për ndryshim të “tablosë” me përfshirje si bashkinvestitorë të të tretëve. *Së dyti*, sipas qartësimeve në udhëzimin e ILDKPKI-së¹⁰⁷ lidhur me deklarimin e pasurive në proces legalizimi, në rast të bashkinvestimit me të vëllanë, subjekti duhet të kishte ndërmarrë në kohë veprimet pranë ALUIZNI-t, të kishte kryer deklarimin si bashkinvestitor duke e shoqëruar me dokumentacionin provues dhe jo gjatë kohës që zhvillohej procesi i rivlerësimit të subjektit. *Së treti*, pretendimi i subjektit për sa bashkëshorti dhe i vëllai janë bashkëpronarë në banesën ekzistuese, për rrjedhojë janë bashkëpronarë në shtesën e katit të ndërtuar në mënyrë informale mbi të, vlerësohet i pabazuar. Nga dëshmia e trashëgimisë ligjore të babait të bashkëshortit të subjektit, rezultojnë katër trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit, me pjesë të barabarta, për rrjedhojë, investimi në ndërtimin informal duket se nuk ka “respektuar” raportet e bashkëpronësisë së godinës ekzistuese. *Së katërti*, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të jetë rastësi që deklarata noteriale për njohje bashkinvestitori me ½ pjesë përpilohet dhe nënshkruhet më datë 26.08.2022, pasi subjekti ishte njohur me rezultatet e hetimit administrativ më datë 21.07.2022, dhe përpara se të paraqiste parashtrimet e saj më datë 07.09.2022, me të cilat ngre për herë të parë pretendimin për përgjysmim të shpenzimeve për ndërtimin e shtesës së katit, bazuar në këtë dokument si provë. Sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se edhe në këtë rast, deklarata noteriale është hartuar në mbështetje të pretendimeve të subjektit me qëllim për të ndikuar në përmirësimin e balancës negative të viteve korrente.

29.4.3 Përpos sa më sipër, gjatë hetimit administrativ¹⁰⁸, subjekti ka deklaruar ndarjen e vlerës 1.000.000 lekë në vite përkatësisht: *në vitin 2013, vlera 300.000 lekë; në vitin 2014, 100.000 lekë; në vitin 2015, 200.000 lekë; në vitin 2016, 100.000 lekë; në vitin 2017, 300.000 lekë; diferenca e*

¹⁰⁶ Në deklarata pasqyrohet se deklaruesit janë trashëgimtarë ligjorë të R. G., në emër të të cilit figuron në bashkëpronësi me 1/12 pjesë pasuria me nr. {***}, truall 267 m² dhe ndërtesë 267 m²; sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***}, datë 03.02.2016. Referuar aktit noterial, trashëgimtarë ligjorë të R. G. përcaktohen D. G., A. G., I. G. dhe M. R., të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga ¼ pjesë mbi pasurinë trashëgimore.

¹⁰⁷ Udhëzimi i ILDKPKI-së, në pikën 9, përcakton: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme në proces legalizimi pranë ALUIZNI, të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë këtij institucioni”.

¹⁰⁸ Në pyetësorin nr. 2, pyetja nr. 3: “Në D-Vett., keni deklaruar shtesë kati pa leje ndërtimi me sip. 70 m², ndërtuar mbi banesën ekzistuese në lagjen “{***}”, Vlorë, nga bashkëshorti juaj, me vlerë totale shpenzimi për ndërtimin 1.000.000 lekë me të ardhurat nga puna si avokat. Mund të deklaroni e provoni me dokumentacion ligjor vlerën e investimit, të mirëmbajtjes e shfrytëzimit të kësaj pasurie shtesë kati me sip. 70 m²? A janë bërë investime te kjo pasuri apartament dhe truall dhe, nëse po, sa janë vlerat e investuara dhe burimet financiare të përdorura?”

pagesave për përfundimin e pasurisë në vitin 2018 është kryer nga bashkëpronari tjetër dhe konkretisht, vëllai i bashkëshortit. Ky deklaram dëshmon sërish mungesë konsistence në qëndrimet e subjektit. Së pari, vjen në kontradiktë me deklaramin në DIPP-2016, ku kostoja prej 1.000.000 lekësh (totale) deklarohet shpenzim i kryer totalisht deri në vitin 2016. Për rrjedhojë, shpërndarja potenciale e kostos do të ishte në vitet 2013-2016, duke përjashtuar vitin 2017. Së dyti, konsideruar se deklarata vetting është dorëzuar më datë 28.01.2017, nuk duket e besueshme që për një periudhë 28-ditore të jetë shpenzuar një vlerë e njëjtë me atë të vitit 2013, kur është kryer një volum i madh punimesh. Së treti, deklarimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, se shtesa është bërë e banueshme në vitin 2017, përjashton pretendimin e saj për investime për përfundim të pasurisë në vitin 2018.

29.5 Në përmbyllje, sipas përfundimeve më sipër, kostoja totale e ndërtimit prej 2.022.080 lekësh, në kontrollin e analizës financiare të kryer në Kolegj, u shpërnda në vitet e periudhës 2013-2015, në këtë raport: (i) për vitin 2013, sipas fotografive bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit, dorëzuar më datë 16.07.2013, punimet e strukturës së ndërtimit ishin kryer, për rrjedhojë shpenzimet për ndërtim u përlllogaritën në vlerën 891.737 lekë, pasi bazuar në të dhënat zyrtare, ato përbëjnë rreth 441% të volumit të punimeve¹⁰⁹; (ii) për dy vitet vijuese, 2014-2015, u nda përpjesëtimisht pjesa e mbetur, prej 1.130.343 lekësh, me vlerë 565.171 lekë për secilin vit.

29.6 Nga rishikimi në Kolegj i analizës financiare të Komisionit për periudhën 2013-2015, ku të ardhurat e bashkëshortit për vitin 2013 mbetën të pandryshuara, për sa pretendimet lidhur me to u vlerësuan të pabazuara dhe kostoja e punimeve të ndërtimit u rishpërnda sipas vlerave të pasqyruara në paragrafin më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pamjaftueshmëri financiare në vlerën prej (-) 8.423.974 lekësh¹¹⁰ për përballimin me burime financiare të ligjshme të shpenzimeve të jetesës, shtimin e kursimeve dhe krijimin e pasurive.

29.7 Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së katit të banesës në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në geramat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C/III. Pasuri tokë me sip. 20.000 m², në Tale, Lezhë

- 30.** Lidhur me këtë pasuri, të deklaruar në deklaratën vetting nga personi i lidhur, bashkëshorti, Komisioni ka konkluduar: bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e avokatit, ka kryer veprime fiktive, duke nënshkruar një kontratë shitblerjeje (e cila ishte kontratë shkëmbimi), duke mos lëshuar faturë tatimore për shërbimin e kryer ndaj familjes Ll. L., si dhe duke shmangur pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit.

¹⁰⁹ Referuar marrëveshjes midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë “Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”, datë 17.05.2006, vlerave të shprehura në përqindje në tabelën 3.

¹¹⁰ Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, balancat rezultuan si vijojnë: viti 2013 prej (-) 2.254.950 lekësh, më pak se vlera e përlllogaritur nga Komisioni, prej 1.303.449 lekësh (nga vlera - 3.558.399 lekë), si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt - 565.776 lekë, konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 549.803 lekësh dhe uljes së shpenzimeve për ndërtimin e shtesës në Vlorë prej 1.319.423 lekësh (nga vlera llogaritur nga KPK prej 2.211.160 lekësh në pjesën e vlerës së rillogaritur Kolegj prej 891.737 lekësh); të vitit 2014 prej - 6.169.024 lekësh, më pak se KPK, prej 1.759.811 lekësh (nga vlera -7.928.835 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 1.926.057 lekë, konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 398.925 lekësh dhe shtimit të shpenzimeve për ndërtimin e shtesës në Vlorë për vlerën prej 565.171 lekë; në vitin 2015 balanca mbetet pozitive.

30.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

- i. Kontrata e porosisë mes dy avokatëve, bashkëshorti njëri prej avokatëve, dhe porositësit Ll. L., përfaqësues i bashkëpronarëve L., e lidhur më datë 12.06.2011, si dhe kontrata shtesë e vitit 2013 përcaktojnë qartë mënyrën e shpërblimit të avokatëve, 20.000 m² ose 1% të pronës së kthyer porositësve me vendim të KKK Pronave, Qarku Lezhë, konform ligjit nr. 9109/2003, urdhrit nr. {***} prot., datë 16.05.2005, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, neneve 659 e vijues dhe 913 të Kodit Civil.
- ii. Kontrata, pavarësisht e titulluar si kontratë shitblerjeje, në përmbajtje është kontratë shkëmbimi, si e vetmja mënyrë për kalimin e pronësisë në emër të avokatëve, dhe gjen bazueshmëri ligjore në nenet 757 e vijues të Kodit Civil. Kontrata dhe çmimi nuk janë fiktive pasi palët kanë pasur qëllim të sjellin pasojat juridike, dhe çmimi i përcaktuar prej 1.250.000 lekësh është vlera minimale për efekt fiskal, për sipërfaqe toke *kullotë* sepse për *moçal* (sipas certifikatës së pasurisë) nuk ka çmim reference. Sipas nenit 4 të kontratës së shitblerjes, nga bashkëshorti nuk është lëshuar asnjë faturë tatimore për shërbimet dhe nga z. Ll. L. nuk është kryer asnjë pagesë kundrejt punës si avokat dhe, për rrjedhojë, nuk ka pagim të detyrimeve tatimore.
- iii. Shpenzimet e shkëmbimit dhe të tjera shtesë që lidhen me tatimet janë në ngarkim të z. Ll. L., deklaruar prej tij përmes deklaratës noteriale me nr. {***}, datë 16.07.2022¹¹¹, për pasojë parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është konfirmuar marrëdhënia me familjen L. dhe ka të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.
- iv. Në momentin e kalimit të pronësisë në favor të bashkëshortit në vitin 2013, ka filluar gjykimi civil për pretendimin e kësaj prone nga të tretë, dhe me vendim të ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, prona është vënë në sekuestro. Duke konsideruar pronën në konflikt gjyqësor, ku mund të vendoset anulimi i titullit të pronësisë, bashkëshorti nuk ka ndërmarrë veprime sipas arsyetimit të Komisionit, pasi në mënyrë hipotetike, mund të humbte në pasurinë e tij duke paguar detyrimet tatimore, të cilat nuk mund të kthehen pavarësisht se ka humbur titullin e pronësisë.

30.2 Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se përfundimi i arritur për këtë pasuri nuk përfshihet prej Komisionit në konkluzionet përfundimtare për vlerësimin e kriterit të pasurisë e, për rrjedhojë, nuk ka dhënë pasojë në shkarkimin të subjektit të rivlerësimit nga detyra. Pavarësisht sa më sipër, pasi shqyrtoi aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson pretendimet e subjektit të pabazuara, për sa vijon.

30.3 Kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *vetting*: *një sipërfaqe prej 20.000 m² tokë, e titulluar “moçal,” e ndodhur në Tale, Lezhë, viti i krijimit datë 14.10.2013, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt.8.10.2013, e regjistruar në ZVRPP Lezhë me nr. {***} pasurie, vol. {***}, f. {***}, z.k {***}. Çmimi i blerjes 2.500.000 lekë. Burimi i blerjes së kësaj sipërfaqeje janë: kontrata e porosisë, dt. 12.6.2011 dhe kontrata shtesë e*

¹¹¹ Subjekti citon pjesë nga deklarata e z. Ll. L., se nuk ka bërë asnjë pagesë ndaj punës së avokatëve, se kontrata e vitit 2013 është kontratë shkëmbimi e të gjitha shpenzimet e këtij shkëmbimi dhe ato të tjera shtesë që lidhen me tatimet, janë në ngarkimin tim dhe të trashëgimtarëve.

porosisë, dt. 25.2.2013, ku objekti i tyre është dhënia e shërbimeve avokatore, konsulenca dhe përfaqësim në gjykim (shih vendimin nr. {***}, dt. 26.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). E pavlerësuar, sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa që zotëron: 50%.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2013, subjekti deklaron: pasuri e paluajtshme, lloji “moçal”, e ndodhur në Tale 2, Lezhë, e regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, ZK {***}, nr. {***} pasurie, f. {***}, me sip. 10.000 m², përfituar nga profesioni i b/shortit si avokat me nr. licence {***}, nëpërmjet kontratës së porosisë, dt. 12.6.2011, dhe kontratës shtesë të porosisë.

30.4 Nga aktet në fashikuj, rezulton se me kontratë porosie të datës 12.06.2011, bazuar në nenin 12, pika 2 e ligjit nr. 9109/2003, është formalizuar marrëdhënia juridike midis bashkëshortit të subjektit, në cilësinë e avokatit, dhe z. Ll. L. etj. Sipas përmbajtjes së këtij akti, avokat A. G. dhe avokat A. Sh. marrin përsipër të japin shërbime juridike, konsulenca të vijueshme juridike dhe të ndjekin si mbrojtës ligjorë të gjitha çështjet civile në të gjithë nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë, me objekt: *Shfuqizimin e vendimit nr. {***}, datë 10.12.2008, të AKKP-së Tiranë, lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 10.06.2008, të Zyrës Rajonale të KKP Qarku Lezhë dhe vendimit nr. {***}, datë 28.12.2002, të KKP Lezhë, dhe të pajisin porositësit me certifikatën e regjistrimit të pronës të fituar me vendimin nr. {***}, datë 10.06.2008, të Zyrës Rajonale të KKP Qarku Lezhë.* Kohëzgjatja e aktmarrëveshjes përcaktohet për periudhën e punës së kryer përpara hartimit të kontratës, e cila ka filluar që në datë 07.11.2008, vijon deri në zgjidhjen e çështjes dhe finalizohet me pajisjen e porositësve me certifikatë pronësie si bashkëpronarë të pronës. Për kryerjen e këtij shërbimi, shpërblimi për punën e avokatëve, do të jetë 20.000 m² nga prona e kthyer sipas vendimit nr. {***}, datë 10.06.2008, të Zyrës Rajonale të KKP Qarku Lezhë.

30.4.1 Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se vendimi nr. {***}, datë 10.06.2008, i KKKP Qarku Lezhë, është ekzekutuar nga shoqëria përmbartimore “{***}” ShPK për pjesën më të madhe të vendimit [...] në datën 05.05.2011, dhe pas këtij momenti është lidhur kontrata e porosisë, datë 12.06.2011¹¹². Në këto rrethana faktike, kontrata e porosisë është lidhur jo sipas parashikimeve të Kodit Civil¹¹³, dhe jo sipas parashikimeve të Kodit Etik të Avokatit¹¹⁴. Sa u përket tarifave të shërbimit, Kodi Etik i Avokatit parashikon: *marrëveshje me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit, sipas së cilës avokati merr përsipër të fillojë një çështje ose rast me tarifën minimale të përcaktuar dhe klienti bie dakord të paguajë tarifa të tjera shtesë për rezultatin pozitiv.* Gjithashtu, Dhoma e Avokatisë, ku bashkëshorti i subjektit bën pjesë, sjell në kujtesë të avokatëve rëndësinë e plotësimit të faturës së shitjes, për çdo shitje të realizuar të shërbimit të avokatisë¹¹⁵. Sa më sipër, bashkëshorti i subjektit, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik më datë 17.09.2007 dhe i pajisur me NIPT, nuk ka lëshuar asnjë faturë për shërbimet e kryera prej tij për një periudhë prej rreth 5 vjetësh, duke shmangur detyrimet tatimore.

30.4.2 Pas regjistrimit të pronës në ZVRPP Lezhë në emër të bashkëpronarëve L., dhe pjesëtimit të saj ku është veçuar sipërfaqja prej 20.000 m², më datë 14.02.2013, mes bashkëpronarëve L. dhe avokatëve, më datë 25.02.2013 lidhet kontrata shtesë e porosisë, ku në nenin 5 përcaktohet se:

¹¹² Shih përgjigjet e subjektit në pyetësin nr. 3, pyetja 2.

¹¹³ Kodi Civil, në nenin 913, parashikon: “Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër”.

¹¹⁴ Kodi Etik i Avokatit, në nenin 28, të titulluar “Tarifat”, në pikën 3 parashikon: “Avokati nuk duhet të ketë të drejtë të bëjë një pactum de quota litis. Me “pactum de quota litis” kuptohet një marrëveshje e arritur përpara përfundimit të çështjes, e cila përcakton tarifat që duhet t’i paguhen avokatit vetëm për rezultatet e arritura dhe në të cilën klienti merr përsipër t’i paguajë avokatit një pjesë të rezultatit të arritur”.

¹¹⁵ Shih: <https://dhka.org.al/sq/procedurat-tatimore/>.

porositësit, në zbatim të kontratës së porosisë, janë dakord se si shpërblim për avokatët është sipërfaqja prej 20.000 m², e përcaktuar në certifikatën për vërtetim pronësie të ZRPP Lezhë, lëshuar më datë 14.02.2013. Në vijim, me kontratë shitblerje të pasurisë së paluajtshme moçal, me nr. {***} kol., datë 8.10.2013, bashkëpronarët L. i shesin blerësve/avokatëve, pronën me sipërfaqe 20.000 m². Në nenin 4 të kontratës së shitblerjes përcaktohet çmimi minimal fiskal i shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme kullotë, është caktuar në vlerën 2.500.000 lekë, shumë e cila është likuiduar paraprakisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale [likuidimi është bërë në zbatim të kontratës së porosisë dhe kontratës shtesë të porosisë më datë 12.06.2011 dhe 25.02.2013]. Subjekti pretendon se ky përcaktim nuk ka të bëjë me likuidim monetar, por është shërbimi i konvertuar në pasuri të paluajtshme, është marrë çmimi minimal fiskal i pasurisë, por i titulluar kullotë dhe mënyra e vetme për kalimin e pronësisë mbetet kontrata e shitblerjes, pasi kalimi i pronësisë me kontratë dhurimi do të konsiderohej si fiktiv. Duke konstatuar se pasuria përcaktohet moçal në certifikatën e pronësisë dhe kartelën e pasurisë në emër të bashkëpronarëve L., e me të njëjtin zë kadastral përcaktohet në titullin dhe objektin e kontratës së shitblerjes, si dhe në certifikatën e pronësisë në emër të blerësve, nuk duket bindëse që për një pasuri, zëri kadastral i së cilës regjistrohej në regjistrat publikë, të kishte pengesa për futjen në qarkullim civil¹¹⁶.

30.4.3 Duke abstraguar lidhur me pasqyrimin e llojit të pasurisë në veprimet juridike të ndërmarra nga bashkëshorti i subjektit, trupi gjykues çmon të ndalet në pretendimin e subjektit se kontrata e shitjes në thelb, është kontratë shkëmbimi. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, pretendon se në rastin e saj, nuk janë të njëjtat kushte si në rastin e trajtuar prej Kolegjit, ku kontrata e porosisë ka qenë me dy mënyra – me vlerë monetare dhe në natyrë – dhe sipas saj, shpërblimi në vlerë monetare kërkon detyrimisht prerjen e faturës tatimore. Duke sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në çështje në të cilat subjektet e rivlerësimit kanë pretenduar krijim të pasurive të paluajtshme si pagesë në natyrë të përfaqësimit ligjor/shërbimeve të konsulencës juridike¹¹⁷, është vlerësuar se në mungesë të pagesës së detyrimeve tatimore për qëllim të ligjshmërisë së të ardhurave, pretendimet për pagesë në natyrë nëpërmjet një pasurie të paluajtshme, nuk e kapërcejnë pragun e kërkuar nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016. Në të kundërt sa pretenduar prej subjektit, në rastin e bashkëshortit të saj, përfitimi i shpërblimit si avokat për përfaqësim/shërbime të ofruara përgjatë një periudhe rreth 5-vjeçare, në kushtet e një konflikti civil që dokumentohet të ketë qenë dinamik përgjatë kësaj periudhe, përjashtojnë çdo pretendim lidhur me mosfaturimin e shërbimeve të kryera, qoftë edhe pas regjistrimit të pronës si realizim *de facto* i përfitimit të shpërblimit.

¹¹⁶ Në kontratën e shitjes, në nenin 3, “Informacion mbi pasurinë”, pasqyrohet lloji i pasurisë kullotë me vendndodhje në {***} të rrethit Lezhë [sipas kartelës së pasurisë në emër të shitësve], në nenin 4 përcaktohet çmimi minimal fiskal i shitjes së pasurisë së paluajtshme kullotë, e më tej në nenin 6 se ZVRPP Lezhë i lind e drejta e regjistrimit të pronës kullotë e ndodhur në Tale, Lezhë, në favor të blerësve.

Ndërkohë, në burime të hapura: <https://panel.klsh.org.al/storage/php7rADrr.pdf> identifikohet, KLSH - “Raport përfundimtar i auditimit “mbi auditimin e përputhshmërisë në ish-zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Lezhë”, shih faqet 15-16 të raportit ku pasqyrohet: “ZVRPP Lezhë ka ndryshuar zërin kadastral nga ranishte në moçal. Si bazë veprimi ka shërbyer referenca nr. {***}, datë 27.5.2011, lidhur me vendimin gjyqësor Lezhë {***}, datë 18.05.2016, jo i formës së prerë, i cili ka mbështetur vendimin {***}, datë 10.06.2008, të ZRKKP Lezhë, ky i fundit ishte rrëzuar nga AKKKP Tiranë, sipas vendimit nr. {***}, datë 10.12.2008. Këto vendime nuk flasin për tokë ranore për dhënie në favor të pronarëve. Vendimet e fundit të cituara në raportin e KLSH-së kanë të njëjtat ekstremite si ato të referuara në vendimet gjyqësore të paraqitura prej subjektit, dhe sipas deklarimeve të saj, është ekzekutuar vendimi {***}, datë 10.06.2008, i ZRKKP Lezhë.

¹¹⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 11/2022 (JR) dhe nr. 32/2022.

30.5 Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për pasurinë me sipërfaqe 20.000 m², tokë *moçal*, e ndodhur në Tale, Lezhë, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 8.10.2013, dhe burim krijimi dhënien e shërbimeve avokatore nga personi i lidhur, bashkëshorti, sipas kontratës së porosisë, datë 12.6.2011, dhe kontratës shtesë të porosisë, datë 25.2.2013, nënshkrimi i kontratës së shitblerjes për pasurinë që përftohej si shpërblim të shërbimeve të avokatisë, përbën një veprim juridik fiktiv (i simuluar) me synim shmangien nga detyrimet tatimore. Ky konkluzion mban në konsideratë edhe faktin se, prej personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, shërbimet e avokatisë janë ofruar për një periudhë të gjatë kohore, që nis prej vitit 2008, pa lëshuar asnjë faturë tatimore.

*C.IV. Pasuria automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}*

31. Subjekti i rivlerësimit kundërshton sa konkluduar për këtë pasuri në vendimin objekt shqyrtimi, *se nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, nuk justifikoi me burime të ligjshme blerjen e automjetit, sipas përcaktimeve të germës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke parashtruar si vijon.*

- i. Konkluzioni është alogjik dhe kontradiktor me vetë analizën financiare të Komisionit për vitin 2006, ku rezulton me balancë pozitive në vlerën 543.323 lekë, pa llogaritur të ardhura të tjera të pretenduara prej saj, por të papranuara prej Komisionit dhe provon tendencën dashakeqëse për të rënduar pozitën e saj, *edhe kur nuk nevojitet interpretim ligjor.*
- ii. Nuk janë marrë parasysh shpjegimet e saj se, pavarësisht se është blerë prej bashkëshortit dhe deklaruar prej tij si pjesë takuese 100%, automjeti hyn në ato sende të luajtshme të përdorimit vetjak, për arsye se subjekti nuk ka leje drejtimi për automjet, shërben për të gjithë familjen dhe natyrshëm është kontribuar për blerjen e tij nga të ardhurat e saj, të bashkëshortit¹¹⁸ dhe kursimet e depozituara në bankë nga ana e bashkëshortit, një pjesë e të cilave është tërhequr në vitin 2006.

31.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting* nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, me pjesë takuese 100% dhe burim krijimi nga të ardhurat nga puna si avokat, ndërsa në deklaratën e pasurisë të vitit 2006, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të kësaj pasurie. Sipas këtij deklarimi, Komisioni ka konsideruar të ardhurat e bashkëshortit të vërtetuara me dokumentacion ligjor, ato të përfituara nga angazhimi pranë {***}, për periudhën janar-mars 2006, në vlerë prej 1.662 USD ose prej 155.683 lekësh, e cila nuk e mbulon vlerën e automjetit prej 350.000 lekësh. Balanca pozitive e pretenduar prej subjektit, i referohet rezultatit të analizës financiare për të gjithë vitin 2006, e për rrjedhojë përfshin të ardhurat e përfituara pas blerjes së automjetit më datë 28.07.2006, që logjikisht nuk përbën bazë për të vlerësuar burimet e ligjshme për blerjen e makinës. Lidhur me të ardhurat të tjera të bashkëshortit nga puna si avokat, sikundër do të analizohet në detaje në vijim, nuk provohet ligjshmëria e tyre në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në kushtet kur nën përgjegjësinë e buruar nga ligji nr. 84/2016, burimi i krijimit të pasurisë automjet është deklaruar: *të ardhurat nga puna si avokat*, e për sa në deklaratën e pasurisë të vitit 2006 nuk është deklaruar burim krijimi, që në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në këtë proces, trupi gjykues i Kolegjit

¹¹⁸ Subjekti parashtron se blerja e pasurisë është kontribut dhe nga të ardhurat e bashkëshortit për vitin 2006, nga shërbimet juridike në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, punësimi pranë “{***}” ShPK për periudhën prill 2006 - shtator 2007, “{***}” ShPK.

vlerëson se çdo pretendim gjatë procesit të rivlerësimit, për konsiderim edhe të të ardhurave të tjera si burim për krijimin e pasurisë, mbetet deklarativ dhe i pabazuar.

31.2 Në përfundim, për pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, blerë në vitin 2006, me çmim 350.000 lekë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e tij. Përkundrejt burimit të krijimit të deklaruar në deklaratën *vetting*, të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit, nga puna si avokat, pretendimi i subjektit për krijimin e kësaj pasurie edhe me të ardhura të saj, mbeti deklarativ. Për rrjedhojë, përfundimi i Komisionit vlerësohet i drejtë, dhe subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e përcaktuara në germën “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.V. Pasuritë trashëgimore të bashkëshortit të subjektit

32. Për pasuritë e personit të lidhur, bashkëshortit, të trashëguara nga babai R. G., sipërfaqe trualli prej 6000 m², 3.590 m², 1.200 m², 8.399 m², 1.350 m², të ndodhura në Vlorë, subjekti parashtrroi se megjithëse konstaton se këto pasuri të përfituara me trashëgimi ligjore nuk japin ndonjë efekt, Komisioni konkludon se argumentet e saj lidhur me pasaktësi të emrit të bashkëshortit në dëshminë e trashëgimisë ligjore, nuk rezultuan bindëse, duke u kthyer në qesharak nga tendenca dashakeqëse dhe mllefi për të penalizuar me patjetër subjektin, duke cenuar besueshmërinë e të gjitha konkluzioneve të arritura për të gjitha gjetjet e tjera.

32.i. Në vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, ekzistenca e këtyre pasurive të bashkëshortit të fituara me trashëgimi ligjore dhe të paregjistruara në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting*, nuk prodhoi asnjë efekt. Për rrjedhojë, për sa pretendimet e subjektit lidhur me konkluzionet e Komisionit për pasuritë e tjera objekt kontrolli, analizohen bazuar në rrethanat faktike të rezultuara nga provat e administruara, trupi gjykues i Kolegjit çmoi të mos i atribuojë pretendimit analizim të mëtejshëm.

C.VI. Pasuritë llogari dhe depozita bankare të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit

33. Komisioni ka konkluduar se për pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike [depozita dhe llogari rrjedhëse], me burim nga të ardhurat e bashkëshortit nga puna si avokat, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor burimin e krijimit të totalit të likuiditeteve bankare. Ndërsa për pasuritë e deklaruara në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike nga bashkëshorti i subjektit, si llogari dhe depozita bankare me burim nga avokatia dhe nga administrimi i pronave të familjes M., janë pasuri të krijuara me të ardhura për të cilat bashkëshorti i subjektit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor përkatësinë dhe ndarjen e tyre dhe, si të tilla, ato vlerësohen se janë pasuri të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

33.1 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të deklaruara në deklaratën *vetting* nga angazhimi në veprimtari private me profesionin avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, në vlerën 24.318.000 lekë, Komisioni ka konkluduar se, sipas dokumentacionit provues, janë në një total prej 17.604.356 lekësh, ndërkohë likuiditetet e krijuara prej tij gjatë viteve, nuk kanë bazë krahasuese me të ardhurat totale të gjithë periudhës. Komisioni ka analizuar për mundësinë e krijimit të secilës prej këtyre llogarive/depozitave nga rezultati financiar i vitit përkatës të krijimit të tyre.

33.2. Lidhur me të ardhurat e deklaruara në deklaratën *vetting* pa shifër, nga administrimi i pronave të familjes M., Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshorti kanë bërë deklaram të pasaktë, me qëllim fshehjen e vlerave reale të përfituara, dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor vlerën e këtyre likuiditeteve në emër të bashkëshortit të saj dhe pagesën e detyrimit tatimor përkatës.

33.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me të ardhurat e bashkëshortit në periudhën 2000-2006, duke pretenduar se është kontradiktor, alogjik dhe jokoherent, dhe parashtron se:

- i. Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 2000-2006, nga veprimtaria jashtë qendrës së punës {***}/Ministria e Bujqësisë, si individ pranë shoqërive tregtare “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK etj., janë punë dytësore dhe detyrimet tatimore për shpërblimin e përfutur janë të shoqërive tregtare që kanë përfutur nga ofrimi i shërbimeve. Në mënyrë të gabuar, Komisioni ka interpretuar të ardhurat nga {***}, si të ardhura nga aktiviteti privat, kur në fakt ato janë të ardhura si rezultat i marrëdhënieve të punës dhe, për ndërprerjen e paligjshme të tyre, gjykata ka vendosur përfitimin e dëmshpërblimit.
- ii. Të ardhurat nga {***} [pagat dhe shpërblimet në fundvit] janë llogaritur në mënyrë të gabuar, duke mos konsideruar që paga në USD është indeksuar 1:1 me kursin e euros; nuk janë përfshirë disa paga të vitit 2000, 2004, shpërblimet me dy rroga në fundvit.
- iii. Konstatimi se vlera e gjendjes së llogarive dhe depozitave në fund të vitit 2016, është 41.326.002 lekë, ndërsa të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1997-2016, janë 17.262.799 lekë, është i gabuar, si rezultat i konvertimit të monedhave të ndryshme në të njëjtën periudhë kohore, dhjetor 2016, ndërkohë që depozitimet në bankë janë bërë në kohë të ndryshme.

33.3.1 Sa i përket konkluzionit të Komisionit lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga administrimi i pronave të familjes M., subjekti e kundërshton si alogjik, duke pretenduar se nuk është arsyetuar, nuk është analizuar prokura e përfaqësimit dhënë bashkëshortit, nuk janë marrë parasysh rrethanat faktike të kësaj marrëdhënieje, si një proces administrimi i papërfunduar, se puna e bashkëshortit nga viti 2001 ka qenë kryesisht administrim i këtyre pronave. Subjekti pretendon se këto të ardhura nuk duhet të llogariten si të ardhura nga puna si avokat [person fizik], dhe analiza financiare duhet të korrigjohet duke mos i konsideruar si të ardhura në pronësi të bashkëshortit të subjektit, por si të ardhura me burim të ligjshëm, për të cilat janë shlyer detyrimet tatimore.

33.4 Nga aktet në fashikull, rezulton e dokumentuar sa vijon.

- a. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit i ka deklaruar këto pasuri si vijojnë:
 - pasuritë depozita bankare në BKT, në vlerë 22.779 USD dhe 29.728 euro; në Intesa San Paolo Bank, në vlerë 40.255 euro; në Raiffeissen Bank, në vlerë 1.992.281 lekë, 80.652 USD, 2.348 USD dhe 30.048 euro; në ProCredit Bank, në vlerën 37.159 USD, me pjesë takuese 100%, dhe burim krijimi: *të ardhurat vjetore nga puna si avokat me nr. licence {***} dhe NIPT {***}*;
 - pasurinë llogari rrjedhëse në ProCredit Bank, në vlerën 51.438 USD, me pjesë takuese 100%, dhe burim krijimi: *të ardhurat e mia vjetore nga puna si avokat me nr. licence {***} dhe NIPT {***}, dhe nga administrimi i pronave të familjes M., sipas prokurës së përgjithshme, datë 4.7.2001, pika 6, 9 etj.*

- b. Në deklaratën *vetting*, në formularin e përshkrimit të të ardhurave, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si vijon:
- angazhim në veprimtari private, me profesionin avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, në vlerën 24.318.000 lekë;
 - angazhim pranë {***} pranë Ministrisë së Bujqësisë, për periudhën 2000 - 2006, në vlerën 40.000 USD;
 - angazhim pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për vitet 2004-2007, në vlerën 1.950.000 lekë;
 - angazhim pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerat 960.000 lekë dhe 24.000 euro;
 - të ardhura nga administrimi i pronave të familjes M. sipas prokurës së përgjithshme, datë 4.7.2001 (pa vlerë).
- c. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga angazhimi në veprimtari private, me profesionin avokat, në vlerën 24.318.000 lekë, gjatë hetimit administrativ¹¹⁹, subjekti ka deklaruar: (i) për periudhën shtator 1996 - prill 2000, posedojnë dokumentacion vetëm për shoqërinë “{***}” ShPK, shtetasin Xh. Sh.; si dhe disa vendime gjyqësore ku pasqyrohet aktiviteti i bashkëshortit si përfaqësues ligjor; (ii) për periudhën 2000 - shtator 2007, në formë tabelare, me vlera dhe vite përkatëse, të ardhurat korresponduese nga: {***}, Ministria e Bujqësisë; shoqëria “{***}” ShPK; shoqëria “{***}” ShPK; shoqëria “{***}” ShPK; {***}; shoqëria “{***}” ShPK; (iii) në lidhje me shpërblimin e punës dhe përqindjen e bashkëshortit për administrimin e pronave të familjes M., do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar, ku do të ndahet shpërblimi si person fizik [avokat] dhe shpërblimi si person fizik natyral për administrimin e pronave, duke zbritur shpenzimet e kryera për administrim. Lidhur me vlerat monetare të përfituara nga dhënia me qira e pronave të familjes M., për periudhën 2000-2016, subjekti i ka paraqitur vlerat në formë tabelare sipas viteve dhe kohëzgjatjes së kontratave të qirave, si dhe shumat e transferuara për bashkëpronarët M. për periudhën 2007-2015.

33.5 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga {***} pranë Ministrisë së Bujqësisë, të deklaruara në deklaratën *vetting* për periudhën 2000-2006, në vlerën 40.000 USD, *së pari*, në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni shprehet *për statusin e bashkëshortit të subjektit si i punësuar pranë {***}-së, Ministria e Bujqësisë, Komisioni nuk ka pasur objekt shqyrtimi çështjen nëse ai ishte i punësuar si jurist apo me kontratë si avokat pranë këtij institucioni, përkundrazi, Komisioni ka bërë pjesë të analizës financiare të ardhurat e përfituara për periudhën sipas dokumentacionit të sjellë nga subjekti (ku përfshihen kopje të kontratave, vendime gjyqësore urdhër ekzekutimi etj.).* Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se Komisioni këto të ardhura i ka konsideruar nga aktiviteti privat i bashkëshortit, rezulton i pabazuar.

33.6 Komisioni ka konkluduar se në total të ardhurat e bashkëshortit nga {***}-ja, arrijnë vlerën 35.162 USD: nga kontratat e shërbimit për periudhën maj 2000 - mars 2006, në vlerën 26.712 USD, dhe 8.450 USD nga vendimi i gjykatës për dëmshpërblim në vitin 2009. Konvertimi në lekë është kryer sipas kursit mesatar të dhjetorit të çdo viti. Subjekti pretendoi përllogaritje të gabuar, duke parashtruar: (i) për periudhën maj 2003 - 31 dhjetor 2005, nuk është llogaritur indeksimi i pagës me kursin e euros, pasi sipas marrëveshjes së Bankës Botërore dhe Ministrisë së Bujqësisë, paga është paguar në dollarë duke ruajtur raportin 1:1 me kursin e euros, për të mos cenuar të ardhurat e punonjësve; (ii) nuk janë përfshirë pagat e muajve prill, maj, gusht 2000; (iii) për

¹¹⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

periudhën 2000-2005, nuk janë përlllogaritur shpërblimet me dy paga mujore në vit, të cilat duhet të ishin llogaritur me kursin e euros. Për sa më sipër, subjekti pretendoi se provohen me vendimin nr. {***}, datë 19.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë transaksioni, datë 01.04.2006, të Bankës Kombëtare Tregtare, procesverbalin nr. {***}, nr. {***} prot., datë 29.12.2005, observacion mbi projekt-raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit¹²⁰ (në vijim “KLSH”).

33.6.1 Lidhur me pretendimin për indeksimin e pagës së bashkëshortit në dollarë, me kursin 1:1 në monedhën euro, nga aktet në fashikuj konstatohet se: (i) në shkresën e datës 15.05.2003, drejtuar ministrit të Bujqësisë, drejtori i Projektit bën prezent rënien e të ardhurave mujore të punonjësve nga rënia e kursit të dollarit, dakordësinë me menaxherin e projektit, që paga të konvertohet në raportin 1:1 me monedhën euro, dhe parashtron kërkesën për dhënie miratimi që konvertimi të fillojë për muajin maj 2003. Në shkresë pasqyrohet shënimi: “Ok. Datë 15.05.2003”, nënshkruar dhe vulosur me vulë të ministrisë; (ii) referuar observacionit për projekt-raportin e KLSH-së, faqja 45, pasqyrohet se nga data 15.05.2003, pagesat janë kryer në euro për shkak të rënies së kursit të USD-së. Duke vlerësuar provueshmërinë e dokumenteve të sipërcituara, trupi gjykues i vlerësoi të bazuara pretendimet e subjektit.

33.6.2 Lidhur me pretendimet për përfshirje: (i) të pagave të muajve prill, maj, gusht 2000, konstatohet se për këtë vit, Komisioni ka konsideruar pagat e 7,5 muajve, duke referuar datën e kontratës 15.05.2000, paga e muajit gusht rezulton e përfshirë, ndërsa pretendimet për pagë të muajit prill 2000, dhe gjysmës së parë të muajit maj mbetën deklarative, dhe u vlerësuan nga trupi gjykues të pabazuara; (ii) të shpërblimeve me dy paga mujore në vit për periudhën 2000-2005, sipas praktikës së Bankës Botërore që aplikon pagën e 14, të llogaritura me kursin e euros, subjekti shprehet se provohen me procesverbalin nr. {***} të KLSH-së dhe observacionin për projekt-raportin e KLSH-së. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar shpërblime me dy paga në vit për vitet 2004 dhe 2005, ndërsa në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ, i ka pretenduar nga viti 2000. Duke evidentuar mungesë konsistence në deklaratimet e subjektit, trupi gjykues konstaton se në aktet e referuara prej subjektit, evidentohet dhënia e dy shpërblimeve për vitin 2004. Konkretisht, në procesverbalin nr. 3 datë 29.12.2005, të KLSH-së, në pikën 2 pasqyrohet se më 31.12.2004, në bazë të miratimit të ish-ministrit, ish-drejtori i {***}-së ka urdhëruar dhënien e shpërblimit të stafit me dy paga mujore, që janë përballuar nga kostoja lokale e projektit, veprim i cili është vlerësuar se ka rritur përqindjen e kostos operative në raport me donatorin. Në observacionin e {***}-së, komentohet se {***}-ja vepron si njësi autonome dhe marrëdhëniet kanë qenë direkt me ministrat përkatës. Sa më sipër, provat e referuara nga subjekti nuk provojnë sa pretenduar prej tij se stafi i {***}-së ka përfituar shpërblim dy paga mujore, duke filluar nga viti 2000. Për më tepër, edhe në vitin 2004, për të cilin provohet përfitimi i dy pagave shpërblim, nuk provohet që të jetë aplikuar praktika e Bankës Botërore, e madje të mos jetë marrë as miratim prej saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit për përfitim të shpërblimeve me dy paga mujore duke filluar nga viti 2000, dhe në vlerësim të të dhënave nga dokumentet e sipërcituara, vlerësoi të marrë në konsideratë e të përfshijë në analizën financiare shpërblimin me dy paga mujore vetëm për vitin 2004.

¹²⁰ KLSH-ja, me shkresën {***} prot., datë 13.06.2022, përcjell procesverbalin me nr. {***} prot., datë 29.12.2005, mbajtur në Njësinë e Menaxhimit të {***}-së “Mbi kontrollin e kryer për marrëdhëniet e punës dhe të pagave”, dhe observacion mbi Projekt-raportin e KLSH-së, pjesë takuese lidhur me procesverbalin nr. {***}.

33.6.3 Në përmbyllje, duke reflektuar shpërblimet me dy paga mujore në vitin 2004, konvertimin e të ardhurave me kursin e euros për vitet 2003-2005, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga {***}-ja pranë Ministrisë së Bujqësisë, në total arrijnë në vlerën prej 27.612 USD ose prej 3.565.276 lekësh¹²¹.

34. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga shërbimet e kryera pranë shoqërive “{***}” ShPK, për vitet 2004-2007, me vlerë 1.950.000 lekë, “{***}” ShPK, për vitet 2005-2007, “{**}” ShPK, “{***}” ShPK, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga këto angazhime private të bashkëshortit të saj, sipas përcaktimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

34.1. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit pranë shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së lidhur me parimin e gjësë së gjykuar, dhe kërkon nga Kolegji që këto të ardhura të përfshihen në analizën financiare. Në vijim, analiza e trupit gjykues.

34.1.1 Subjekti pretendoi se shërbimi i kryer prej bashkëshortit pranë shoqërisë “{***}” ShPK ka qenë punë dytësore, pasi periudha e këtyre shërbimeve përkon me një pjesë të periudhës që bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë {***}-së, Ministria e Bujqësisë [si marrëdhënie pune parësore], provuar me kontratat e punës dhe vendimin gjyqësor. Në këto kushte, sipas udhëzimit nr. 3, datë 11.02.2002, tatimi në burim paguhej nga shoqëria që kryente pagesën. Së pari, përpos sa më lart analizuar, se Komisioni nuk ka analizuar lidhur me natyrën e marrëdhënies së bashkëshortit pranë {***}-së, konstatohet se vetë subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, të ardhurat e bashkëshortit nga {***}-ja i ka renditur *si të ardhura të bashkëshortit të realizuara nga veprimtaria private me profesion avokat*.

34.1.2 Së dyti, subjekti pretendoi se në këtë marrëdhënie pune, bashkëshorti ka ndarë punën si individ me pagë mujore 50.000 lekë, me atë si avokat, pasi në nenin e fundit të kontratës së porosisë parashikohet se përfaqësimi në gjykim me cilësinë e avokatit, do të jetë objekt i një marrëveshjeje tjetër me shoqërinë “{***}” ShPK. Sipas subjektit, cilësimi i bashkëshortit avokat në kontratën me këtë shoqëri, është në të njëjtat kushte si në kontratat e lidhura me {***}-në. Subjekti argumentoi se në gjykimin civil me objekt dëmshpërblimin e bashkëshortit për shkak të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, pala e paditur, {***}-ja, ka pretenduar se bashkëshorti i subjektit nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por avokat i jashtëm, duke iu referuar kontratave ku cilësohej si i tillë, dhe gjykata e ka zgjidhur në mënyrë shteruese problematikën, duke i konsideruar marrëdhënie pune¹²². Në bazë të nenit 451/a të Kodit të

¹²¹ Totali i të ardhurave, reflekton shumatoren e vlerave: viti 2000, në vlerën 2.250 USD (ose 328.680 lekë, rritur me 30.375 lekë, pas saktësimit të kursit të këmbimit. Komisioni ka referuar kursin e euros, ndërkohë të ardhurat janë në USD); në vitin 2001, në vlerën 3.600 USD (ose 493.336 lekë); në vitin 2002, në vlerën 3.600 USD (ose 485.878 lekë); në vitin 2003, në vlerën 4.800 USD (ose 641.520 lekë, shtuar me vlerën 119.808 lekë, me kursin e euros, ndryshe nga KPK-ja); në vitin 2004, në vlerën 6.300 USD (ose 798.462 lekë, shtuar me vlerën 287.730 lekë, si rezultat i konsiderimit të shpërblimeve dhe llogaritjes me kursin e euros); në vitin 2005 në vlerën 5.400 USD (ose 661.716 lekëve, shtuar me vlerën 103.734 lekë, nga llogaritja me kursin e euros); në vitin 2006, në vlerën 1.662 USD (ose 155.683 lekë), total prej 27.612 USD ose 3.565.276 lekësh. Me efekt rritës në ekuivalentin në lekë, krahasuar me Komisionin për periudhën 2000 – 2006, prej + 541.647 lekësh.

¹²² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 19.3.2007, ka vendosur pagimin e dëmshpërblimeve në favor të bashkëshortit: për ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme,

Procedurës Civile, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së, subjekti kërkoi që Kolegji duhet të mbajë në konsideratë rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, edhe në lidhje me parimin e *gjësë së gjykuar*.

34.1.3 Konstatohet se me kontratën e porosisë, hartuar nga av. A. G. - Dhoma e Avokatisë Tiranë - më datë 01.07.2004, me *bazë ligjore ligjin nr. 9109, datë 17.07.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenin 913¹²³ e vijues të Kodit Civil*, porositësi, shoqëria "{***}" ShPK, emëron si përfaqësues të posaçëm dhe mbrojtës të interesave, av. A. G., i cili merr përsipër të japë konsulencë juridike dhe të ndjekë si mbrojtës ligjor të gjitha çështjet civile që lidhen me shoqërinë, *si në organet administrative dhe ato gjyqësore*. Kohëzgjatja e *akt-marrëveshjes* përcaktohet me afat të pacaktuar, duke filluar nga data 01.07.2004; shpërblimi për avokatin 50.000 lekë/muaj, dhe për çështjet gjyqësore do të ketë një tarifë tjetër, e cila do të jetë objekt i një marrëveshjeje që i bashkëlidhet kontratës. Kontrata është firmosur nga i porosituri – bashkëshorti i subjektit – në cilësinë e avokatit. Me 35 mandatpagesa pasqyrohet pagimi i shumave 50.000 apo 100.000 lekë [në këtë rast, për dy muaj], nga shoqëria "{***}" për z. A. G. për "shërbime avokatie".

34.1.4 Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kontrata e porosisë, sipas bazës ligjore dhe në përmbajtje të saj, në mënyrë të qartë specifikon dhe artikulon kryerjen e shërbimeve të avokatisë përmes veprimeve juridike dhe dhënies së asistencës ligjore prej të porositurit, avokatit A. G., dhe parashikimi se përfaqësimi në gjykim do të jetë objekt i një marrëveshjeje tjetër, ka të bëjë me caktimin e një shpërblimi të ndryshëm për një shërbim brenda kufijve të porosisë. Duke arsyetuar *a contrario*, n.q.s. bashkëshorti përmes kësaj kontrate nuk do të gëzonte tagra përfaqësimi si avokat, atëherë do të ishte në pamundësi të realizonte përfaqësimin e kësaj shoqërie tregtare pranë organeve administrative, përfaqësim i parashikuar në nenin 1 të kontratës. Ky akt, të cilit, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 21 të Kodit të Punës, i mungojnë elementet thelbësore të kontratës së punës, si vendi i punës, elementet përbërëse të pagës, kohëzgjatja e pushimeve të paguara etj., si dhe referuar mandatpagesave të administruara që vërtetojnë se gjatë gjithë periudhës bashkëshorti i ka përfituar të ardhurat si avokat, e bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit për ndarje të punës së bashkëshortit në këtë marrëdhënie, si individ me atë si avokat. Gjithashtu, i pabazuar vlerësohet edhe pretendimi se në interpretim të marrëdhënieve të punës së bashkëshortit në harmoni dhe me nenin 4 të kontratës, që ka të bëjë me zgjidhjen e marrëdhënies, kontrata duhet të konsiderohet si kontratë pune. Parashikimi në këtë nen, i njoftimit 60 ditë përpara zgjidhjes së njëanshme të kontratës, nuk vlerësohet se vjen në mospërputhje me sa parashikon neni 13 i ligjit nr. 9091/2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", baza ligjore e përdorur për hartimin e kontratës¹²⁴. Gjithashtu, në DIPP-të e periudhës 2004-2007, që në kuptim të ligjit nr.

*me 7 muaj pagë; për mosrespektimin e afatit të njoftimit, me 3 muaj pagë; për moszbatim të procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës, me 2 muaj pagë; dhe shpërblimin për vjetërsi, me 3 muaj pagë. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, dhe rekursi i palës së paditur, {***}-së, nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë.*

¹²³ Kodi Civil, në nenin 913, të referuar si bazë ligjore të kontratës së porosisë, përcakton: "Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër".

¹²⁴ Ligji nr. 9091/2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", në nenin 13 parashikon: "Nëse avokati vendos të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e mëtejshme e një personi, është i detyruar ta njoftojë atë 15 ditë përpara mbarimit të shërbimit nga ana e tij. Në çdo rast, heqja dorë duhet bërë në një mënyrë dhe në një kohë të tillë që porositësi të marrë masa për të vepruar ndryshe, përveç rastit të një vështirësie të madhe nga ana e të porositurit".

84/2016, nenit 32, pika 5, kanë vlerën e provës, për personin e lidhur [bashkëshortin], subjekti ka deklaruar të ardhura si avokat/Dhoma Avokatisë Tiranë, dhe jo nga një marrëdhënie punësi si punë dytësore. Sa më sipër, në të gjitha këndvështrimet, provohet bindshëm se të ardhurat nga shoqëria “{***}” ShPK, bashkëshorti i subjektit i ka përfituar si avokat. Lidhur me pretendimin se në këtë rast, janë të njëjtat kushte ligjore si në kontratën e lidhur me {***}-në, ku bashkëshorti cilësohet avokat dhe marrëdhënia e punës është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, trupi gjykues konstaton se në arsyetimin e saj, gjykata ka vlerësuar se në asnjë nga kontratat e lidhura, nuk bëhet fjalë për porosi të {***}-së apo për marrëdhënie përfaqësimi sipas nenit 913 të Kodit Civil, dhe për të vlerësuar marrëdhënien, është bazuar edhe në dokumentacionin administrativ ku figuron pozicioni jurist. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se jemi përpara *gjësë së gjykuar*, është krejtësisht i pabazuar, për sa kontrata me “{***}” ShPK është bazuar pikërisht në nenin 913 të Kodit Civil, i munguar në kontratën me {***}-në, duke përbërë arsye që gjykata të vendosë se në atë rast nuk ka qenë marrëdhënie përfaqësimi. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit për fakte dhe rrethana të njëjta, e në këtë kontekst, rëndësinë e parimit të sigurisë juridike në lidhje me parimin *res judicata*, vlerësohet i pabazuar.

34.1.5 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga kërkimet për të siguruar dokumentacion në lidhje me pagimin nga shoqëria “{***}” ShPK të tatimeve në burim për shërbimet e kryera nga bashkëshorti, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ka rezultuar se kjo shoqëri për periudhën 2004-2007, nuk ka paguar tatim në burim për punonjësit e saj. Gjithashtu, për këtë qëllim, i është drejtuar me kërkesë shoqërisë, e cila nuk i ka kthyer përgjigje, megjithëse ka marrë dijëni. Duke bërë me dije se kjo shoqëri me aktivitete të madh në fushën e ndërtimit në atë periudhë, ka qenë subjekt i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, dhe kontrolluar në vijimësi nga organet tatimore, subjekti pretendoi se në analizë të shkresës së organeve tatimore, si *dhe qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në raste të ngjashme*, nuk është e përjashtuar mundësia e pagesës së detyrimit tatimor (në burim) nga shoqëria, jashtë sistemit tatimor. Subjekti pretendoi se: (i) Komisioni, me paragjykim, nuk ka marrë në konsideratë si një të tërë, në përmbajtje, shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë¹²⁵, duke anashkaluar paragrafin ku jepet informacioni: *për këto periudha, deklarimi i tatimit në burim nuk kishte deklaruar tip dhe nuk është deklaruar elektronikisht, pagesat kryheshin nga jashtë sistemit tatimor*; (ii) sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është në pamundësi objektive për të vërtetuar pagimin e tatimit në burim nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK, sepse këto pagesa mund të jenë kryer jashtë sistemit tatimor.

34.1.6 Trupi gjykues vlerëson se në përmbajtje të shkresës së DRT Tiranë, si një e tërë, dhe të paragrafit të cituar prej subjektit, nuk rezulton pamundësi për të siguruar informacionin e kërkuar, për sa nuk referohet kërkimi në burimet arkivore si alternativ, i papërmendur as në kërkesën e subjektit. Për më tepër, duke analizuar, sipas pretendimit të subjektit, se ka qenë marrëdhënie punësi dhe detyrimet tatimore janë paguar nga shoqëria “{***}” ShPK, rrjedhimisht në përmbushje të detyrimeve ligjore, nga shoqëria duhet të ishin paguar edhe sigurimet shoqërore, të cilat do të rezultonin në të dhënat dhe arkivat e institucioneve shtetërore përkatëse, pasi ato ruhen deri në moshën e daljes në pension. Subjekti nuk shprehet lidhur me to, e as ka adresuar ndonjë kërkesë në institucionet përkatëse për të marrë informacion që do të shërbente si provë për sa

¹²⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 10.06.2022, adresuar subjektit sipas kërkesës për pajisje me vërtetim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, protokolluar me nr. {***}, datë 27.05.2022, nr. {***}, datë 30.05.2022, lidhur me shërbimet e kryera për shoqërinë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, si dhe shoqërinë “{***}” ShPK, me NIPT {***}.

pretenduar. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit lidhur me interpretimin prej Komisionit të shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, dhe se është në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara.

34.1.7 Përpos sa më sipër, në kontratën e porosisë për kryerjen e shërbimeve, për avokatin A. G., përcaktohet shpërblimi prej 50.000 lekësh në muaj, dhe me mandatpagesat e paraqitura me deklaratën *vetting*, të nënshkruara prej tij, kjo vlerë është tërhequr *cash*, çka dëshmon se bashkëshorti i subjektit ka qenë në dijeni se prej shoqërisë “{***}” ShPK nuk mbahej asnjë ndalesë për pagimin e detyrimeve tatimore. Referuar parashtrimin të subjektit *se është detyrë e punëdhënësit që të bëjë ndalesat në borderotë e pagave, për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me punësimin aktual*, edhe duke analizuar *a contrario* se marrëdhënia ka qenë punësimi, do të rezultonte se bashkëshorti ka qenë në kushtet e keqbesimit, sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pasi ai firmoste dhe përfitonte pagën e plotë, çka dëshmon se dakordësonte shmangien e detyrimeve tatimore në kundërshtim me ligjin. Faktet që bashkëshorti ka përfituar të ardhurën mujore të plotë, aq sa përcaktuar në kontratën e porosisë, dhe se nuk ka asnjë gjurmë dokumentare në kohë reale që bashkëshorti i subjektit t’i jetë drejtuar shoqërisë për pagesën e detyrimeve tatimore, apo pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, por të kërkojë informacion vetëm në funksion të këtij procesi, krijojnë bindjen se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për marrëdhënie punësimi dhe për pagim të detyrimeve tatimore prej shoqërisë, janë të pabazuara dhe përpjekje për të paraqitur një tablo të ndryshme nga ajo faktike.

34.1.8 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka konstatuar në mënyrë të drejtë situatën faktike nëpërmjet provave të marra në shqyrtim, duke arritur në konkluzionin se kur kontrata/marrëveshja lidhet në cilësinë e avokatit, siç është kontrata e porosisë së vitit 2004 ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe avokatit A. G., ky i fundit duhej të ishte patjetër i regjistruar si subjekt tatimor, të lëshonte faturë dhe ta depozitonte pranë organeve tatimore, duke paguar edhe detyrimet përkatëse. Për sa bashkëshorti ofronte shërbime si avokat, i paregjistruar në organet tatimore, detyrimin për derdhjen e tatimit në shtet e ka përfituesi i shërbimit, por, njëkohësisht, ai ka detyrimin për ta vënë në dijeni ofruesin e shërbimit për pagesën e tatimit sipas pikës 2 të nenit 35 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, që parashikon: “Paguesi i këtyre shumave duhet të nxjerrë pagesat e përfitimeve dhe mbajtjen në burim të tatimeve dhe t’ua vërë në dispozicion organeve tatimore, si dhe personit për të cilin është bërë pagesa, regjistrimet përkatëse”. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për të konsideruar shërbimet pranë shoqërisë “{***}” ShPK si punë dytësore, e që të ardhurat e përfituara si *shpërblime* u nënshtrohen rregullimeve sipas udhëzimit nr. 3, datë 11.02.2002¹²⁶.

¹²⁶ Subjekti referon në pikat 2.3.1 dhe 2.3.8 të udhëzimit nr. 3/2002, të titulluar “Për tatimin mbi të ardhurat”. Në këtë akt, në pikën 2.3, “Të ardhura të tatueshme” renditen nën pikat 2.3.1., pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; dhe 2.3.8, të ardhurat nga burime të tjera, ku parashikohet: “Çdo individ që përfiton të ardhura nga burime të tjera të cilat nuk përmenden në pikat e mësipërme, taten në masën 10 për qind. Sikurse u sqarua në pikën 2.3.1 të këtij udhëzimi, në këto të ardhura, por duke mos u kufizuar vetëm në to, futen edhe të ardhurat që mund të përfitojnë individët nga shpërblime që nuk kanë të bëjnë me marrëdhëniet aktuale të punës (me detyrat funksionale të vendit të punës ku individit është i punësuar), si nga honorarë të ndryshëm, shpërblime nga pjesëmarrje në komisione, borde, këshilla, qofshin këto organe të subjektit ku është i punësuar individit përfitues, apo të subjekteve të tjera jashtë qendrës së tij efektive të punës. Në rastet kur ky shpërblim paguhet nga qendra e punës ku është i punësuar individit, do të taten me 10 për qind ai shpërblim për pjesëmarrje, i cili nuk paguhet në mënyrë sistematike

Të ardhurat nga shoqëria “{***}” ShPK, me pagë mujore fikse, nuk kanë qasje me *shpërblime nga pjesëmarrje në komisione, borde, këshilla, qofshin këto organe të subjektit ku është i punësuar individi përfitues, qofshin këto organe të subjektit ku është i punësuar individi përfitues, apo të subjekteve të tjera jashtë qendrës së tij efektive të punës.*

34.2 Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur [bashkëshortit], nga shoqëria “{***}” ShPK, Komisioni ka konkluduar se të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia me këtë shoqëri, për vitet 2005-2007, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, pasi subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara pranë shoqërisë “{***}” ShPK në vlerat 960.000 lekë dhe 24.000 euro, sipas deklaratimit në deklaratën *vetting* dhe, si të tilla, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare.

34.2.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky konkluzion është alogjik, kontradiktor, në kundërshtim me një pjesë të arsyetimit për marrëdhënien me shoqërinë “{***}” ShPK, në kundërshtim me Kodin e Punës, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar”. Subjekti parashtron se:

(i) Bashkëshorti në këtë marrëdhënie nuk ka qenë i punësuar si avokat, por si individ, me pagë mujore 30.000 lekë, dhe shpërblime të tjera në euro për shërbime juridike të suksesshme të kryera. Komisioni është kontradiktor në arsyetim, në rastin e shoqërisë “{***}” ShPK i referohet titullit *avokat* në kontratën e porosisë, ndërsa në rastin e shoqërisë “{***}” ShPK, arsyeton se borderotë nuk janë në formën e kërkuar nga ligji e se ato duhet të ishin dorëzuar pranë organeve tatimore.

(ii) Shërbimet juridike pranë shoqërisë “{***}” ShPK kanë qenë punë dytësore deri më datë 31.03.2006, periudhë e cila korrespondon me punësimin pranë {***}-së dhe, sipas udhëzimit nr. 3, datë 11.02.2002, “Për tatimin mbi të ardhurat”, detyrimi tatimor paguhej nga shoqëria. Për periudhën prill 2006 - shtator 2007, ka qenë si i punësuar sipas dispozitave të Kodit të Punës. Moshartimi i kontratës së punës, midis shoqërisë dhe bashkëshortit, është përgjegjësi e punëdhënësit, sikundër edhe forma, mënyra e mbajtjes së borderove dhe e dorëzimit të tyre pranë organeve tatimore, sipas legjislacionit tatimor, janë përgjegjësi e shoqërisë.

(iii) Referuar shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe mospërgjigjes prej shoqërisë “{***}” ShPK, sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, është në pamundësi objektive për të vërtetuar pagimin prej shoqërisë të tatimit në burim, pasi pagesat mund të jenë kryer nga ana e shoqërisë edhe nga jashtë sistemit tatimor.

34.2.2 Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti nuk ka deklaruar periudhën kur i ka përfituar të ardhurat nga “{***}” ShPK, dhe si dokumentacion justifikues ligjor bashkëlidhur ka paraqitur kopje të noteruara të borderove të pagave, disa prej të cilave kanë nënshkrim dhe vulë të shoqërisë, ku figuron A.G. me *profesion avokat, paga 30.000 lekë* dhe nënshkrim në kolonën

në çdo muaj të vitit. Si të ardhura personale të tatueshme të individëve, konsiderohen edhe tërheqjet nga kapitali i shoqërisë, që bëjnë pronarët apo pronari i vetëm i kësaj shoqërie”.

përkatëse. Gjithashtu janë të administruara kërkesa të av. A. G., për pagim të shërbimeve avokatore¹²⁷, dhe mandatpagesa për shpenzime gjyqësore të nënshkruara prej tij¹²⁸.

34.2.3 Në borderotë e paraqitura si dokumentacion justifikues ligjor, mungojnë të dhëna për mbajtje të tatimit mbi të ardhurat apo kontribute të tjera të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi (shoqërore, shëndetësore). Duke analizuar *a contrario*, se të ardhurat janë nga punësimi, subjekti ka pasur detyrimin që me deklaratën *vetting*, të paraqesë dokumentacion për të ardhurat *neto*, sipas udhëzimit të ILDKPKI-së, detyrim i papërbushur me dokumentacionin e dorëzuar. Sikundër edhe në rastin e shoqërisë “{***}” ShPK, edhe për shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti pretendon se ka adresuar kërkesë pranë shoqërive, por nuk ka marrë përgjigje. Në vlerësim të rëndësisë së barrës së provës në procesin e rivlerësimit kalimtar, konsideruar mundësitë për të kontaktuar dhe insistuar pranë këtyre shoqërive për të siguruar informacionin e nevojshëm, duket se subjekti me adresimin e vetëm një kërkesë dhe kujdesit për të vërtetuar se kërkesa është dorëzuar nga shërbimi postar, të ketë pasur synim të vetëm dokumentimin e përpjekjes që nuk ka dhënë rezultat. Konkretisht, kërkesa e subjektit adresuar shoqërisë “{***}” ShPK, është dorëzuar në destinacion më datë 15.06.2022, seanca dëgjimore është zhvilluar më datë 28.09.2022, e në një periudhë tremujore nuk duket që subjekti të ketë bërë përpjekje për të marrë doemos një përgjigje.

34.2.4 Në analizë të akteve të sipërcituara, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit se pranë shoqërisë “{***}” ShPK, bashkëshorti ka qenë i punësuar si individ, për sa në dokumentacionin e paraqitur, pozicioni i bashkëshortit përcaktohet “avokat”, madje në këtë marrëdhënie, me mandatpagesat provohet përfitimi i shpërblimeve nga përfaqësimi në gjykime, atribut i avokatit. Në kushtet kur edhe për shërbimet ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, si në rastin e shoqërisë “{***}” ShPK, provohet se bashkëshorti ka vepruar si avokat, lidhur me pretendimet për shpërblime nga punë dytësore, për zbatim të parimit të *gjësë së gjykuar*, për interpretim si një të tërë të shkresave të institucioneve tatimore, analiza është e njëjtë si në paragrafët më lart e, për rrjedhojë, edhe në këtë rast vlerësohen të pabazuara.

34.3 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga shoqëria “{***}” ShPK, prej 2.800.000 lekësh, në vitin 2005, Komisioni ka konkluduar të mos i përfshijë në analizën financiare pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore.

34.3.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se në marrëveshjen e bashkëshortit me shoqërinë, me objekt ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Lushnje, në lidhje me kthimin e dëmshpërblimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ishte parashikuar që bashkëshorti do të përfitonte vlerën 50%. Pagimin e tatimit në burim në masën 10% e provon me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. {***}, datë 28.06.2006, pjesë e praktikës përmbarimore, ku sqarohet se: [...] *tatimi në burim i mbajtur kësaj shoqërie, është mbështetur në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 8, germa “g”, dhe udhëzimin e ministrit të Financave nr. 5/2008, pika 2.6.3, ku theksohet se të ardhurat e përfituara i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale dhe mbahen në burim nga pagesi i të ardhurave në masën 10%, që i derdh ato në organin tatimor përkatës jo më vonë [...]. Në rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke qenë njëherazi dhe agent tatimor,*

¹²⁷ Kërkesa për detyrim për pagesa lidhur me përfaqësim në gjykatë: në datën 15.11.2006, për shumën prej 1.500 eurosh; në datën 15.01.2007, për shumën 500 euro; në datën 27.09.2007, për shumën 3.000 euro.

¹²⁸ Mandatpagesa nr. {***}, datë 11.04.2005, shuma 100.000 lekë; nr. {***}, datë 26.04.2005, shuma 150.000 lekë; nr. {***}, datë 03.05.2005, shuma 30.000 lekë; nr. {***}, datë 24.06.2005, shuma 20.000 lekë; nr. {***}, datë 27.07.2006, shuma 120.000 lekë;

ka zbatuar me korrektësi ligjin dhe udhëzimin e cituar më lart për ekzekutimin e plotë të vendimit nr. 362, datë 22.09.1997, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje [...]. Sipas subjektit: (i) tatimi i mbajtur nga organet tatimore, në shumën prej 615.600 lekësh, është tatimi i mbajtur për secilën palë kontraktuese; (ii) duke theksuar se në këtë periudhë, bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë {***}-së, dhe ky shërbim ka qenë punë dytësore, subjekti parashtron se nëse edhe bashkëshorti do të paguante tatim të shumës së përfutur, do të tatohej dy herë; (iii) arsyetimi i Komisionit se vendimet gjyqësore nuk tatoheshin me ndryshimet e ligjit nr. 8438/1998 në vitin 2012, nuk ka vlerë për çështjen konkrete.

34.3.2 Nga aktet në fashikuj, konstatohet se në parashtrime, subjekti ka pretenduar: *vlen të theksohet se në bazë të ligjit nr. 8438, pika 8/1, në të cilin është përcaktuar se vendimet gjyqësore me objekt shpërblim dëmi janë të përjashtuara nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe për rastin konkret, shuma e mbajtur nga organet tatimore është vetëm tatimi mbi të ardhurat e ndara nga bashkëshorti im dhe shoqëria përkatëse*¹²⁹, dhe në seancën dëgjimore, bashkëshorti i subjektit shprehet se: *neni 8, pika 1 e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcakton se vendimet gjyqësore për shpërblim dëmi janë të përjashtuara nga të ardhurat*¹³⁰. Për rrjedhojë, në përgjigje të sa pretenduar prej subjektit, në vendim, Komisioni ka analizuar se ky parashikim ligjor u përket ndryshimeve që pësoi ligji nr. 8438/1998 në vitin 2012.

34.3.3 Nga aktet në fashikuj, *së pari*, konstatohet se këto të ardhura të bashkëshortit nuk janë deklaruar në deklaratën *vetting*, në DIPP-2005 subjekti nuk deklaroi asnjë të ardhur për bashkëshortin, por i ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit 3, duke paraqitur si dokumentacion: (i) prokurën e përgjithshme nr. {***}, datë 4.5.2005, me të cilën shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i saj A. V., emëron përfaqësues të posaçëm *avokatin* A. G., që ta përfaqësojë në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. {***}, datë 22.9.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; (ii) procesverbalin, datë 27.12.2005, mbajtur me shkrim dore, mes porositësit A. V., administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, dhe av. A. G., ku pasqyrohet ndarja mes tyre në masën 50%, e shumës së ekzekutuar prej 5.640.400 lekësh; (iii) praktikën përmbartimore të vitit 2006, lidhur me ekzekutimin edhe të shumës së mbajtur, 10%, si tatim në burim për shumën e ekzekutuar.

34.3.4 Në procesverbalin, datë 27.12.2005, mbajtur me shkrim dore, mes porositësit A. V., administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, dhe av. A. G., ndër të tjera pasqyrohet *tatimi në burim i mbajtur nga DRT-ja prej 10%, në vlerën 615.600 lekë, do të llogaritet i paguar nga të dyja palët në masën 50%. Për shumën e mbajtur do të vazhdojë ekzekutimi, e cila në rast se do të ekzekutohet, do të ndahet 50% secili*, që tregon qartë synimin edhe të avokatit/ bashkëshortit të subjektit për të mos paguar asnjë detyrim tatimor për shumën e përfutur. Kjo potencohet edhe nga korrespondencat e vitit 2006, në dosjen përmbartimore, për të ekzekutuar edhe shumën e mbajtur prej 10% si tatim mbi shumën e ekzekutuar. Për rrjedhojë, me veprime konkludente, në kohën e përfutimit të shumës, bashkëshorti i subjektit si avokat ka dëshmuar qëndrimin për mospagim të detyrimeve tatimore, të asnjë lloji. Për sa me dokumentacionin e administruar, rezulton se bashkëshorti i subjektit, me shërbimin e ofruar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, ka ushtruar veprimtari si avokat, pretendimi i subjektit *se ky shërbim ka qenë punë dytësore*, vlerësohet i pabazuar. Për shpërblimin e marrë si avokat, bashkëshorti ka pasur detyrimin për të paguar detyrimin tatimor në zbatim të ligjit nr. 8438/1998, ku *parashikohet se çdo e ardhur personale e përfutur, i nënshtrohet detyrimit të pagimit të tatimit mbi këto të ardhura*.

¹²⁹ Shih parashtrimet e subjektit, f. 29, paragrafi i fundit.

¹³⁰ Shih faqen 52 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

34.4 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve: 50.000 lekë në vitin 2003 nga “{***}”¹³¹ dhe 100.000 lekë nga Xh. Sh. në vitin 1997¹³², subjekti pretendon ligjshmërinë e tyre me të njëjtin arsyetim, se duke qenë punë dytësore dhe detyrimet tatimore paguhen nga ai që kryen pagesën. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se edhe në marrëdhënie me të sipërpërmendurit, bashkëshorti i subjektit ka vepruar si avokat në një periudhë që nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, dhe nuk ka asnjë gjurmë dokumentare që të provojë pagimin e detyrimeve tatimore. Për rrjedhojë, me të njëjtin arsyetim si analizuar në paragrafin 32.1.viii më lart në këtë vendim, pretendimet e subjektit, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara.

C.V.I. Të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, nga administrimi i pronave të familjes M.

35 Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshorti kanë bërë deklaram të pasaktë, me qëllim fshehjen e vlerave reale të përfituara nga shërbimi dhe administrimi i pronave të familjes M.. Ky konkluzion është bazuar në përfundimet si vijojnë.

i. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar si pasuri disa llogari dhe depozita bankare me burim nga avokatia, me një vlerë të konsiderueshme, ndërsa te përshkrimi i të ardhurave, ndër të tjera, deklaronte të ardhura nga administrimi i pronave të familjes M. sipas prokurës së vitit 2001, pa deklaruar vlerë.

ii. Në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar në asnjë rast detyrime ndaj të tretëve.

iii. Likuiditetet në llogari dhe depozita nga administrimi i pronave të familjes M. janë të shpërndara në disa llogari bankare, ndarja e tyre nga të ardhurat e tjera të bashkëshortit të subjektit është pothuaj e pamundur. Mungesa e një kontrate ndërmjet familjes M. dhe bashkëshortit të subjektit lë të papërcaktuara pjesët takuese të bashkëpronarëve dhe të fitimit të subjektit. Shërbimi dhe administrimi i kryer në vite nga bashkëshorti i subjektit, nuk është shoqëruar me faturë tatimore, por edhe nëse pozita dhe roli i tij do të ishin sqaruar në këtë marrëdhënie, mënyra e shpërndarjes së fitimit nuk do të shuante detyrimin për të faturuar shërbimin e ofruar në të shkuarën, si dhe detyrimin e subjektit për ta deklaruar atë në vite.

35.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit si alogjik dhe të pabazuar në ligj e në prova, duke parashtruar si vijon.

¹³¹ Subjekti ka paraqitur kopje të noteruara të akteve të emërtuara: “Pagesa të kryera nga {***} për {***}”, disa të nënshkruara nga ekonomiste D. D.. Ndër shumë zëra të tjerë, pasqyrohet: “datë 23.10.03 -pagesë avokati për veprimet e {***} - 30.000 lekë”, dhe: “datë 13.11.2003 - A. G., shpenzime juridike - 20.000 lekë”.

¹³²Subjekti ka paraqitur prokurë të posaçme, datë 05.09.1997, nr. {***}, me të cilën Xh. Sh. emëron përfaqësues të posaçëm av. A. G., për përfaqësimin në gjykimin e çështjes civile me palë të paditur AKP Tiranë, me objekt padie: “Kthim shume lekësh për shpenzime të nevojshme të bëra në një magazinë” dhe aktmarrëveshje, datë 15.01.2002, shkresë e thjeshtë, lidhur në bazë të ligjit nr. 7827, datë 31.05.1994, “Për avokatinë në RSh”, neni 35, kreu I, ku nga teksti i marrëveshjes evidentohet se vetëm për gjykimin e çështjes në shkallë të parë, pagesa e avokatit – 100.000 lekë – është dhënë nga Xh. Sh. dhe është tërhequr nga av. A. G..

- i. Duke mos arsyetuar dhe mos marrë parasysh faktet që lidhen me mosmarrëveshjet dhe kontradiktat mes bashkëpronarëve M., për kërkimin e vlerës 60 mijë dollarë pa interesa, si dhe marrëdhënien e bashkëshortit si mik i kësaj familjeje, bashkëshorti nuk është trajtuar si individ natyror, dhe qëllimisht marrëdhënia nuk është konsideruar si një proces administrimi i përfunduar.
- ii. Prokura e përgjithshme, për nga përmbajtja e saj, duhet të konsiderohet si kontratë porosie. Në analizë të tagrave të prokurës, provave të administruara, rezulton se puna e bashkëshortit ka qenë kryesisht administrim dhe, në këto kushte, duhet të trajtohet si individ natyror e jo si avokat. Bashkëshorti nuk ka kryer shërbime avokatie e, për rrjedhojë, nuk ka faturuar shërbime. Llogaritë dhe depozitat që janë krijuar nga ky administrim, janë likuiditete në llogaritë bankare të bashkëshortit si individ, dhe jo si person fizik.
- iii. Meqenëse nuk është përfunduar kontrata e porosisë, provuar me vazhdimësinë e kontratave të qirave dhe vjeljen e qirave, rezulton se dhe shumat, si të drejta reale të familjes M., janë në bankë, likuiditete të pacenuara, çka tregon se bashkëshorti nuk ka shtuar pasuri me to, prandaj nuk duhej të përfshiheshin në analizë financiare si të ardhura nga puna si avokat.
- iv. Të ardhurat [qiratë] nga administrimi i pronave të familjes M. nga viti 2001 e në vazhdim, nga bashkëshorti i subjektit, janë të ardhura të ligjshme, pasi janë të identifikuar, është paguar tatimi në burim nga qiramarrësit, janë të deklaruara pasi ndodhen në llogari bankare, nuk kanë lidhje me punën si avokat, por si individ.
- v. Deklarimet lidhur me marrëdhënien e bashkëshortit me familjen M., janë konfirmuar nga deklarata noteriale e datës 09.08.2022¹³³, e bashkëpronares R. D.. Në këto kushte, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti, si dhe personat e tjerë – familja M. – kanë konfirmuar marrëdhënien dhe e kanë të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, likuiditete në llogaritë bankare.
- vi. Konkluzioni për konsiderimin e vlerave monetare të ndodhura në llogaritë bankare të bashkëshortit, të familjes M., si të ardhura nga shërbimet e avokatisë të bashkëshortit, të ndara në dy periudha, para dhe pas regjistrimit në organet tatimore, është kontradiktor edhe sikur këto të ardhura të ishin të tilla. Për periudhën që bashkëshorti nuk ka qenë i regjistruar pranë organeve tatimore, ka qenë i punësuar pranë {***}-së dhe shoqërive tregtare, për rrjedhojë të gjitha shërbimet juridike, përfshirë edhe administrimin e pronave të familjes M., kanë qenë punë dytësore. Për periudhën 2007-2016 që bashkëshorti ka qenë i regjistruar në organet tatimore, në mënyrë të padrejtë janë bashkuar të ardhurat nga qiratë e familjes M. me të ardhurat nga puna si avokat me taksë fikse të paguar për fashën 3-4 milionë lekë, duke nxjerrë për këtë periudhë pamundësi financiare.
- vii. Edhe në rastin hipotetik të një marrëveshjeje për shpërndarjen e fitimit, sipas arsytimit të Komisionit, bashkëshorti do të përfitonte 20% të të ardhurave nga qiratë dhe 80% do t'i mbeteshin familjes M., dhe detyrimi tatimor që do të duhej të paguhej në mandate të veçanta, është arkëtuar në burim nga personat juridikë që ushtrojnë aktivitet tregtar në këto pasuri, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për tatimet.

Bazuar në argumentet e parashtruara, subjekti kërkon prej Kolegjit që të ardhurat e

¹³³ Hartuar pranë zyrës noteriale të B. Sh. D., në Ashdod Israel, nr. serie {***}.

bashkëshortit nga administrimi i pronave të familjes M. të mos llogariten si të ardhura nga puna si avokat (person fizik), dhe të korrigjohet analiza financiare duke mos u konsideruar si të ardhura në pronësi të bashkëshortit, por të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

35.2 Së pari, nga aktet e administruara në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit konstaton si vijon.

- i. Me prokurën e përgjithshme të datës 04.07.2001, bashkëpronarët e pronave të familjes M.¹³⁴ caktojnë dhe emërojnë si përfaqësues të tyre, avokatin A.G., të kryejë dhe/ose të firmosë të gjitha paditë, çështjet, marrëveshjet dhe/ose dokumente, për të gjitha pasuritë, të luajtshme e të paluajtshme, të tanishme dhe të ardhshme, duke listuar në 30 pika tagra të gjera përfaqësimi dhe duke marrë përsipër të konfirmojnë dhe pranojnë çdo akt ose çështje që përfaqësuesi, zëvendësi ose agjenti që do të caktohet prej tij, do të bëjë ose do të shkaktojë në sajë të prokurës.
- ii. Me prokurën e përgjithshme, datë 22.12.2010, R. D., trashëgimtare e vetme e një prej të përfaqësuarve në prokurën e përgjithshme të datës 4.07.2001, emëron përfaqësues të përgjithshëm av. A. G., për ta përfaqësuar në zgjidhjen në rrugë administrative dhe gjyqësore në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pasuritë e saj të paluajtshme, ku është pronare apo b/pronare, duke listuar tagra të gjera për avokatin edhe lidhur me administrimin e pronave të saj, lidhjen e kontratave të shkëmbimit/çdo akti tjetër të nevojshëm etj. [...] si dhe të marrë në dorëzim të ardhurat që do të vijnë nga lidhja e këtyre kontratave dhe t'i depozitojë ato në llogarinë time bankare.
- iii. Në vitet 2003, 2004, 2011, 2014, 2016, si përfaqësues i bashkëpronarëve M., bashkëshorti i subjektit ka lidhur disa kontrata qiraje për prona të kësaj familjeje.
- iv. Urdhërpagesa në Raiffeissen Bank dhe ProCredit Bank për likuidimet e qirave në llogari të z. A. G..

35.3 Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se prokura e përgjithshme e lëshuar në juridiksionin e një shteti të huaj, i është nënshtruar rregullave të posaçme të legalizimit, duke e kthyer dokumentin në të vlefshëm që të përdoret përpara organeve shtetërore apo gjyqësore në vendin tonë¹³⁵. Në prokurë nuk është parashikuar baza ligjore sipas së cilës të përfaqësuarit kanë kërkuar hartimin e saj, por në përputhje me parashikimet e nenit 70 të Kodit Civil: *Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuarit, me vullnetin e tij të lirë, ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit*, rezulton se të përfaqësuarit kanë legjitimuar përkundrejt të tretëve përfaqësuesin e zgjedhur prej tyre, bashkëshortin e subjektit, në cilësinë e avokatit me numër licence {***}. Ky cilësim prej përfaqësuesve, dëshmon zgjedhjen prej tyre jo të individit natyror, por të avokatit, si profesionist me pozitë më të fortë në këtë marrëdhënie përfaqësimi, për shkak të cilësive të tij për njohjen, parashikimin me saktësi më të lartë të detajeve të shërbimeve të kërkuara, si dhe për kryerjen e veprimeve juridike të nevojshme. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se pavarësisht ngjashmërisë që shfaq përfaqësimi si institut i së drejtës me porosinë, referuar në

¹³⁴ Të përfaqësuar M., A., P., Z. M. dhe E. G..

¹³⁵ Në rastet kur të përfaqësuarit lëshojnë një prokurë përpara një noteri në një shtet tjetër, veprojnë rregullat e Konventës së Hagës të 5 tetorit 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja", e quajtur ndryshe Konventa e Apostilit, shih: <https://punetejashme.gov.al/wwwp-content/uploads/2022/05/Lista-e-vendeve-me-Apostile-maj-2022.pdf>.

dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Civil, neneve 913 - 934, porosia rregullohet me kontratë ku përcaktohen detyrimet e të porositurit për të kryer një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër. Rregullimi i marrëdhënies juridiko-civile me akt përfaqësimi, përjashton detyrimin për përfaqësuesin [avokatin], për të dhënë llogari për veprimtarinë e realizuar, detyrim i një rëndësie të veçantë në kontratën e porosisë, në funksion të kontrollit nga porositësi për veprimtarinë e realizuar nga i porosituri, nëse ajo realizohet sipas kriterëve të administrimit të mirë dhe përkujdesjes, sipas parashikimeve nga neni 921 i Kodit Civil¹³⁶. Tagrat e përfaqësimit, të cituara edhe prej subjektit, ndër të tjera, për të dhënë me qira/shkëmbyer/shitur/hipotekuar etj. çdo pasuri të paluajtshme që ta gjykojë të arsyeshme; të përdorë paratë, t'i investojë si ta gjykojë të përshtatshme; të hyjë në transaksione në interes të bashkëpronarëve M. etj., dëshmojnë tejkalim të hapësirave të veprimit sipas një kontrate porosie¹³⁷. Në situatën faktike, ku bashkëpronarët M., me veprim juridik të njëanshëm, prokurën e përgjithshme, kanë përcaktuar llojin e marrëdhënies juridiko-civile mes tyre dhe bashkëshortit të subjektit, atë të përfaqësimit, pretendimi i subjektit se prokura e përfaqësimit, për nga përmbajtja e saj, duhet të trajtohet *si kontratë porosie e papërfunduar*, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit se prej Komisionit, qëllimisht është shmangur interpretimi ligjor i prokurës së përgjithshme dhe parashikimeve të neneve 920 dhe 999¹³⁸ të Kodit Civil, në kushtet kur për mbi dhjetë vite nuk rezulton që bashkëshorti, konform këtyre neneve, të kishte përcaktuar me akt juridik shpërblimin e tij, vlerësohen nga trupi gjykues i Kolegjit, të pabazuara.

35.4 Karakteri dhe vëllimi i tagrave të përfaqësimit për kryerjen e veprimeve të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të bashkëpronarëve M., për prona në zotërim prej tyre, dhe për të tjera që do të mund të krijohen, duket të synojnë që nëpërmjet vlerësimit prej avokatit të nevojave për ato shërbime që sipas ligjit apo situatës konkrete, janë të nevojshme për t'u ndërmarrë në mënyrë që interesat e të përfaqësuarve të marrin një mbrojtje sa më të përshtatshme. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, është kontradiktore në qëndrimet e saj, ndërsa në ankim shprehet se bashkëshorti ka kryer administrim të pronave të familjes Matathia, ndërsa gjatë hetimit administrativ deklaroi se shpërblimi i punës së bashkëshortit do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar, ku do të ndahet shërbimi i avokatisë nga administrimi. Për më tepër, nga aktet në fashikuj konstatohet se për periudhën 2000-2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si avokat, ka hartuar dhe lidhur 32 kontrata qiraje si përfaqësues i bashkëpronarëve M., për dhënie me qira të dy pronave të tyre dhe, sipas deklaramit të subjektit, është angazhuar në trajtimin e pronave, për efekt kompensimi¹³⁹, veprimtari që qartazi dëshmojnë angazhimin e tij si avokat. Në këtë marrëdhënie përfaqësimi, avokati, bashkëshorti i subjektit në këtë rast, si profesionist ka për qëllim "fitimin" që synon të krijojë për shkak të shërbimeve që ofron, dhe nisur

¹³⁶ Kodi Civil, në nenin 921, parashikon: "I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj. I porosituri detyrohet gjithashtu që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është autorizuar t'ia kalojë një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit".

¹³⁷ Kodi Civil, në nenin 916, parashikon: "I porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositësit".

¹³⁸ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 920, parashikon: "Porosia prezumohet se është me shpërblim. Masa e shpërblimit, kur nuk caktohet nga palët, përcaktohet në bazë të tarifave profesionale ose zakonisht dhe në mungesë të tyre, nga gjykatat", dhe në nenin 999: "Në qoftë se depozita ka për objekt një sasi të hollash ose sendesh të tjera të barsndërrueshme, dhe depozitari ka të drejtën t'i përdorë, ky fiton pronësinë dhe detyrohet të kthejë po të njëjtën sasi nga i njëjti lloj dhe me të njëjtën cilësi. Në raste të tilla zbatohen dispozitat lidhur me huanë, kur nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë depozitën".

¹³⁹ Shih përgjigjen e pyetjes 7 në pyetësorin standard.

nga kjo premisë, edhe në kontekst të miqësisë, deklarimi se *shpërblimi i punës dhe përqindjes së bashkëshortit për administrimin e pronave të familjes M., do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar*, duket sa i pabesueshëm aq i pakuptimtë, për shkak të kohëzgjatjes së marrëdhënies 2001-2016, angazhimit dhe volumit të punëve të kryera për prona me vendndodhje në qytet tjetër. Në çdo këndvështrim të kësaj marrëdhënieje, përfaqësimi apo porosie, pretendimi se bashkëshorti nuk ka përfituar shpërblimin, ndërkohë që provohet se llogaritë bankare në emër të tij mbajnë të ardhura të familjes M. dhe të ardhura nga ushtrimi i avokatisë, mbetet i paprovuar, i dyshimtë dhe deklarativ.

35.5 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se një pjesë e të ardhurave nga administrimi i pronave të familjes M., gjendet në llogaritë bankare të bashkëshortit edhe për arsye të mosmarrëveshjeve midis bashkëpronarëve për vlera të papaguara përpara administrimit të pronave prej bashkëshortit, për pronësinë e katit të tretë të godinës me destinacion shkollë, në proces legalizimi, dhe se kjo provohet me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me nr. {***} regjistri, datë 14.02.2005. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se bashkëpronarët M., të përfaqësuar me prokurën e përgjithshme të datës 04.07.2001, nga av. A. G., janë thirrur në cilësinë e të paditurve, nga një trashëgimtare e kësaj familjeje, e cila nuk përfaqësohet prej tij. Padia ka pasur objekt kthimin e shumës 30.000 USD dhe interesat, shumë që paditësja e ka pretenduar të paguar prej saj për qiramarrësit, për punime rikonstruksioni dhe shtesë kati në pronën në bashkëpronësi me të paditurit, e autorizuar prej tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 14.02.2005, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditëses pa ndonjë arsye për shtyrjen e gjykimit. Pas këtij momenti, nuk ka asnjë gjurmë lidhur me këtë mosmarrëveshje e, për rrjedhojë nuk përjashtohet zgjidhja e saj. Edhe duke analizuar *a contrario* që mosmarrëveshja nuk është zgjidhur, kjo nuk do të përbënte arsye që bashkëpronarët M., ata të përfaqësuar prej bashkëshortit të subjektit, dhe pas më shumë se dhjetë vjetësh, të mbajnë në ruajtje një shumë, për të cilën dëshmohet se nuk kanë pasur vullnet për ta shlyer në vitin 2005, dhe nuk ka asnjë akt ligjor që i detyron për shlyerjen e saj. Gjithashtu, pas mbylljes së seancës dëgjimore, pretendimi i subjektit se këto prova nuk janë analizuar prej Komisionit me qëllim të vetëm penalizimit të saj, dhe se në llogaritë e bashkëshortit një pjesë e të ardhurave nga qiratë janë për arsye të mosmarrëveshjeve mes bashkëpronarëve M., vlerësohen nga trupi gjykues i Kolegjit, të pabazuara.

35.6 Përpos sa më sipër, konstatohet se në prokurën e përgjithshme të vitit 2001, av. A. G. i jepet tagër të hapë ose mbyllë llogari të të përfaqësuarve me çdo bankë dhe të tërheqë, firmosë dhe qarkullojë çdo çek [...], e po ashtu R. D., trashëgimtare ligjore e vetme e E. D., një prej të përfaqësuarve me prokurën e vitit 2001 – me prokurën e përgjithshme të vitit 2010, i jep tagra av. A. G. për të marrë të ardhura në emër të saj dhe t'i depozitojë ato në llogarinë e saj bankare. Bashkëshorti i subjektit nuk ka zgjedhur të çelë llogari bankare në emër të të përfaqësuarve, dhe qiratë e pronave janë derdhur në llogaritë e tij bankare në Raiffeisen Bank dhe ProCredit Bank¹⁴⁰, ose janë marrë prej tij dorazi, duke pranuar të krijojë një tymnajë lidhur me këto të ardhura. Ndërkohë, për likuiditetet e shtuara në llogaritë bankare të bashkëshortit, ku identifikohen se janë derdhur/akumuluar edhe shuma nga qiratë e pronave të familjes M., në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të viteve 2006 dhe 2007, nuk deklarohet burimi i krijimit. Në deklaratat e pasurisë të viteve 2008, 2009, 2010, 2011, lidhur me depozitat/llogaritë bankare në Raiffeisen Bank, subjekti deklaroi: *shtuar nga të ardhurat e bashkëshortit si avokat*. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2012,

¹⁴⁰ Llogaritë bankare në Raiffeisen Bank janë hapur në vitin 2006, dhe në ProCredit Bank janë hapur në vitin 2012.

subjekti deklaroi depozitën bankare në emër të bashkëshortit në ProCredit Bank, me burim krijimi: *të ardhura nga profesioni i bashkëshortit si avokat me nr license {***}*. Në deklaratat e pasurisë të viteve 2013, 2014 dhe 2015, shtimi i likuiditeteve në llogaritë bankare të bashkëshortit deklarohet nga subjekti dhe vetë bashkëshorti, me burim krijimi: *të ardhura nga profesioni i bashkëshortit si avokat me nr. licence {***}*. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2016, dorëzuar në ILDKPKI më 30 mars 2017, bashkëshorti i subjektit i deklaroi depozitat në Raiffeisen Bank, me burim krijimi: *vlera e punës sime si avokat*, si dhe pakësim të llogarisë bankare në ProCredit Bank, për të cilën deklaroi: *është llogari për administrimin e të ardhurave të pronave të familjes M..* Ndërkohë që në asnjë prej deklaratave të pasurisë të periudhës 2003-2016, nuk deklarohen detyrime ndaj bashkëpronarëve M.. Në deklaratën *vetting*, depozita në Raiffeisen Bank, ku identifikohen depozitime të qirave të këtyre pronave, deklarohet me burim *nga të ardhurat e mia vjetore nga puna si avokat*, ndërsa depozita në ProCredit Bank deklarohet me burim *të ardhura nga aktiviteti si avokat dhe administrimi i pronave të familjes M..* Mos deklarimin në deklaratën *vetting* të vlerës së të ardhurave nga administrimi i pronave të familjes M., si dhe të vlerave respektive të tyre në llogaritë bankare, ku janë bashkuar me depozitimet e tjera, trupi gjykues i vlerëson në kundërshtim me parashikimet e kuadrit kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit, i cili ka objekt deklarimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, dhe kontrollin e ligjshmërisë së tyre. Kjo mënyrë deklarimi, duket zgjedhje e qëllimshme e personit të lidhur për të krijuar konfuzion e pamundësuar për llogaritjen e saktë të pasurive të tij, dhe pretendimi i subjektit për të mos i konsideruar si të ardhura të bashkëshortit, por si të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, përpos i pabesueshëm, është i pabazuar.

35.7 Pretendimi i subjektit se *të ardhurat [qiratë] nga administrimi i pronave të familjes M. nga viti 2001 e në vazhdim, janë të deklaruara pasi ndodhen në llogari bankare*, në vetvete përbën ilustrim domethënës të mënyrës jotransparente të zgjedhur nga subjekti për deklarimin e pasurisë dhe detyrimeve, në kushtet kur institucionet e rivlerësimit do të duhej që përmes kontrollit të lëvizjeve të disa llogarive bankare, për një periudhë mbi 10-vjeçare, të identifikojnë shumat, ndërkohë që ka pasur edhe dorëzime dorazi të tyre¹⁴¹. Përpos sa më sipër, ky pretendim bëhet më i pakuptimtë, për sa subjekti nuk ka deklaruar asnjë detyrim ndaj familjes M., përkundrajt detyrimeve të qarta që rezultojnë nga ligji nr. 9049/2003 e ligji nr. 84/2016 dhe formularët në zbatim të tyre. Shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore *për paqartësi lidhur me deklarimin e këtyre të ardhurave*, janë jobindëse. Për rrjedhojë, nën dritën e sa është shtjelluar më sipër, shpjegimet e subjektit se shumat në llogaritë e tij bankare janë të drejta reale të familjes M., janë inkoherente dhe të pabazuara.

35.8 Kjo mënyrë deklarimi vjen në kundërshtim të hapur me kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili parashikon se: *subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur*. Mosdeklarimi i saktë i të ardhurave të bashkëshortit¹⁴², është shkak kushtetues që parashikohet në pikën 2 të nenit D të

¹⁴¹ Në seancë dëgjimore, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se pagesat përmes bankës kanë filluar vonë, nga 2006 - 2007 (shih faqen 54 të procesverbalit të seancës dëgjimore).

¹⁴² Udhëzimi i ILDKPKI-së, nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, në pikën 14 parashikon: "Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve etj., në posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këto marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (pronarit).

Aneksit, dhe në këtë rast interpretohet i lidhur me parashikimin e pikës 5 të nenit D, për sa mënyra e deklarimit dëshmon përpjekje të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur *për të fshehur ose për të paraqitur në mënyrë të pasaktë* pasuritë, llogaritë bankare në emër të bashkëshortit, si dhe për të pamundësuar kontrollin e të ardhurave të ligjshme gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

35.9 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se detyrimet tatimore të qirave janë mbajtur në burim, e se edhe në rast të një marrëveshjeje hipotetike për shpërndarje të fitimit, 20% e të ardhurave nga qiratë të përfitoheshin nga bashkëshorti e 80% t'i mbeteshin familjes M., tatimi në burim do të paguhej i veçuar nga secila palë, dhe shuma e dy pagesave do të ishte aq sa është paguar faktikisht. Ky pretendim vlerësohet i pabazuar, bashkëshorti i subjektit, pajisur me leje të ushtrimit të profesionit të avokatit nga viti 1999, dhe i prokuruar në cilësinë e avokatit nga familja M., kishte detyrimin që të qartësonte përfitimet e tij nga kjo marrëdhënie dhe të shlyente detyrimet tatimore. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se me deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit nga trashëgimtarë të familjes M., është konfirmuar marrëdhënia e bashkëshortit për administrim të pronave të kësaj familjeje, dhe kanë të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁴³, vlerësohet i pabazuar. Pavarësisht veprimtarisë së bashkëshortit, si avokat apo për administrim të pronave, shumat në llogaritë e tij bankare nuk përkojnë me marrëdhëniet që dispozita e cituar parashikon.

35.10 Në përmbyllje, për të ardhurat nga administrimi i pronave të familjes “M.”, sipas prokurës së përgjithshme të datës 4.7.2001, të deklaruar pa vlerë në deklaratën *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor përkatësinë dhe ndarjen e tyre, ndërsa kishte barrën e provës për të provuar këto fakte dhe, si të tilla, ato vlerësohen pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, kanë bërë deklaram të pasaktë me qëllim fshehjen e vlerave reale të përfituara për shërbime dhe administrim të pronave të kësaj familjeje, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

C. Shkaqe ankimi lidhur me metodologjinë e përdorur nga Komisioni për analizën financiare dhe problematikat

- 36** Komisioni ka konkluduar se për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej (-) 35.563.982 lekësh¹⁴⁴, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka kryer analizën financiare të ndarë në dy periudha, dhjetor 1993-2002, dhe si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, që i korrespondon periudhës 2003-2016.

¹⁴³ Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 4, parashikon: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

¹⁴⁴ Në analizën financiare të Komisionit, balanca (-) 35.563.982 lekë, ka rezultuar si total i viteve me banaca negative: viti 2003 prej (-)2.138.132 lekësh; viti 2004 prej (-)1.378.270 lekësh; viti 2005 prej (-)944.419 lekësh; viti 2008 prej (-)4.849.621 lekësh; viti 2009 prej (-)8.225.091 lekësh; viti 2010 prej (-)1.748.630 lekësh; viti 2011 prej (-)2.806.500 lekësh; viti 2012 prej (-)1.986.085 lekësh; viti 2013 prej (-)3.558.399 lekësh; viti 2014 prej (-)7.928.834 lekësh.

36.1 Subjekti pretendon se metodologjia e përdorur nga Komisioni për hartimin e analizës financiare dhe të përlllogaritjes së të ardhurave financiare, është alogjike, e pabazuar në ligj dhe në prova dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit dhe mendimin e kualifikuar të institucioneve kompetente. Në vijim, shkaqet e ankimit dhe analiza e trupit gjykues për to.

36.2. *Së pari*, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shërbimet pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, Xh. Sh., {***}-së janë analizuar më sipër në këtë vendim, prandaj për të shmangur përsëritjen në vijim, konkluzionet e arritura për to, gjejnë zbatim në analizën financiare të vitit/viteve respektive.

36.3. *Së dyti*, trupi gjykues vëren se disa pretendime të subjektit janë të së njëjtës natyrë për disa vite të analizës financiare, ose për të njëjtin shkak ankimi pretendohet ndryshimi i rezultatit të analizës financiare të disa viteve. Për lehtësi leximi, këto pretendime trajtohen të grupuara dhe konkluzionet e arritura për to, gjejnë zbatim në analizën financiare të viteve respektive.

Lidhur me shpenzimet e jetesës

37 Lidhur me pretendimet e subjektit për llogaritje të shpenzimeve të jetesës me 30% për vitet 1997-2002, sipas qëndrimit orientues të Kolegjit, trupi gjykues konstaton se në analizën financiare të periudhës 1993-2000, Komisioni ka konsideruar shpenzimet e jetesës me 30% të të ardhurave deri në vitin 1996, dhe me 66% të të ardhurave për vitet 1997-1999.

37.1 Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se në vendimin e referuar prej subjektit, Kolegji ka mbajtur qëndrim orientues¹⁴⁵ se shpenzimet e jetesës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të llogariten me 30% të të ardhurave, që përafrojnë me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që u përkasin pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave, dhe ka theksuar se *organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë për afërsisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim.* Në kushtet kur për vitin 1997, subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, realizonte të ardhura nga puna si gjyqtare, të cilat ishin mbi vlerën 800 USD, dhe sipas deklarimeve, subjekti dhe bashkëshorti në vitet 1997-1999, me periudha, kanë jetuar me familjet e origjinës ose në banesa pranë tyre, konsideruar mundësitë financiare të familjeve, nuk përjashtohet ndihma që potencialisht mund t’i jetë dhënë familjes së re të subjektit. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, dhe për sa më sipër, si qëndrim garantist, për vitet 1997-1999, për familjen e subjektit shpenzimet e jetesës u llogaritën me 30% të të ardhurave.

37.2 Lidhur me pretendimin që për vitet 2000, 2001, 2002, nuk ka referencë të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, prandaj shpenzimet e jetesës të llogariten me 30% të të ardhurave, konstatohet se subjekti e ka ngritur edhe në Komision me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, dhe prej Komisionit është vlerësuar si standard i pazbatueshëm sepse për periudhën 2000-2002, zbatohen shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së. Qëndrimi i Komisionit vlerësohet i drejtë, për

¹⁴⁵ Shih vendimin e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), paragrafët 21.39 - 21.42.

sa referuar informacionit të përcjellë në Kolegj nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019, rezulton se të dhënat që përdoren për përlogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2000-2016, burojnë pikërisht nga publikimet zyrtare të INSTAT-it, dhe në analizën financiare të Komisionit për këto vite, llogaritja e shpenzimeve të jetesës referon pikërisht këto të dhëna. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar.

37.3 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se janë rritur padrejtësisht vlerat për shpenzimet e jetesës për vitet 2004-2016, duke mos iu referuar INSTAT-it, si institucion i caktuar me ligj, por të dhënave të ILDKPKI-së, ku vlerat janë më të larta për një familje me katër, pesë, apo tre persona. Trupi gjykues sjell në vëmendje se si praktikë e konsoliduar, për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2000-2016, të dhënat e referuara nga ILDKPKI-ja e që përdoren nga organet e rivlerësimit, burojnë pikërisht nga publikimet zyrtare të INSTAT-it. Në vendim, Komisioni është shprehur qartë se përlogaritja e shpenzimeve të jetesës është bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i). Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

Lidhur me konvertimin e likuiditeteve gjendje në llogaritë bankare të bashkëshortit

- 38** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se *konstatimi i Komisionit, se vlera e gjendjes së llogarive dhe depozitat në emër të z. A. G. në fund të vitit 2016, është 41.326.002 lekë, ndërsa të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1997-2016, janë 17.262.799 lekë, është rezultat i një metodologjie të gabuar dhe alogjike, pasi bën konvertimin e monedhave të ndryshme në të njëjtën periudhë kohore (dhjetor 2016), ndërkohë që ato janë depozituar në bankë në kohë të ndryshme.*

38.1 Në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit¹⁴⁶, për të mos pasur efekt të ndryshimeve të kursit në momentin e konvertimit të likuiditeteve në monedhë të huaj në lekë, likuiditetet janë konvertuar nga monedhat e tyre origjinale USD/euro në lekë, me kursin e vitit të krijimit të tyre, dhe për vitet në vijim që ato kanë vazhduar të jenë gjendje, është mbartur balanca e likuiditeteve [euro/USD], konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të vitit të krijimit të tyre, duke shtuar ndryshimet e ndodhura në vitin në analizë. Po ashtu, dhe për vitet në vijim, është konsideruar e mbartur balanca e likuiditeteve në euro/ USD, e konvertuar në lekë, sipas kursit të këmbimit të vitit të mëparshëm, duke shtuar ndryshimet e ndodhura në vitin në analizë [gjendja e tyre në monedhën origjinale – euro/ USD – nga viti në analizë, duke zbritur gjendjen me vitin e mëparshëm], e cila është konvertuar me kursin e vitit në analizë. Në ndryshim nga praktika në Kolegj [që është kursi i ditës së fundit të vitit], për konvertimet e gjendjes së likuiditeteve, është konsideruar kursi mesatar i dhjetorit të viteve përkatëse, pasi ky është kursi i përdorur nga Komisioni.

38.2 Me konsiderimin e konvertimit të likuiditeteve sipas mënyrës sa më sipër, pasi pjesa më e madhe depozitave/likuiditeteve janë në monedhën euro ose USD, në analizën e viteve që nga 2002 deri në 2016, ka ndikuar me një vlerë totale prej 6.443.725 lekësh¹⁴⁷. Në analizën e viteve 2003-2016, efekti i ndikimit në analizë nga konvertimi i likuiditeteve në lekë me kursin e vitit e duke ndryshuar konvertimin si shpjeguar më sipër, ka efekt për vlerën 6.335.893 lekë në total, si

¹⁴⁶ Shih vendimin e Kolegjit nr. 19/2022, paragrafi 29.6 e vijim.

¹⁴⁷ Në vitin 2002, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 1.527.219 lekësh, e ndërsa në analizën në Kolegj, shtesë likuiditetesh prej 1.419.387 lekësh, pra pakësuar me vlerën 107.832 lekë, konsideruar ndryshimin e kursit të këmbimit euro me lekë nga 2001 në 2002, që është rritur me 15,89. Ndërsa për vitet 2003 – 2016, me një efekt prej 6.335.893 lekësh.

kombinim: (i) për vitet në analizë 2003-2005 e 2013, ku ka pasur shtim likuiditetesh, por rënie të kursit të këmbimit nga viti në vit, ka ndikuar me shtim likuiditetesh në Kolegj, por më shumë se Komisioni, prej (-) 679.318 lekësh¹⁴⁸; (ii) për vitet në analizë 2008-2012 e 2014, ku ka pasur shtim likuiditetesh, por si kombinim i rritje/rënies së kursit të këmbimeve nga viti në vit i monedhave euro dhe USD, ka ndikuar me shtim likuiditetesh në Kolegj, por më pak se Komisioni, prej (+) 5.265.055 lekësh¹⁴⁹; (iii) për vitet në analizë 2006-2007 e 2016, ku ka pasur pakësim likuiditetesh, por si kombinim i rritje/rënies së kursit të këmbimeve nga viti në vit, i monedhave euro dhe USD ka ndikuar me pakësim likuiditetesh në Kolegj, por në një kombinim më pak se Komisioni prej (-) 1.044.721 lekësh¹⁵⁰; (iv) për vitin në analizë 2015, ku ka pasur shtim likuiditetesh në Komision prej 416.615 lekësh, por sipas llogaritjes rezulton pakësim i likuiditeteve prej (-) 2.378.262 lekësh, si kombinim i rritjes së kursit të këmbimeve nga viti në vit i USD (+13) e rënie e depozitave në USD prej 15.593 USD e ulje e kursit në euro, por ndryshimi shumë i vogël i depozitave në euro nga viti në vit e ka ndikuar, pra me diferencë (+) 2.794.877 lekë.

Në përmbyllje, nga rillogaritja e balancave të likuiditeteve në ekuivalentin në lekë, efekti në vitet që rezultojnë me balanca negative në analizën financiare të Komisionit, është si vijon.

- i. Për vitet 2003-2005 e 2013, duke shtuar pasurinë “ndryshimi i likuiditeteve në bankë”, pra subjekti duhet të justifikojë më shumë me të ardhurat e ligjshme ose ndryshe duke rritur rezultatin e vitit¹⁵¹.
- ii. Për vitet 2008-2012 e 2014, duke pakësuar pasurinë “ndryshimi i likuiditeteve në bankë”, pra subjekti duhet të justifikojë më pak me të ardhurat e ligjshme ose ndryshe duke pakësuar

¹⁴⁸ Si total i: në vitin 2003, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 2.369.204 lekësh, në Kolegj shtesë prej 2.394.779 lekësh, pra diferencë - 25.575 lekë; në vitin 2004, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 1.530.514 lekësh, në Kolegj shtesë prej 1.579.716 lekësh, pra diferencë - 49.202 lekë; në vitin 2005, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 1.208.182 lekësh, në Kolegj shtesë prej 1.246.947 lekësh, pra diferencë - 38.765 lekë; në vitin 2013, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 2.683.040 lekësh, në Kolegj shtesë prej 3.248.817 lekësh, pra diferencë - 565.776 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit në euro dhe depozitave dhe rënie e kursit të këmbimit USD, por rritje e depozitave në USD.

¹⁴⁹ Si total i: në vitin 2008, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 6.095.423 lekësh, në Kolegj shtesë prej 5.630.336 lekësh, pra diferencë 465.087 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit si në euro dhe USD dhe depozitave; në vitin 2009, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 8.489.151 lekësh, në Kolegj shtesë prej 7.557.993 lekësh, pra diferencë 931.158 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit si në euro dhe USD dhe depozitave; në vitin 2010, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 3.058.840 lekësh, në Kolegj shtesë prej 1.498.556 lekësh, pra diferencë 1.560.284 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit në euro dhe USD dhe rritje e depozitave në euro dhe pakësim i tyre në USD; në vitin 2011, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 4.241.732 lekësh, në Kolegj shtesë prej 4.203.223 lekësh, pra diferencë 38.509 lekë nga efekti i rritjes së depozitave në euro dhe USD dhe ulje e kursit të këmbimit në euro e rritje e kursit në USD; në vitin 2012, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 3.042.469 lekësh, në Kolegj shtesë prej 2.698.508 lekësh, pra diferencë 343.961 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit në euro dhe USD dhe rritje e depozitave; në vitin 2014, Komisioni ka konsideruar shtesë likuiditetesh prej 7.965.691 lekësh, në Kolegj shtesë prej 6.030.634 lekësh, pra diferencë 1.926.057 lekë nga efekti i rritjes së depozitave në euro dhe USD dhe ulje e kursit të këmbimit në euro e rritje e kursit në USD.

¹⁵⁰ Si total i: në vitin 2006, Komisioni ka konsideruar pakësim likuiditetesh prej - 896.997 lekësh, në Kolegj pakësim prej - 913.676 lekësh, pra diferencë +16.679 lekë nga efekti i rritjes së kursit të këmbimit në euro dhe depozitave në euro dhe rritje e depozitave në USD, por ulje e kursit të USD; në vitin 2007, Komisioni ka konsideruar pakësim likuiditetesh prej - 2.208.935 lekësh, në Kolegj pakësim prej - 1.611.258 lekë, pra diferencë -597.677 lekë nga efekti i pakësimit të kursit të këmbimit në euro dhe depozitave në euro dhe rritje e depozitave në USD, por ulje e kursit të USD; në vitin 2016, Komisioni ka konsideruar pakësim likuiditetesh prej - 1.739.337 lekësh, në Kolegj pakësim prej - 1.275.614 lekësh, pra diferencë -463.723 lekë nga efekti i pakësimit të kursit të këmbimit në euro dhe depozitave në euro dhe i pakësimit të depozitave në USD, por rritje e kursit të USD.

¹⁵¹ Për vitin 2003, duke e rritur diferencën negative me 25.575 lekë; për vitin 2004, duke e rritur diferencën negative me 49.202 lekë; për vitin 2005, duke e rritur diferencën negative me 38.765 lekë; për vitin 2013, duke e rritur diferencën negative me 565.776 lekë.

rezultatit e vitit¹⁵², pra në total të viteve me balanca negative, me efekt pakësimi në total të balancave negative prej 4.585.737 lekësh¹⁵³.

Lidhur me shpenzimet për arsimimin e vajzave, periudha 2002-2008, dhe shpenzimet e jetesës për to për periudhën 2002-2014

- 39** Subjekti i rivlerësimit pretendoi të mos përfshihen shpenzimet për arsimimin e vajzave, binjake, në institucionin arsimor “{***}” për vitet 2002-2008, për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe për sa vijon.
- i. Mënyra e llogaritjes së shpenzimeve në vendim, e ndryshme nga ajo e përdorur në rezultatet e hetimit administrativ, nuk i është komunikuar subjektit, duke i cenuar parimin e mbrojtjes. Të dyja mënyrat nuk kanë logjikë ekonomike dhe ligjore pasi nuk është paraqitur asnjë argumentim në këto drejtime.
 - ii. Për vitet 2002-2008, përllogaritja me koston e arsimimit të vitit 2009, me normë zbritëse 10% për çdo dy vite – në referim të trendit rritës së kostove, për vitet për të cilat nuk ka informacion – pa përfshirë kosto transporti, nuk qëndron. Sipas subjektit, përpos se nuk referohet një metodologji ku është bazuar kjo përllogaritje, ku të ardhurat e një familjeje në vitin 2000 dhe në vitin 2009 nuk janë të njëjta, nuk është e njëjta kosto e arsimimit për klasën e parë me klasën e tetë, niveli i pagave të mësuesve për këtë periudhë është rritur më tepër se 2-fish.
 - iii. Sipas praktikave të institucionit, janë përfituar ulje: për provimin e pranimit; për shkak se ishin dy fëmijë; për kryerje të menjëhershme të pagesës për arsimim; (iv) për njërën nga vajzat bursë të plotë për tri vite dhe reduktim të çmimit për vitet e tjera, për shkak të rezultateve të larta, provuar në mënyrë indirekte me provat: dëftesat e secilit vit, fletë nderi dhe certifikata honorifike.

39.1 Konstatohet se edhe në Komsion, subjekti ka ngritur pretendime për mospërfshirje të kostove të arsimimit të vajzave për vitet 2002-2008. Komisioni shprehet: (i) në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, *për shkak se nuk vërtetohen nga vetë institucioni, këto vite arsimimi nuk mund të konsiderohen me kosto zero lekë. Prandaj kostoja e arsimimit të dy vajzave në vitet 2002 – 2008, është vlerësuar sa kostoja e studimeve të tyre në vitin 2009, si vit të parë të vërtetuar nga vetë institucioni {***};* (ii) në vendim: *në mungesë të një dokumentacioni provues për kostot reale të arsimimit të vajzave të subjektit pranë institucionit arsimor “{***}” për periudhën 2002-2008, Komisioni zbatoi një zbritje progresive nga kostoja e vitit 2009 në masën 10% çdo dy vite, duke iu referuar trendit rritës që ka pasur kostoja e arsimimit nga viti 2009 në vitin 2013. Në vështrim të krahasuar, rezulton se Komisioni ka mbajtur një qëndrim garantist ndaj subjektit.*

39.2 Nga aktet në fashikuj, rezulton se institucioni arsimor “{***}”, në përgjigje të kërkesës së subjektit, vërteton pagesat e kryera për dy vajzat e saj për vitet shkollorë të periudhës 2009-2014,

¹⁵² Për vitin 2008, duke e ulur diferencën negative me 465.087 lekë; për vitin 2009, duke e ulur diferencën negative me 931.158 lekë; për vitin 2010, duke e ulur diferencën negative me 1.560.284 lekë; për vitin 2011, duke e ulur diferencën negative me 38.509 lekë; për vitin 2012, duke e ulur diferencën negative me 343.961 lekë; për vitin 2014, duke e ulur diferencën negative me 1.926.057 lekë.

¹⁵³ Nga totali i viteve me balanca negative prej 35.563.982 lekësh (vitet 2003-2005, 2008-2014), kombinimi i efekteve do të rezultonte me total balancë negative më pak, prej 4.583.737 lekësh.

me sqarimin: *institucioni nuk disponon të dhëna në lidhje me vitet e mëparshme*. Konstatohet se në ankim, subjekti e “zgjeron” këtë përgjigje se arsyeja e pamundësisë së përcaktimit të shpenzimeve është se ka kaluar afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit, i parashikuar sipas ligjit “Për arkivat”. Rezulton se në nisje të hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nuk mund të paraqesë shpenzimet për shkollim të vajzave për vitet 2002-2008, pasi shkolla nuk disponon të dhëna¹⁵⁴. Në vijim, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka kundërshtuar përllogaritjen e kryer nga Komisioni, pa pretenduar asnjë vlerë apo referencë për llogaritjen e tyre, pa paraqitur asnjë dokument nga shkolla në mbështetje të pretendimeve të saj për praktikën e zbatuar, si tarifa të reduktuara për dy fëmijë të së njëjtës familje, apo për aplikimin e bursave. Në këto rrethana faktike, zbritja progresive e kostove të arsimimit, me 10% sipas trendit rritës nga të dhënat e viteve 2009-2014, ka synuar të reflektojë shpjegimet e subjektit.

39.3 Trupi gjykues vlerëson se pretendimi për të mos llogaritur shpenzimet e arsimimit të vajzave për vitet 2002-2008, në kushtet kur këto shpenzime janë kryer, është i pabazuar. Fakti që institucioni arsimor nuk ka të dhëna për pagesat e kryera, nuk mund të konsiderohet si shkak për të pretenduar aplikim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Përpos sa më sipër, pretendimi se përsa shpenzimet nuk janë deklaruar në deklaratat e pasurisë, llogaritja e tyre do të rëndonte subjektin, edhe nga ana ligjore vlerësohet i pabazuar. Detyrimi për deklarim të shpenzimeve për arsim u parashikua me ndryshimet e ligjit nr. 9049/2003, në vitin 2012,¹⁵⁵ për rrjedhojë në deklaratat e pasurisë të viteve në analizë subjekti nuk kishte detyrim për deklarim të shpenzimeve për arsim.

39.4 Nga kontrolli i analizës financiare në vendimin e Komisionit, konstatohet se për vitet 2002 deri në 2008, vlerat e shpenzimeve të arsimit janë ulur krahasuar me vlerat e pasqyruara në analizën financiare në raportin e rezultateve hetimore. Për një qëndrim garantist ndaj subjektit, në Kolegj, në mënyrë alternative, u konsideruan shpenzimet e arsimit të vitit 2009, të vërtetuara, prej 2.668 eurosh për secilën vajzë, duke aplikuar zbritje, inflacionin e përllogaritur sipas CPI-së (Indeksi i Çmimeve të Konsumit), indeks i publikuar nga INSTAT-i¹⁵⁶, si dhe duke ruajtur zbritjen progresive të aplikuar nga Komisioni prej 10%, duke iu referuar trendit rritës që ka pasur kostoja e arsimimit nga viti 2009 në vitin 2013. Në këtë përllogaritje që reflektoi pretendimin e subjektit për konsiderim të inflacionit në këto vite, rezultoi se në vitet 2003 - 2008, shpenzimet e arsimimit për dy vajzat, do të jenë 332.347 lekë¹⁵⁷ më pak se vlera në analizën financiare të Komisionit. Pavarësisht ndryshimit, vitet 2003-2005 dhe 2008 rezultojnë me balanca negative, ndonëse në vlera më të ulura.

¹⁵⁴ Përgjigjet e subjektit janë administruar në Komision me nr. {***}, datë 21.02.2020.

¹⁵⁵ Ligji ndryshues 85/2012, në nenin 1, parashikon: “Në nenin 2, pas pikës 6, shtohen pikat 7, 8 e 9 me këtë përmbajtje: “7. “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, aredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues”.

¹⁵⁶ Shih: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_PR_PRCPI/CPI006/?rxid=eae798d2-a24d-44f0-9c9c-3909a5be39bd - Indeksi i Çmimeve të Konsumit (Inflacioni).

¹⁵⁷ Për të dyja vajzat, shpenzimet e arsimimit do të ndryshojnë në vitin 2008, nga 5.336 euro në 4.695 euro ose 578.311 lekë (prej 13.261 lekësh më pak); në vitin 2007, nga 5.336 euro në 4.537 euro ose 548.578 lekë (prej 32.080 lekësh më pak); në vitin 2006, nga 4.322 euro në 3.914 euro ose 484.214 lekë (prej 50.406 lekësh më pak); në vitin 2005, nga 4.322 euro në 3.822 euro ose 468.309 lekë (prej 61.284 lekësh më pak); në vitin 2004, nga 3.890 euro në 3.265 euro ose 413.785 lekë (prej 79.208 lekësh më pak); në vitin 2003 nga 3.890 euro në 3.171 euro ose 423.764 lekë (prej 96.108 lekësh më pak), total prej 2.625 eurosh më pak ose prej 332.347 lekësh më pak, sipas kurseve të viteve përkatëse.

39.5 Lidhur me pretendimet se për vitet 2002-2014, shpenzimet e jetesës janë llogaritur dy herë për vajzat e subjektit, pasi në paketën e arsimit përfshiheshin shpenzimet për vaktet e ngrënies, mëngjesi dhe dreka, trupi gjykues vlerëson si vijon. Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, konstatohet se institucioni arsimor “{***}”¹⁵⁸ vërteton pagesat e kryera në total për vitet 2009-2014, duke ndarë në zëra “pagesë shkollimi” dhe “pagesë transporti”, ku nuk përfshihet pagesë për ushqim/vakte. Për vitet 2002-2008, pavarësisht mungesës së informacionit për pagesat e kryera, subjekti nuk ka provuar me dokument nga institucioni arsimor “{***}” që për ciklin tetëvjeçar, paketa arsimore ka përfshirë vakte ngrënieje. Përpos sa më sipër, *së pari*, shpenzimet e jetesës së familjes sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, janë mesatare dhe përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste në favor të subjekteve të rivlerësimit, të cilët kanë një standard më të lartë jetese; *së dyti*, nga shpenzimet e jetesës së familjes nuk mund të pretendohen zbritja e dy vakteve ushqim të fëmijëve, pasi shpenzimet për ushqim për familjen, përfshirë edhe vajzat, kryhen gjithsesi (për darkat, ditët e pushimit javor, pushimet vjetore, të semestrit dhe të verës). Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit mbetet i paargumentuar dhe i paprovuar.

C/2 Lidhur me analizën financiare të viteve 1999-2002

40 *Lidhur me depozitat bankare në vitet 1997 - 1998, në emër të bashkëshortit*, Komisioni ka konkluduar se:

i. Subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitave në vitet 1997 dhe 1998. Të ardhurat e ligjshme të dokumentuara, pagat e subjektit si gjyqtare (dhjetor 1993-1998) dhe pagat e bashkëshortit si nd/gjyqtar dhe gjyqtar (1993-1996), edhe pas ndryshime në analizë sipas të ardhurave të vërtetuara me provat në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ishin të pamjaftueshme për krijimin e depozitave në vlerë totale 1.900.000 lekë deri në fund të vitit 1998.

ii. Për depozitat e krijuara tek ish-Banka e Kursimeve në vitet 1997-1998, nuk disponohet informacion i dokumentuar për vlerat e sakta të depozituara në secilin vit dhe për vlerat e sakta të interesave të përfituar nga këto depozita deri në vitin 2005. Për depozitat pranë BKT-së, nuk disponohet informacion i dokumentuar për vlerat e sakta të depozituara në secilin vit dhe për vlerat e sakta të interesave të përfituar nga këto depozita deri në vitin 2002.

40.1 Subjekti i rivlerësimit parashtron se burimet e krijimit të këtyre depozitave janë kursimet personale, të bashkëshortit, kursimet e familjeve respektive para martesës, si dhe pas martesës me familjen e madhe të bashkëshortit, nuk disponon dokumentacion për shkak të kohës së largët, por ka provuar ligjshmëritë e depozitave me shkresat përkatëse nga bankat¹⁵⁹, ku në mënyrë kronologjike, janë përshkruar të gjithë veprimet me këto depozita, janë specifikuar vlerat, përlllogaritja e interesave, për periudhat konkrete. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, për të ardhurat dhe kursimet e kësaj periudhe, janë: në të ardhurat e saj nuk janë përfshirë: pagat e muajve tetor-dhjetor 1994, me pagë mujore 16.500 lekë; paga e muajit dhjetor 1996; pagat e muajve shtator-tetor-nëntor për vitin 1997; pagat e pesë muajve për vitin 1998, me vlerë 31.751 secila; për periudhën 1993-1997, shpenzimet e jetesës së subjektit përballoheshin nga familja e origjinës, prandaj nuk duhet të zbriten nga të ardhurat e saj; për

¹⁵⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 11.02.2020, drejtuar subjektit, me lëndë: “Kthim përgjigje kërkesës suaj për vërtetim pagese”.

¹⁵⁹ Shkresa e Raiffesisen Bank nr. {***}, datë 27.05.2022, dhe e BKT-së me nr. {***} prot., datë 07.06.2022.

vitet 1997-2000, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur me 66% të të ardhurave vjetore, në kundërshtim me vendimin orientues të Kolegjit nr. 15/2021(JR); ndryshimi i të ardhurave totale për këto vite, passjell ndryshimin e vlerës së shpenzimeve për jetesë.

40.2 Në Kolegji, u krye korrigjimi i analizës financiare të Komisionit, duke reflektuar: (i) si kursime të subjektit deri në vitin 1997, të ardhurat neto nga pagat, pa zbritur shpenzime të jetesës; (ii) duke shtuar të ardhurat e saj, pagat e muajit dhjetor 1996, muajve shtator-dhjetor 1997; (iii) shpenzimet e jetesës për vitin 1997, ashtu si dhe për vitet në analizë 1993-1996, në raportin 30% me të ardhurat nga paga. Në përfundim, për periudhën 01.01-30.10.1997, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti, kishin mundësi financiare në vlerën 800.000 lekë, por edhe me diferencë pozitive në vlerën prej 109.145 lekësh, për krijimin e depozitës në datën 30.10.1997, në ish-Bankën e Kursimeve. Referuar vërtetimit të bankës, gjendja e depozitës më datë 10.12.1997, është 1.200.000 lekë, por nuk jepet informacion si është krijuar/shtuar, shtesa prej 400.000 lekësh. Duke konsideruar kursimet e mundshme të periudhës 1993-1996, të ardhurat e vitit 1997 prej 227.981 lekësh, shpenzimet për jetesë prej 68.394 lekësh, shpenzime qiraje prej 40.000 lekësh dhe shumën e depozituar prej 1.200.000 lekësh gjatë vitit 1997, analiza financiare për këtë vit do të rezultonte me një balancë negative prej (-) 276.211 lekësh e, për rrjedhojë, pamundësi për krijimin me burime të ligjshme të shumës së shtuar në depozitë, prej 400.000 lekësh. Duke konstatuar se kjo shifër, në vlerë absolute, përbën 35% të vlerës së depozitës 800.000 lekë, në referim të të dhënave të Bankës së Shqipërisë¹⁶⁰, për politika të përkohshme në vitin 1997 lidhur me përqindjet e interesave deri në 37%, nuk përjashtohet mundësia që shuma prej 276.211 lekësh të përbëjë normën e interesit të aplikuar nga banka. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se kursimet e mundshme të subjektit dhe personit të lidhur, bashkëshortit, deri në vitin 1997, janë depozituar të gjitha në depozitën në ish-Bankën e Kursimeve dhe, për rrjedhojë, balanca e vitit 1997 rezulton pozitive.

40.3 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se me të njëjtin arsyetim, sikundër për depozitën si më lart analizuar, kundërshton përfundimin e Komisionit se për *llogarinë në monedhën euro në BKT, e cila vjen me një gjendje të vërtetuar prej 8.873,96 eurosh (2.272,41 + 1.165,75 + 2.435,8) para datës 1.1.2002 nga kjo bankë, përmes shkresës nr. {***} prot., datë 7.6.2022, në të cilën pranohet nga banka që në momentin e emetimit të monedhës euro (datë 1.1.2002), depozitat e mëparshme në monedhat ITL, DEM dhe GRD janë konvertuar në monedhën euro. Më pas, në datën 20.9.2002, ato janë unifikuar në një depozitë të vetme. Ndërkohë, nuk saktësohet momenti i krijimit të tyre para vitit 2002.*

40.4 Trupi gjykues konstaton se, në ndryshim nga depozitat në Raiffeisen Bank, në shkresën e BKT-së me nr. 2292/1 prot., datë 7.6.2022, nuk jepet informacion për kohën e hapjes së tri depozitave në monedha të ndryshme, të konvertuara në monedhën euro në momentin e emetimit

¹⁶⁰Shih: https://www.bankofalbania.org/Botime/Botimet_sipas_viteve/Raporti_Vjetor_1997.html - "Raporti Vjetor 1997" i Bankës së Shqipërisë, faqe 10 : "[...] Gjatë periudhës maj-shtator, kur ekonomia ishte paralizuar, kushtet për investime ishin të pafavorshme, besimi në monedhën vendase ra e leku zhvlerësohej, sistemi financiar kishte hyrë në krizë. Nisur nga këto dukuri dhe në bazë të ecurisë së pritshme të inflacionit, Banka e Shqipërisë bëri ndryshimet e nevojshme në përqindjet e interesit për depozita me afat 3-mujore, nga 27 për qind në mars, në 34 për qind në maj dhe 37 për qind në korrik. Kjo politikë e përkohshme e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, realizoi objektivin e tij në veçetë, rikthimin e besimit të publikut ndaj sistemit bankar, si një domosdoshmëri për funksionimin normal të sistemit bankar. Rrjedhojë që rikthimi i depozitave në sistemin bankar, pas tërheqjeve masive që ato patën nga fillimi i vitit deri në korrik '97. Gjithashtu, ato ndikuan edhe në vlerësimin e lekut, duke përfutur interesa shumë më të lartë se depozitimi në valuta të huaja".

të saj, dhe të unifikuara në një depozitë të vetme më datë 20.09.2002. Nga aktet në fashikuj, konkretisht kërkesës drejtuar BKT-së më datë 19.05.2022, për marrje dokumentacioni lidhur me këtë depozitë, bashkëshorti i subjektit referon se është klient i bankës prej vitit 1998, dhe se tri llogaritë bankare në *ITL, DEM dhe GRD*, janë hapur përpara vitit 2002, momenti kur janë bashkuar në një llogari të vetme në monedhën euro. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se këto depozita janë krijuar nga bashkëshorti përpara martesës, nuk rezulton i bazuar për sa subjekti ka lidhur martesë në vitin 1996, ndërsa bashkëshorti deklaron se është klient i bankës nga viti 1998, pra pas martesë. Për rrjedhojë, për vitin 2001 u konsiderua gjendja prej 5.979 eurosh, që përfshin edhe interesat e përfutur nga këto depozita deri në këtë vit, e që mbarten në vitin 2002, sipas informacionit në shkresën e bankës.

40.5 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi, për përlllogaritje të pasaktë të të ardhurave të saj nga pagat, pasi nuk janë përfshirë: pagat e muajve tetor-dhjetor 1994; paga e muajit dhjetor 1996; pagat e muajve shtator-tetor-nëntor 1997; pagat e pesë muajve për vitin 1998, konstatohet se subjekti i ka ngritur këto pretendime në parashtrimet për rezultatin e hetimit administrativ dhe ka paraqitur vërtetimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, me nr. {***} prot., datë 28.06.2022. Në vështrim të krahasuar të analizës financiare në rezultatin e hetimit administrativ, me analizën financiare në vendim, konstatohet se Komisioni ka kryer korrigjimet duke shtuar të ardhura të subjektit nga paga, për muaj të vërtetuar me shkresën e sipërcituar. Duke çmuar se subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtares në vazhdimësi, për një qëndrim garantist, trupi gjykues mori në konsideratë edhe përfitimin e pagave për muaj të papërfshirë në analizën financiare të Komisionit, sipas një vlerësimi objektiv¹⁶¹.

40.6 Lidhur me analizën financiare të vitit 1998: (i) pretendimi i subjektit për shtimin e depozitës në Raiffeisen Bank me interesat e përfutur, prej 365.027 lekësh, nuk provohet nga shkresa e bankës, e për më tepër shuma e pretenduar përbën 30% të vlerës së depozitës prej 1.200.000 lekësh, pothuaj dyfishin e normës së interesit vjetor të vitit 1998 prej 16,5%, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë; (ii) për dy depozitat e reja, me balanca 700.000 lekë më 30.12.1998 dhe 200.000 lekë më 30.06.1998, përbëjnë shtesa depozitash, dhe nuk qëndron pretendimi i subjektit se përveç kursimeve të vitit, ato mbulohen dhe nga interesat e tyre. *Së pari*, nuk ka të dhëna për momentin e hapjes së këtyre depozitave dhe për afatin e maturimit të tyre; *së dyti*, edhe pa konsiderimin e shtesës së këtyre depozitave [900.000 lekë], sërish analiza financiare do rezultonte negative. Në përfundim, pas korrigjimit vetëm të shpenzimeve të jetesës në raportin 30% me të ardhurat nga paga, viti 1998 rezultoi me balancë negative prej (-) 1.138.276 lekësh.

40.7 Lidhur me analizën financiare të vitit 1999: (i) u rishikuan shpenzimet e jetesës në raportin 30% me të ardhurat nga paga¹⁶²; (ii) u llogaritën 9 muaj shpenzimet e qirasë, sipas shpjegimeve të subjektit në pyetëtorin standard. Ndërsa nuk u morën në konsideratë: (i) interesat e depozitës bankare në ish-Bankën e Kursimeve. *Së pari*, në shkresën e bankës nuk ka informacion si është shtuar depozita nga viti 1998 prej 1.565.027 lekësh, me balancë në fund të vitit 1999 prej 1.803.952 lekësh. *Së dyti*, diferenca mes dy vlerave të sipërcituara, prej 234.625 lekësh, që subjekti e pretendon si interesa të përfutur, përbën 15% të gjendjes së depozitës në fund të vitit 1998. Kjo

¹⁶¹ Për muajin dhjetor 1996, paga e subjektit u konsiderua sa mesatarja e pagave të muajve pararendës (prej +13.454 lekësh). Për muajt tetor e nëntor 1997, paga u konsiderua si paga e muajit gusht (prej + 22.246 lekësh). Për rrjedhojë, për vitin 1997, përlllogaritja e pagave rezultoi sa pretenduar prej subjektit, në vlerën prej 227.981 lekësh.

¹⁶² Për vitin 1999, prej 120.250 lekësh (30% e të ardhurave nga paga prej 400.833 lekësh).

përçindje përtafron me normën e interesit prej 13% të depozitave në mesin e vitit 1999¹⁶³. Edhe sipas kësaj norme interesi, maksimumi i interesit të përfituar do të ishte 203.454 lekë, dhe jo sa e pretendon subjekti; (ii) shuma prej 1.500.000 lekësh, si të ardhura të bashkëshortit nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës, çështja “{***}” ShPK, për të cilën është analizuar në detaje më lart në këtë vendim, dhe vlerësuar prej trupit gjykues si të krijuar me burime jo të ligjshme financiare. Në përfundim, pas rishikimit për shkaqe të cilat u vlerësuan të bazuara, analiza financiare për vitin 1999, rezultoi me balancë negative në vlerën prej (-) 944.878 lekësh.

40.8 Lidhur me analizën financiare të vitit 2000: (i) u korrigjua vlera e kostos së ndërtimit të shtesës së apartamentit më sipërfaqe 68 m², sipas vlerësimit të Kolegjit, në vlerën prej 1.536.176 lekësh; (ii) u korrigjuan të ardhurat e bashkëshortit nga {***}-ja prej 2.250 USD, duke kryer konvertimin me kursin mesatar prej 1 USD = 146,08 lekë, sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Pretendimet e subjektit lidhur me interesa të depozitave bankare, pa referuar vlerë të tyre, dhe për sa ndryshimet e likuiditeteve rezultojnë 95.589 lekë, u vlerësuan të pabazuara. Në përfundim, pas rishikimit për shkaqe të cilat u vlerësuan të bazuara, analiza financiare për vitin 2000, rezultoi me balancë negative në vlerën prej (-)1.305.535 lekësh [më pak se Komisioni prej 179.239 lekësh].

40.9 Sa më sipër, lidhur me analizën për periudhën 1993-2000, për të cilën Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamjaftueshmëri financiare prej (-) 4.397.569 lekësh për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës, pas shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të subjektit, rezultoi se nuk ka balancë negative deri në vitin 1997, që përkon me momentin e fillimit të bashkëjetesës së subjektit me bashkëshortin dhe hapjen e depozitës në ish-Bankën e Kursimeve. Ndërsa, për analizën nga 1998 – 2000, momenti i ndërtimit të shtesës anësore të apartamentit në Tiranë, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamjaftueshmëri financiare prej 3.388.689 lekësh¹⁶⁴ për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

40.10 Lidhur me analizën financiare të vitit 2001, u vlerësua se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit për: (i) interesat e depozitave bankare për të cilat nuk jep shpjegime nga i kanë rezultuar, por duket se i referohet një depozite gjendje më 30.06.2001, me këtë vlerë. Duke konsideruar këtë vlerë si interesa të depozitave, do të përbënte një interes prej 6% të balancës së depozitave prej 3.696.077 lekësh më 31.12.2000, që është më e ulët se normat e interesit vjetor prej 8,9% për vitin 2001, referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë; (ii) mospërfshirjen e shpenzimeve të mobilimit të shtesës anësore me sipërfaqe 68 m², pasi në pyetësin standard këto shpenzime janë deklaruar prej saj të kryera në vitet 2001 dhe 2002.

Në përfundim, pas korrigjimit të të ardhurave të bashkëshortit nga {***}-ja prej 3.600 USD, ose prej 493.336 lekësh, duke aplikuar kursin mesatar prej 1 USD = 137,04 lekë, sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë¹⁶⁵, analiza financiare e vitit 2001 rezultoi me diferencë negative prej (-) 1.081.317 lekësh. Thellimi i balancës negative me (-) 5.350 lekë, vjen si rezultat i konvertimit të depozitave nga monedha euro në lekë.

¹⁶³Referuar raportit vjetor të vitit 1999 të Bankës së Shqipërisë:

https://www.bankofalbania.org/Botime/Botimet_sipas_viteve/Raporti_Vjetor_1999.html.

¹⁶⁴Total i diferencave të viteve: 1998 – prej (-)1.138.276 lekësh; 1999 – prej 944.878 lekësh; 2000 – prej 1.305.535 lekësh.

¹⁶⁵Shih: https://www.bankofalbania.org/Botime/Botimet_sipas_viteve/Raporti_Vjetor_2000.html.

40.11 Lidhur me analizën financiare të vitit 2002, duke llogaritur shpenzimet për shkollimin e vajzave për 9 muaj, sipas pretendimit të subjektit, dhe duke korrigjuar/shtuar të ardhurat e interesit në BKT Bank, sipas lëvizjes së llogarive bankare prej 35,95 eurosh (4.958 lekë), analiza financiare rezulton në vlerën prej (-) 1.102.339 lekësh [më pak se Komisioni prej 161.070 lekësh, ndikuar dhe nga konvertimi i depozitave nga monedha euro në lekë, për të cilën është analizuar në paragrafin 36 më lart].

Analiza financiare për periudhën 2003-2016

Të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat për periudhën shtator 2007 - dhjetor 2016

- 41** Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat për periudhën shtator 2007 - dhjetor 2013, Komisioni ka analizuar dhe konkluduar:
- *Nga Bashkia Tiranë vërtetohet një xhiro e deklaruar nga z. A. G., në vlerat 3-4 milionë lekë për gjithë periudhën e zhvillimit të aktivitetit, si edhe pagesa e taksave vendore të biznesit të vogël për këtë xhiro të deklaruar, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.*
 - *Nga organet tatimore, nuk konfirmohet pagesa e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël sipas ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, i ndryshuar, neni 12, pika 1. Meqë nuk vërtetohet deklarimi i xhiros mbi 2.000.000 lekë pranë DRT-së Tiranë dhe nuk vërtetohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për xhiron mbi 2.000.000 lekë, të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti i tij privat nuk mund të kapërcejnë pragun prej 2.000.000 lekësh për ato vite ku nuk vërtetohet kjo nga organet tatimore.*
 - *Si rrjedhim, Komisioni: (i) për vitin 2007, xhiron maksimale të mundshme nga aktiviteti prej 4.000.000 lekësh e ka plotpjesëtuar për muajt e aktivitetit, nga data 17.09.2007, kur bashkëshorti i subjektit është regjistruar si person fizik, duke aplikuar një marzh fitimi prej 80%; (ii) për vitin 2008, është konsideruar xhiro maksimale prej 2.000.000 lekësh pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, mbi të cilën është aplikuar një marzh fitimi prej 80%; (iii) për vitin 2009, është konsideruar vlera e fitimit prej 342.000 lekësh, vërtetuar me shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë¹⁶⁶; (iv) për vitet 2010-2013, është konsideruar xhiro maksimale prej 2.000.000 lekësh, mbi të cilën është aplikuar një marzh fitimi prej 80%; (v) për vitet 2014-2016, është konsideruar vlera sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë.*

41.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se është rezultat i një metodologjie të zbatuar në shkelje të hapur me ligjin, provat dhe mendimin e specializuar të administratës tatimore. Subjekti parashtron:

- i. Komisioni ka cituar vetëm nenin 12/1 të ligjit nr. 9844/2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””, pa e interpretuar në harmoni dhe pa marrë në konsideratë nenet 1, 12/2, 12/5, 12/6 të po këtij ligji, udhëzimet “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin”, si dhe kuadrin nënligjor të Ministrisë së Financave.
- ii. Në kuptim të dispozitave të sipërcituara të ligjit nr. 9844/2007, bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur shpenzime të njohura, të cilat, në bazë të nenit 12/5 të këtij ligji, janë të zbritshme me qëllim që të rideklaroheshin prej tij në deklaratën e tatimit mbi të ardhurat për të ardhurat personale, nuk ka qenë në ato raste që të paguhej tatim shtesë prej 10%.
- iii. Për periudhën 2007-2013, rezulton se provohet xhiroja vjetore prej 3.000.000 - 4.000.000

¹⁶⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 19.05.2002.

lekësh, dhe pagimi i detyrimeve përkatëse është pasqyruar dhe paguar pranë Bashkisë Tiranë, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”.

- iv. Në vitin 2009, me deklaratën e paraqitur, bashkëshorti ka pretenduar për një qarkullim prej 680.000 lekësh, shpenzime 300.000 lekë, dhe fitim 380.000 lekë. Organet tatimore nuk e kanë marrë në konsideratë këtë deklaram, me arsyetimin se nuk pasqyron të vërtetën, shpenzimet e deklaruara nuk janë shpenzime të njohura, për sa zyra ku ushtrohej aktiviteti ishte një dhomë e shtëpisë dhe mobilimi konsiderohej si i shtëpisë, dhe nga inspektimi/hetimi me metoda krahasuese alternative, kanë arritur në përfundimin që qarkullimi vjetor duhet të mbetet në fashën 4 milionë lekë. Kjo provohet për sa organet tatimore nuk kanë bërë rimbursim të shpenzimeve të pretenduara, taksave të parapaguara për vitin 2009 për qarkullimin vjetor 4 milionë lekë.
- v. Nuk është marrë parasysh mendimi i kualifikuar i administratës tatimore, shpjeguar në paragrafin e dytë të shkresës nr. {***}, datë 19.05.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë [provë e marrë nga Komisioni], ku, gjithashtu, është pasqyruar se detyrimi i bashkëshortit deri në këtë periudhë është 9.536 lekë. Sipas arsyesimit të përdorur prej Komisionit, për uljen e fashës së qarkullimit për shkak të mosdorëzimit të deklaratës, organet tatimore në njoftimet e tyre të detyrimit të viteve në vijim, do të kishin pasqyruar detyrimin tatimor, që do të ishte rreth 1.200.000 lekë pa penalitete dhe interesa.
- vi. Sipas arsyesimit të Komisionit, që bashkëshorti i subjektit, personi fizik A. G., përveç taksës vendore të biznesit të vogël, duhet që të paguante dhe tatimin mbi të ardhurat personale, do të sillte taksimin e dyfishtë për të njëjtin nivel fitimi, që do të rezultonte 17,5 %, ndërkohë që në atë periudhë ka qenë aplikuar taksa e sheshtë 10 për qind dhe jo tatimi progresiv, sipas të ardhurave.
- vii. Aplikimi i marzhit të fitimit prej 80%, është i pabazuar, pasi nuk referon në normë ligjore, studim apo investigim që të bëjë rivlerësim tatimor.

41.2 Së pari, nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton si vijon.

- i. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit deklaroi të ardhura nga *angazhimi në veprimtari private me profesionin avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, në vlerën prej 24.318.000 lekësh*.
- ii. Në deklaratat vjetore të pasurisë dhe interesave periodikë, nga viti 2007, kur është *regjistruar si person fizik*, të ardhurat e bashkëshortit deklarohen si vijojnë: në DIPP-2007, në vlerën prej 3.900.000 lekësh; në DIPP-2008 në vlerën prej 3.900.000 lekësh; në DIPP-2009-2013, nuk janë deklaruar të ardhura; në DIPP-2014, në vlerën prej 925.000 lekësh; në DIPP-2015, në vlerën prej 2.510.864 lekësh; në DIPP-2016, në vlerën prej 1.063.842 lekësh.
- iii. Gjatë hetimit administrativ¹⁶⁷, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit pas regjistrimit si person fizik, ka deklaruar si vijon: viti 2007 – 1.000.000 lekë; viti 2008 – 4.000.000 lekë; vitet 2009-2013 – 4.000.000 lekë secili; viti 2014 – 925.000 lekë; viti 2015 – 2.828.400 lekë; viti 2016 – 1.240.000 lekë.

¹⁶⁷ Në përgjigje të pyetësorit.

- iv. Referuar informacionit të Bashkisë Tiranë¹⁶⁸, në periudhën 2007-2013, bashkëshorti i subjektit e ka qarkullimin vjetor të deklaruar në nivelin 3-4 milionë lekë, ka shlyer taksat si biznes i vogël dhe taksa të tjera vendore.
- v. Referuar informacionit të DRT Tiranë: (i) të dërguar në ILDKPKI¹⁶⁹, shtetasi A. G., me status ligjor person fizik, datë regjistrimi 17.09.2007, me përgjegjësi tatimore, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH), nga data e regjistrimit e në vijim, subjekti është deklarues në organet tatimore, dhe pasqyrohen të ardhurat e deklaruara, fitimi i realizuar për vitet 2009, dhe 2014-2016; (ii) të dërguar në Komision¹⁷⁰, shtetasi A. G., me status ligjor person fizik, i regjistruar në sistemin tatimor më datë 17.09.2007, për të ardhurat e deklaruara sipas deklaratave të të ardhurave të dorëzuara në sistemin tatimor, pasqyrohen qarkullimi, fitimi, dhe fitimi pas tatimit, për vitet 2009, 2014-2016. Për vitin 2007, pasqyrohet në varësi të pushtetit lokal. Për vitet 2008, 2010-2013, pasqyrohet pa dorëzuar deklaratë.

Në shkresat e sipërcituara, pasqyrohet se subjekti deklarues është person fizik dhe nuk shpërndan dividend pasi, bazuar në pikën 5. 6, “Vendimi për destinimin e fitimit”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës për destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

41.3 Trupi gjykues konstaton se sipas parashikimeve të nenit 12, pika 1 e ligjit nr. 8438/1998: “Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të cilat realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale”¹⁷¹, të dyja shkresat e DRT Tiranë të sipërcituara, në përmbajtje konfirmojnë detyrimin e bashkëshortit të subjektit për deklarim pranë organeve tatimore. Konkretisht, në shkresën e parë konfirmohet nga data e regjistrimit e në vijim, subjekti është deklarues në organet tatimore, ndërsa në të dytën citohet: për të ardhurat e deklaruara sipas deklaratave të të ardhurave të dorëzuara në sistemin tatimor, pra pa përjashtuar për asnjë arsye detyrimin për dorëzim të deklaratave.

¹⁶⁸ Shkresa nr. {***}, datë 26.10.2016, e Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, konfirmon se në bazë të ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. {***}/2015, taksapaguesi A. G. e ka qarkullimin vjetor të deklaruar për vitet 2007-2013 deri në nivelin 3-4 milionë lekë. Me formularët e pagesave, datë printimi 12.10.2016, rezultojnë të pasqyruar likuidimi i pagesave të kryera për taksën e biznesit të vogël (këstet), tarifa e pastrimit, taksa e ndërtesës, taksa e tabelës, tarifa e regjistrimit, taksa e gjelbër.

¹⁶⁹ Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nr. {***} prot., datë 13.07.2017, administruar në dosjet e ILDKPKI-së. Bashkëlidhur “Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël” për vitin 2009; “Formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin” për vitet 2014-2016.

¹⁷⁰ Shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me nr. {***}, datë 19.05.2022, në përgjigje të kërkesës së Komisionit. Bashkëlidhur, regjistrimi në sistemin C@ts, datë rregjistrimi 17.09.2007, në të cilin ka deklaruar se “fitimi i parashikuar deri në fund të vitit, 225.000 lekë (7,5% e xhiros) dhe xhiro e parashikuar deri në fund të vitit 3.000.000 lekë”; për vitet 2009, “Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël; e 2014-2016 “Për Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin”.

¹⁷¹ Ligji nr. 9326, datë 06.12.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103-204, f. 6836.

41.4 Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, dokumenteve bashkëlidhur shkresave të DRT Tiranë, personi fizik A. G. ka qenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga biznesi i vogël për vitin 2009, dhe subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin deri në vitet 2014-2016 – ashtu si vërtetohet dhe nga deklaratat e dorëzuara për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014-2016. Si *person fizik*, përpos taksave vendore mbi biznesin e vogël, bashkëshorti i subjektit ka pasur detyrimin për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale, 10% mbi të ardhurat e tatueshme, për tatimpaguesit që realizonin qarkullim vjetor nga 2-8 milionë lekë/vit, kjo sipas informacionit të detajuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me ndryshimet e legjislacionit tatimor në vite¹⁷². Thënë ndryshe, përveç taksave vendore mbi biznesin e vogël, të vërtetuara të paguara nga Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, për vitet 2007-2016, personi fizik A. G. ka qenë subjekt i detyrimeve të pagesës për tatimin mbi të ardhurat, për rrjedhojë pretendimi i subjektit për taksim të dyfishtë, vlerësohet i pabazuar. Referuar akteve në fashikuj, për vitet 2009 dhe 2014-2016, janë llogaritur tatimet mbi të ardhurat, ndërsa për vitet kur nuk janë dorëzuar deklaratat, logjikisht xhiroja vjetore nuk mund të pretendohet se ka kaluar vlerën 2 milionë lekë, pasi e kundërta do të kishte sjellë detyrimin për të deklaruar të ardhurat e taksueshme sipas kuadrit ligjor të tatimeve.

41.5 Edhe pse Bashkia Tiranë informon se gjatë gjithë viteve 2007-2016, personi fizik ka deklaruar xhiro 3-4 milionë lekë, referuar formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2009, të ardhurat e deklaruara prej 680.000 lekësh janë disa herë më të vogla, po ashtu dhe në formularët e sjellë nga DRT-ja për vitet 2014-2016, xhirot e deklaruara janë gjithmonë nën vlerën prej 3 milionë lekësh (maksimumi viti 2015, prej 2.828.400 lekësh). Sa më sipër, pagesa e taksës duket se nuk përputhet me qarkullimet e viteve për të cilat janë paguar tatimet mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, e pagesa e kësaj takse, nuk përbën bazë për të pretenduar të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i personit fizik, në kushtet kur nuk është vërtetuar pagesa e tatimeve mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2008, 2010-2013. Përpos sa më sipër, në deklaratat e pasurisë të viteve 2009-2013, nuk janë deklaruar të ardhura nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortit të subjektit. Për rrjedhojë, në të gjitha këndvështrimet, pretendimet e subjektit për të ardhura në vlerën 3-4 milionë në vit për periudhën 2007-2013, mbeten të paprovuara e deklarative.

41.6 Subjekti pretendoi *se marzhi i fitimit i aplikuar nga Komisioni prej 80% e xhiros së aktivitetit të personit fizik, është i pabazuar. Së pari*, Komisioni në vendim shprehet se ky marzh fitimi i përdorur në analizë përbën një standard të përdorur vijimësisht për aktivitete të të njëjtit lloj; *së dyti*, subjekti nuk pretendon një tjetër marzh fitimi; *së treti*, referuar formularëve të deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël të vitit 2009 (datë 30.03.2010), formularëve të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014-2016, marzhi i fitimit rezulton në një mesatare prej ~ 78%¹⁷³, pra i përafërt me marzhin e aplikuar nga Komisioni prej 80% e xhiros/qarkullimit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit u gjet i pabazuar.

42 Në përmbyllje, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe rishikimit të analizës financiare të Komisionit për vitet 2003-2016, me reflektim të ndryshimeve si më lart pasqyruar, balanca

¹⁷² Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr.{***} prot., datë 16.10.2019.

¹⁷³ Për vitin 2009, prej 50% (fitimi 342.000 lekë/ qarkullimi 680.000 lekë); për vitin 2014, prej 86% (fitimi 797.915 lekë/ qarkullim 925.000 lekë); për vitin 2015, prej 89% (fitimi 2.510.864 lekë/ qarkullim 2.828.400 lekë); për vitin 2016, prej 86% (fitimi 1.063.842 lekë/ qarkullim 1.240.000 lekë).

negative rezulton në vlerën prej (-) 27.277.130 lekësh¹⁷⁴, në një diferencë prej 8.286.852 lekësh nga sa ka konkluduar Komisioni.

- 43 Lidhur me analizën financiare, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për periudhën 2003-2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e përcaktuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- 44 Lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e aftësive profesionale, duke evidentuar se dhënia e masës disiplinore është bazuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe, në përfundim të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, pretendimet e subjektit nuk u gjetën të bazuara në prova e në ligj, trupi gjykues e vlerëson pa relevancë shqyrtimin e shkaqeve të ankimit për këtë kriter.
- 45 Në përfundim, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, në zbatim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 570, datë 07.10.2022, gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹⁷⁴ Si total i diferencave negative të vitit 2003, prej – 1.947.791 lekësh, më pak se KPK prej 190.341 lekësh (nga vlera -2.138.132 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt – 25.575 lekë, rishikimit të të ardhurave nga {***}-ja, me efekt shtim prej 119.808 lekësh, uljes së shpenzimeve të shkollës prej 96.108 lekësh; të vitit 2004, prej – 1.060.534 lekësh, më pak se KPK-ja prej 317.736 lekësh (nga vlera -1.378.270 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt – 49.202 lekë, rishikimit të të ardhurave nga {***}-ja, me efekt shtim prej 287.730 lekësh, uljes së shpenzimeve të shkollës prej 79.208 lekësh; të vitit 2005, prej – 595.646 lekësh, më pak se KPK-ja prej 348.773 lekësh (nga vlera - 944.419 lekë), si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt – 38.765 lekë, rishikimit të të ardhurave nga {***}-ja, me efekt shtim prej 103.734 lekësh, uljes së shpenzimeve të shkollës prej 61.284 lekësh, konsiderimit të të ardhurave nga interesi prej 222.520 lekësh; të vitit 2008, prej – 4.371.273 lekësh, më pak se KPK-ja prej 478.349 lekësh (nga vlera - 4.849.622 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 465.087 lekë dhe i uljes së shpenzimeve të shkollës prej 13.261 lekësh; të vitit 2009, prej – 7.293.934 lekësh, më pak se KPK-ja prej 931.157 lekësh (nga vlera - 8.225.091 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 931.157 lekë; të vitit 2010, prej – 188.055 lekësh, më pak se KPK-ja prej 1.560.575 lekësh (nga vlera -1.748.630 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 1.560.284 lekë dhe konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 291 lekësh; të vitit 2011, prej – 2.098.116 lekësh, më pak se KPK-ja prej 708.384 lekësh (nga vlera - 2.806.500 lekë), si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 38.509 lekë dhe konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 669.875 lekësh; të vitit 2012, prej – 1.297.807 lekësh, më pak se KPK-ja prej 688.277 lekësh (nga vlera - 1.986.084 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 343.961 lekë dhe konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 344.316 lekësh; të vitit 2013, prej – 2.254.950 lekësh, më pak se KPK-ja prej 1.303.449 lekësh (nga vlera - 3.558.399 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt – 565.776 lekë, konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 549.803 lekësh dhe uljes së shpenzimeve për ndërtimin e shtesës në Vlorë prej 1.319.423 lekësh (nga vlera e llogaritur nga KPK-ja prej 2.211.160 lekësh, në pjesën e vlerës së rillogaritur në Kolegj prej 891.737 lekësh); të vitit 2014, prej – 6.169.024 lekësh, më pak se KPK-ja prej 1.759.811 lekë (nga vlera - 7.928.835 lekë) si rezultat i rillogaritjes së likuiditeteve me efekt 1.926.057 lekë, konsiderimit të të ardhurave nga interesat prej 398.925 lekësh dhe shtimit të shpenzimeve për ndërtimin e shtesës në Vlorë, për vlerën prej 565.171 lekësh.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 570, datë 07.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Gumbardhi (Caco).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 24.01.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi